



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Drejtorinë e  
Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi  
Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

**të ushtruar në**

**“DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË  
OBJEKTEVE PUBLIKE, BASHKIA TIRANË”**

**Tiranë, 2023**

# PËRMBAJTJA

<b>I.</b>	<b>PËRMbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>4</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2.	Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore .....	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	7
<b>II.</b>	<b>HYRJE.....</b>	<b>9</b>
1.	Objektivat e auditimit .....	9
2.	Qëllimi i auditimit.....	9
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	10
5.	Përgjegjësitë e audituesve .....	10
6.	Kriteret e vlerësimit .....	10
7.	Standardet e auditimit .....	11
8.	Metodologjia e auditimit.....	11
9.	Dokumentimi i auditimit.....	12
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>13</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	13
2.	<b>Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....</b>	<b>13</b>
	<b>2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.....</b>	<b>13</b>
	<i>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</i> Lidhur me observacionin e DPBNJP/SBNJP për paragrafin e parë, rekomandimi përcjellë <i>nevojën e &lt;hartimit të planeve vjetore të trajnimit&gt;</i> dhe jo hartimin e <i>&lt;programeve të trajnimit&gt;</i> , Ndryshimi i termit përmban në vetvete edhe ndryshimin në përmbajtje, që prek drejtpërdrejtë kompetencat e secilës njësi: DPBNJP në DPOP harton “planet vjetore për trajnimin e stafit” sipas nevojave të njësisë publike në përputhje me objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të DPOP Tiranë, të cilat pasqyrohen në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të çdo njësie publike ( që DPOP Tiranë nuk e ka hartuar); Ky plan vjetor Trajnimesh prezantohet në organin epror - Bashkia Tiranë/Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila nga ana e saj përgatit programet sipas fushave /sistemeve përkatëse.....	21
	Lidhur me paragrafin e dytë, gjetja citon elementët e rregullt dhe mangësitë që u konstatuan. Për këtë arsye grupi i auditimit vlerëson faktin e pranimit nga ana juaj të rekomandimit, por për mungesën e aktit ligjor/nënligjor mbi të cilin duhet të mbështetet argumenti juaj, <i>nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.....</i>	21
	<b>2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....</b>	<b>30</b>
	<b>2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....</b>	<b>84</b>
	<b>2.4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.....</b>	<b>114</b>
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>118</b>
	<b>KONTROLLI I LARTË I SHITIT .....</b>	<b>130</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
DPOP	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditu i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Tiranë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë nga data 01.01.2020 deri në datën 31.12.2021, etj. Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 14 Akte Konstatimi dhe 2 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

## 2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në auditimin e 47 procedurave të prokurimit publike për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 14 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshkruan procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.	Pika 4.3., faqe 84-114	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurime publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
2	Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për blerje mallrash, në 2 raste procedura duhej të ishte ndarë në lote, konkretisht procedurat e vitit 2021 me objekt “Blerje vegla pune” si dhe “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë” pasi mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta, Mos ndarja në lote kufizon pjesëmarrjes e operatorëve ekonomik, pasi një numër i vogël OE mund të kenë objekt të aktivitetit të tyre, të dy objektet e procedurës që prokurohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 29 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me nenin 42 të VKM-në nr. 285/2021.	Pika 4.3., faqe 84-114	E lartë	Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për të realizuar këtë ndarje dhe hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.
3	Në auditimin e procedurave të prokurimit me objekt blerje mjetesesh, konkretisht “Blerje automjet Pick Up” dhe “Blerje automjet kamionçinë ATP 5+1/6+1 vende me bagazh hermetik”, rezulton se specifikimet teknike të vendosura janë me diferenca minimaliste apo fikse për parametrat teknik, specifikime të cilat mund të pengojnë konkurrencën, dhe janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020.	Pika 4.3., faqe 84-114	E lartë	Specialistët e fushës në Komisionin për Hartimin e Specifikimeve Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të marrin masa për vendosjen e specifikimeve teknike sa më përfshirëse, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.
4	Nga auditimi i 47 procedurave të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2020 – 31.12.2021, u konstatua në 13 raste kualifikim i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika	Pika 4.3., faqe 84-114	E lartë	Drejtori i Përgjithshëm i DPOP, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	1, dhe nenin 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3, të ndryshuara me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.			nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.
5	Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se objekti i rikonstruktuar “Ish Garda, edhe pse është kolauduar në datën 28.12.2021, nuk është vënë në shfrytëzim nga Investitori.	Pika 4.4., faqe 114-117	E lartë	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të merren masa të menjëhershme për iniciimin e shfrytëzimit të këtij objekti, me qëllim ruajtjen dhe administrimin sa më të mirë të tij.
6	Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se grupi i pompave të furnizimit me ujë nuk ekzistonte.	Pika 4.4., faqe 114-117	E lartë	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për mungesën e këtij zëri pune dhe të përcaktohet personi përgjegjës që do të zëvendësojë grupin e pompave ose të dëmshpërblejë vlerën e dëmit ekonomik.
7	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 38,197,800 lekë, fituar nga OE “R. C.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 232,320 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 49/5 prot datë 21.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë dhe OE “R.C” SHPK.	Pika 4.4., faqe 114-117	E lartë	Nga DPOP, Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>232,320 lekë pa tvsh</b> nga OE “R. C.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
8	Nga auditimi i kontratave për dhënie me qira të banesave sociale, rezulton debi e akumuluar në vlerën 100,589,491 lekë, nga të cilat, <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin 2017 janë 297 debitorë me vlerën e detyrimit 19,306,264 lekë;</li> <li>• Për vitin 2018 janë 330 debitorë me shumë e debisë prej 36,275,766 lekë;</li> <li>• Për vitin 2019 janë 331 debitorë me vlerën e detyrimit prej 57,472,830 lekë;</li> <li>• Për vitin 2020 janë 338 debitorë me vlerën e detyrimit në 28,445,386 lekë;</li> <li>• Për vitin 2021 janë 305 debitorë në vlerë të detyrimit prej 22,144,145 lekë;</li> </ul> -Rezulton se është krijuar debi ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë. -Nga ana e saj Drejtoria e Strehimit ka raportuar në Bashkinë Tiranë, por mbajtja e statusit “raportim” jo vetëm që nuk ka sjellë marrjen e masave për zgjidhjen e problemit, por ka rezultuar me rritjen e numrit të debitorëve dhe të vlerës së detyrimit. Ky detyrim i përket kontratave me tarifa të pa përditësuara, të cilat janë modeste dhe të përballueshme nga përfituesit. Mungesa e bashkëpunimit mes DPOP Tiranë me Drejtorinë e Strehimit Social/Bashkia Tiranë, është arsyeja bazë e krijimit dhe thellimit të problematikes nga viti në vit.	Pika 2.6., faqe 44-47	E lartë	Nga DPOP, Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Banesave Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të qerasë dhe të marrin masa për hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore, me qëllim arkëtimin e vlerave të debitorëve në shumën 100,589,491 lekë, dhe pagesën e vlerave të detyrimit ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.
9	Nga auditimi i zbatimit të kontratave për dhënie e palestrave me qira ndërmjet DPOP si Drejtori Mbikëqyrëse dhe subjekteve përfituese, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet në vlerën 1,526,525 lekë, nga të cilat për vitin 2018 janë 15 debitorë me shumën e detyrimit 232,130 lekë; për vitin 2019 janë 9 debitorë me shumën e detyrimit 59,475 lekë nga të cilët 3 debitorë janë të trashëguar nga viti 2018 në shumën e 29,475 lekë; për vitin 2020 janë 50 debitorë me shumën e detyrimit 1,012,025 lekë; për vitin 2021 janë 38 debitorë me shumën e detyrimit 514,500 lekë.	Pika 2.6., faqe 47-49	E lartë	Nga DPOP Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Aseteve e Koordinimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të tarifës për palestrat shkollorë të dhëna në përdorim dhe të marrin masa në hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore me qëllim përmirësimin e situatës për të arkëtuar

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				vlerën e plotë të detyrimit prej 1,526,525 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### **Opinioni mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë për vitin ushtrimor 2020 dhe 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200<sup>1</sup>, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar**<sup>2</sup> për llogaritë vjetore të subjektit DPOP, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

#### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga DPOP Tiranë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysht nivelin e materialitetit prej 29,210 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

- Llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është nënvlerësuar për shumën 108 mijë lekë;
- Llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë”, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar duke u nënvlerësuar në vlerën 100,689 mijë lekë;
- Llogaria 602 është nënvlerësuar në shumën 26,492 mijë lekë, e cila përfaqëson nënlllogarinë 6026 “shpenzime për qiramarrje”;
- Llogaria 212 “objekte e konstruksione” nuk përfaqëson vlerën reale të objekteve, pasi disa prej tyre në mungesë të vlerës, në kontabilitet janë regjistruar vlerat e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tyre.

#### **Opinion i auditimit për përputhshmërinë.**

Nga auditimi mbi veprimtarinë e subjektit “**Drejtorja e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**” (periudha 01.01.2020 – 31.12.2022), audituesit vlerësuan shkallën e zbatimit nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*).

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4000 shprehim një **opinion të modifikuar (kualifikuar)** për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, duke

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>2</sup>Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

arritur ne perfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale, por jo të përhapura.

### **Baza për opinionin:**

-Mbi përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, ku nga 47 procedura të audituara, në 14 raste janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës, dhe në shpalljen fitues në 13 raste të operatorëve ekonomik jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve për kualifikim, të cilat nën gjykimin e audituesve nuk janë të përhapura.

-Në lidhje me të ardhurat për banesat sociale, konstatohet se nuk është ndjekur e plotë procedura ligjore për arkëtimin e tyre në vlerën 109,705 mijë lekë, borxhi i krijuar nga familjarët që kanë këto banesa në përdorim, ndaj OSHEE në vlerën 23,924 mijë lekë, ndaj UKT në vlerën 8,703 mijë lekë, dhe mos arkëtimi i qirave për përdorimin e palestrave të shkollave në vlerën 1,526 mijë lekë.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.**

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.



## II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1007/1 Prot, datë 15.11.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.11.2022 deri në datën 30.12.2022, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2020 – 30.12.2022. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. Sh. H. – *Përgjegjës Grupi*
2. S. J. – *Audituese*
3. A. F. – *Audituese*
4. A. Z. – *Auditues*

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie.

**Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjektit të audituar Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

### 1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### 2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### 3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të

<sup>3</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e drejtorisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

**Pika 1.** Mbi menaxhimin financiar, kontrollin.

**Pika 2.** Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

**Pika 3.** Vlerësimi i raportimit financiar.

**Pika 4.** Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

#### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

#### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Tiranë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve

justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>4</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>5</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

---

<sup>4</sup> ISSAI 1315

<sup>5</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Kjo drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe Rregullores së brendshme të DPOP.

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike mbulon me kompetencat e saj kryesore funksionet e përgjithshme të caktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në drejtim të;

Mirëmbajtjes, lyerjes dhe çdo shërbimi tjetër, të objekteve shkollore dhe parashkollore, bodrumeve, vendstrehimeve etj.

Planifikimin dhe ndjekjen e furnizimit të vazhduar me materiale konsumi (naftë/pellet) për sistemin e ngrohjes në objektet parashkollor dhe shkollor.

Menaxhon dhe mirëmban godinat dhe objektet që janë në pronësi të Bashkisë Tiranë.

Është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të privatizimit të objekteve që me ligj apo akte nënligjore i njihen si e drejtë Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, kjo në koordinim të ngushtë me organet përfaqësuese dhe ekzekutive të Bashkisë Tiranë në emër të së cilit vepron si organ i vartësisë së NJVV.

Administron dhe mirëmban Banesat Sociale, aset i Bashkisë Tiranë si dhe banesat në përdorim të komuniteteve.

Kryen funksionet e njesisë menaxheriale të vartësisë së Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore publike, në drejtim të zbatimit të rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe kryen procedurat si njësi prokurimi në përputhje me rregullat procedurale e ligjore të prokurimit publik.

DPOP drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.

DPOP ka 9 drejtori dhe konkretisht:

- 1. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore**
- 2. Drejtoria Ekonomike**
- 3. Drejtoria e Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit**
- 4. Drejtoria e Mirëmbajtjes Godina Arsimore**
- 5. Drejtoria e Mirëmbajtjes, Lyerje Godina Arsimore dhe Publike**
- 6. Drejtoria e Mirëmbajtjes së Impianteve dhe Riparimit**
- 7. Drejtoria e Shërbimit të D.D.D-së**
- 8. Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në Përdorim të Komuniteteve**
- 9. Drejtoria e Teknike dhe Transporti**

#### **2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

##### **2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.**

Bazuar në *Misionin* e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së bashkisë Tiranë”<sup>6</sup>, Bashkia Tiranë duke

<sup>6</sup> *Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe atë të ri nr. 108/2016.*

vlerësuar disa shërbime si kyçe për bashkëjetesën e të gjitha kategorive sociale dhe për një efektivitet të paktën të qëndrueshëm të këtyre shërbimeve ndaj tyre, ka krijuar disa ndërmarrje në varësi të saj si Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë (emërtimi i fundit). Historiku i ndryshimeve strukturore, fushës së veprimtarisë dhe emërtimeve të kësaj Njësie, është:


- Deri më 2004 “Ndërmarrja Komunale Banesa” Tiranë;
- Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.15 datë 10.03.2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit” i cili ndryshoi emërtimin nga “Ndërmarrje Komunale Banesa” në “Drejtoria Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit”;
- Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 2986/1 datë 29.01.2016 “Për riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë Tiranë” u ndryshua struktura organizative nga Drejtoria Nr. 3 e Punëtorëve të qytetit” në “Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit”;
- Me Vendimin Nr. 159 datë 26.12.2019 “Për emërtimin dhe miratimin e stemave të drejtorive të përgjithshme të punëtorëve të qytetit, dhe qendrës ekonomike të zhvillimit të fëmijëve, institucione në varësi të Bashkisë Tiranë”, ndryshohet emërtimi nga “Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit” në “Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike” shoqëruar kjo edhe me zgjerim të fushës së veprimtarisë, me kalimin në kompetence të saj i mirëmbajtjes së objekteve arsimore (godina, ambiente sportive).

Nr	Viti	Emërtimi	VKB/ Ukr.
1	deri më 2004	Ndërmarrja Komunale Banesa	I hershëm
2	2004	Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit	Nr. 15 dt.10.03.2004
3	2016	Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit	Nr.2986/1 dt.29.01.2016
4	2019	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike	Nr.159 dt.26.12.2019

Burimi: DPOP Tiranë

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në DPOP Tiranë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.



## 1. Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit”, titullarët e njësive publike janë

përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV.

“Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, rezulton se për periudhën në auditim 2020, 2021 e 2022 nuk është hartuar/miratur një Plan Strategjik dhe Plan Vjetor të Aktivitetit të Njësisë të cilën drejton, si derivat i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë [PPV], ku të paraqiten qartë misioni, vizioni dhe objektivat e institucionit për një afat 5 vjeçar.

### **1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues.**

**a.** DPOP Tiranë gjatë periudhës nën auditim 2020, 2021 dhe 31.10.2022 ka ushtruar funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme nr. 3 të punëtorëve të qytetit (tani DPOP)” institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në Administratën publike”, Ligjit nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, VKM nr. 511/2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, VKM nr. 390/1995 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë të çdo viti respektiv “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme nr. 3 (tani DPOP)”.

**b.** Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, DPOP Tiranë për periudhën nën auditim nuk ka funksionuar me një Kod Etike, pasi nuk ka hartuar dhe miratur me Vendim të Titullarit të njësisë “Kodin e Etikës për DPOP” në moszbatim të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Nga auditimi rezulton se deri në fund të periudhës Auditimit 30.12.2022, DPOP Tiranë nuk ka funksionuar me Kod Etike të veçantë, por tek Rregullore e Brendshme gjendet e pasqyruar në nenin 10 “Kodi i etikës dhe kodi i veshjes për punonjësit e drejtorisë”.

**c.** DPOP Tiranë për periudhën nën auditim (01.01.2020 deri më 30.12.2022) nuk disponon një Rregullore të posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si edhe te Rregullore e Brendshme nuk përfshihet në asnjë nen të saj. Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre. Kjo në moszbatim të Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën


publike“ Kreu II neni 4,5; Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për Geklarimin dhe Kontrollin e pasurive, të Detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Ligjit nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

“Kodi i Etikës” dhe “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

## 1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës.

Punësimi në DPOP Tiranë bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e DPOP Tiranë:

- Drejtoria e Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës [DPBNJP] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas Kodit të Punës i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përherëshëm i Pranimit [KPP] ose Komisioni në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;
- Titullari i Njësisë në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm;



Struktura përgjegjëse e DPOP Tiranë paraqesin në çdo rast në mënyrë shkresore pozicionet e lira në strukturë konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Tiranë dhe Njësisive në varësi të saj”. Nga verifikimi i dokumentacionit që grupi i auditimit i kërkoi [DPBNJP], rezultoi se për vitin 2020, 2021 dhe 2022 janë të plota praktikat e ndjekura për çdo rast të të punësuarve me kontratë pune, të bazuara mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor. Publikimi i vendeve vakante nga ana e DPOP Tiranë duhet të bëhet në faqen zyrtare të saj si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive [AKPA], konform VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6 dhe Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2.

- Në DPOP Tiranë Struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, dhe janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme të njësisë publike. Strukturat organizative të DPOP Tiranë janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë si më poshtë:



1. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 3488/2 datë 22.01.2019, prot në DPOP me nr. 289/2 datë 28.01.2019;
2. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 4737/1 datë 31.01.2020, prot në DPOP me nr. 429 datë 31.01.2020;
3. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 12245 datë 09.04.2020, prot në DPOP me nr. 1232 datë 09.04.2020;
4. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 39059/1 datë 09.11.2020, prot në DPOP me nr. 4134 datë 10.11.2020;
5. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 1488/1 datë 15.01.2021, prot në DPOP me nr. 135 datë 15.01.2021;
6. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 29767/1 datë 30.07.2021, prot në DPOP me nr. 3028 datë 02.08.2021;
7. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 40141/1 datë 15.10.2021, prot në DPOP me nr. 4347 datë 19.10.2021;
8. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Nr. 50202/1 datë 16.12.2021, prot në DPOP me nr. 5257 datë 20.12.2021.

Me miratimin nga ana e Kryetarit të Bashkisë të Strukturave Organizative të DPOP Tiranë, janë miratuar rregulloret e përditësuara të strukturave respektive, si më poshtë:  
VK për Miratimin e Rregullores së Brendshme të DPOP – Bashkia Tiranë

1. Vendimi nr. 22404/1 datë 12.06.2019
2. Vendimi nr. 20049/1 datë 25.06.2020
3. Vendimi nr. 37050/1 datë 26.10.2020
4. Vendimi nr. 14763/1 datë 12.04.2021
5. Vendimi nr. 2765/1 datë 08.02.2022
6. Vendimi nr. 21334/1 datë 15.06.2022

Gjithashtu në zbatim të tyre, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrat për njohjen e personelit me rregulloret e miratuara:


1. Urdhër nr. 2095/2 datë 29.06.2020
2. Urdhër nr. 3969/1 datë 29.10.2020
3. Urdhër nr. 1315/1 datë 13.04.2021
4. Urdhër nr. 682/1 datë 15.02.2022
5. Urdhër nr. 2727/1 datë 24.06.2022

Për zhvillimin normal dhe me efektivitet të aktivitetit të DPOP Tiranë, është miratuar me Urdhër Drejtori i Përgjithshëm dhe përcjelljen për njohje dhe zbatim nga personeli edhe i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike “Mbi organizimin dhe funksionimin e sigurimit teknik dhe shëndetit në punë” me nr.1798 datë 27.04.2022.

### **1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.**

Struktura organizative të DPOP Tiranë dhe çdo ndryshim në kompozimin e saj miratohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.<sup>7</sup> Nga auditimi rezultoi se DPOP Tiranë funksionon me një Strukturë lineare, në të cilën pasqyrohet qartë shkalla hierarkike, duke patur një transmetim dhe reagim të shpejtë të zbatimit të Urdhrave dhe Udhëzimeve të eprorëve.

<sup>7</sup> Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për miratimin e strukturës organizative të DPOP” janë listuar në piken 1.2 ‘Politika menaxheriale dhe stili i punës’



Çdo strukturë organizative bashkëshoqërohet me organigramën përkatëse, e cila jep një pasqyrim të qartë të shkallës hierarkike si dhe pozicionit të çdo njësie përbërëse të saj. Një informacion mbi njësitë përbërëse të strukturës organizative të DPOP Tiranë, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Nr. i Drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i Stafit Plan Fakt
2019	5	17	358
			355
2020	5	17	375
			400
			400
			400
2021	9	20	415
			415
			415
			415
			415
2022	9	22	425
			425

*Burimi: DPOP Tiranë*

#### 1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore të Njësisë Publike. DPOP Tiranë aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e cila miratohet me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, pasi DPOP Tiranë është njësi varësie e bashkisë Tiranë.<sup>8</sup> Rregullore e fundit është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 21334/1 datë 15.06.2022 dhe është pasuar me Urdhrin nr. 2727/1 datë 24.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm për “Njohjen e gjithë punonjësve me Rregulloren e Brendshme të përditësuar”. Rregullorja e Brendshme përmban: bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. DPOP Tiranë deri më sot nuk disponon “Listën (Hartën) e proceseve/Manualin e Procedurave”, ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës dhe “Gjurmët e auditimit” e unifikuar për njësitë kryesore të strukturës.

<sup>8</sup> Urdhret e Kryetarit të Bashkisë Tiranë për “Miratimin e Rregullores së Brendshme të DPOP”, janë listuar në pikën 1.2 “Politika menaxheriale dhe Stili i punës”

## 1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 (deri më 31 tetor) në DPOP Tiranë si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga ky Institucion. Emërimet/largimet i janë nënshtruar procedurave të përcaktuara në Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**- a. Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit** kërkuam dosjet e punonjësve të emëruar në DPOP Tiranë për disa kategori që në gjykimin tonë mbartin risk profesional si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim.

**Konstatim 1.5/a** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në këtë periudhë, rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit e përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan edhe këto parregullsi apo mangësi:

- Formulari Tip “Fletë Inventari” në disa raste nuk përmbante nënshkrimin e punonjësit; mungonte praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; nënshkrimi në formularin e Vetdeklarimit, deklarata e kodit të etikës, dokumentacioni bazë në të shumtën e rasteve ishin fotokopje e pa njëzuar me origjinalin, kontrata e punës pa formularin “përshkrim i punës të pozicionit”, gjithashtu për pozicionet e veçanta në strukturë me profesionet elektrikist, hidraulik, drejtues mjeti teknologjik nuk përmbanin dokumentacionin e detyrueshëm në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi sipas rregullores së brendshme: arsimin e duhur profesional apo certifikata të kurseve profesionale elektrikist, hidraulik etj, si dhe leje drejtimi shoqëruar me Dëshmi Aftësie Profesionale [DAP] etj.,

- Dosjet e punonjësve të larguar nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar Kreu VII, XIV; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; “Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli” Kreu III/Kap.3.1

**- b Mbi trajnimin e punonjësve në DPOP Tiranë.**

Profesionalizmi është një karakteristikë e punonjësit që nënkupton se ai ka aftësinë, dijen dhe zotësinë e duhur për të kryer detyrat që i ngarkohen. Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë ndër të tjera edhe angazhimin për: futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre; kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit të vlerësimit. Nga auditimi rezulton se stafi administrativ i DPOP ka zhvilluar numër të kufizuar trajnimesh për programet e detyrueshëm ofruar nga ASPA për njësi të veçanta të strukturës së DPOP Tiranë. Nga komunikimi me [DPBNJP] na u përcoll ky informacion: *“Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe performancës në kryerjen e funksioneve të punonjësve dhe zhvillimin e kompetencave dhe njohurive profesionale të tyre, shpesh herë ka përcjellë kërkesa për bashkëpunim, në lidhje me programin e trajnimeve, nga Drejtoria e Trajnimit dhe zhvillimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, Bashkia Tiranë sipas fushës së veprimtarisë që mbulon DPOP”.*

N r	Viti i trajnimit	Vendi i trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Tematika / Cështja e trajnimit	Nr i pjesmarrësve në trajnim	
1	2019	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Drejtoria e Inspektimit dhe Trajnimeve.	10 ditor	Normat tekniko profesionale, në lidhje me dokumentacionin protokoll-arkivë.	2	
2	2019	ASPA	2 ditor	Mbi procedurën e prokurimeve Publike, trajnim i avancuar.	4	
3	2019	Bashkia Tiranë	2 ditor	Burimet Njerëzore, procedurat ligjore, etj.	2	
4	2020	ASPA	2 ditor	Prokurimet Publike, ndryshimet ligjore.	2	
5	2020	DPOP, online Zoom.	3 ditor	Procedura administrative, implementimi i saj sipas rregullave dhe afateve ligjore.	6	
6	2021	Bashkia Tiranë	2 ditor	Trajnim mbi financimet mjedisore.	4	

*Burimi: DPOP Tiranë*

**Observacion i Subjektit – DPOP Tiranë/;** Me shkresën nr. 330/2 prot., datë 24.02.2023 dhe nr. 1007/4 prot., (KLSH) datë 28.02.2023, subjekti i audituar DPOP Tiranë ka paraqitur observacionet e tij lidhur me gjetjet dhe rekomandimet që grupi i auditimit i ka përcjellë në Projekt Raportin e Auditimit si më poshtë vijon:

Drejtoria Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës/ Sektori i Burimeve Njerëzore lidhur me: Rekomandimin 1.2 të pikës 1 të programit të auditimit “Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”. **(Pranohet pjesërisht, arsyet)**

- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, nuk disponon infrastrukturë administrative dhe organike në kuptimin e trajnimit profesional që të ofrojë programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit në mënyre direkte. Në drejtim të kësaj, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, zhvillon programet e trajnimit që ofrojnë strukturat e posaçme jashtë institucionit dhe në këtë kuptim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, është kërkuar mbështetja me trajnim profesional të fushave të caktuara, kjo nga ana e Drejtorisë së Trajnimit dhe Zhvillimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë, cituar edhe në projekt raportin e auditit, faqe.16. Prandaj në këtë Kuptim struktura përgjegjëse në institucion në kuadrin e pranimit pjesërisht të rekomandimit, vlerëson se lidhur me këtë pikë, ka kryer dhe përmbushur shqetësimet e ngritura në raportin e auditit të KLSH-së dhe merr për sipër që programe të tilla për trajnimin e punonjësve të intensivizojë dhe zgjerojë nëpërmjet komunikimit dhe informimit për të gjithë punonjësit, stafin dhe titullarin, gjithmonë duke kërkuar suportin e instancave përkatëse dhe kompetente të cilat ofrojnë trajnime për fushat e ndryshme.

- Në lidhje me plotësimin e dosjeve të personelit sipas paragrafit të fundit të këtij rekomandimi, vlerësojmë se nga ana e strukturës përgjegjëse, Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Performancës, dosjet e personelit janë të kompletuara në nivelin optimal lidhur me dokumentacionin bazë që duhet të përmbajë dosja personale e punës së çdo punonjësi, por theksojmë se kompletimi dhe administrimi i dokumentacioneve që

administrohet në dosjen e çdo punonjësi ka karakterin e një procesi dinamik dhe në vartësi të dokumentit që kërkohet nga ligji apo aktet nënligjore, i cili administrohet dhe depozitohet në dosjen e çdo punonjësi në vartësi të marrëdhënieve në ndryshim që pësojnë marrëdhëniet e punës, dhe si i tillë, edhe në këtë pikë Sektori i Burimeve Njerëzore, merr për sipër që në çdo rast ku bëhet e domosdoshme një gjë e tillë të plotësojë me dokumentacion maksimal të kërkuar nga ligji, dosjet e personelit.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Lidhur me observacionin e DPBNJP/SBNJP për paragrafin e parë, rekomandimi përcjellë *nevojën e <hartimit të planeve vjetore të trajnimit>* dhe jo hartimin e *<programeve të trajnimit>*, Ndryshimi i termit përmban në vetvete edhe ndryshimin në përmbajtje, që prek drejtpërdrejtë kompetencat e secilës njësi: DPBNJP në DPOP harton “planet vjetore për trajnimin e stafit” sipas nevojave të njësisë publike në përputhje me objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të DPOP Tiranë, të cilat pasqyrohen në Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të çdo njësie publike ( që DPOP Tiranë nuk e ka hartuar); Ky plan vjetor Trajnimesh prezantohet në organin epror - Bashkia Tiranë/Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila nga ana e saj përgatit programet sipas fushave /sistemeve përkatëse.

Lidhur me paragrafin e dytë, gjetja citon elementët e rregullt dhe mangësitë që u konstatuan. Për këtë arsye grupi i auditimit vlerëson faktin e pranimit nga ana juaj të rekomandimit, por për mungesën e aktit ligjor/nënligjor mbi të cilin duhet të mbështetet argumenti juaj, *nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

## **2. Menaxhimi i riskut.**

**2.1 Regjistri i Riskut** Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave. DPOP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut, ku bëhet i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe risqeve që vijnë nga burime të jashtme, në kundërshtim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. Regjistrin e riskut e kanë hartuar njësi të veçanta në strukturë (Drejtoria Ekonomike, Drejtoria DDD dhe DPBNJP).

Regjistri i Riskut i konsoliduar, bazohet në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

- DPOP Tiranë deri më 31.12.2022 nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Aktiviteti i GMS përcaktohet në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” ku dhe citohet se “.....Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë.... ”

**2.2 Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet

nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut*:

**2.3 Gjurmët e Auditimit** janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative. Gjurmët e auditimit si edhe regjistri i riskut rezultojnë të hartuara nga njësi të veçanta në strukturë: DPBNJP, DE, DDD.

Nga sa më sipër nga ana e DPOP Tiranë, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Gjurmët e Auditimit, kjo pasi Titullari i Njësisë në cilësinë e NA, nuk ka miratuar “Gjurmët Standarde të Auditimit”.

**b.** Lidhur me *Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT*, grupi i auditimit referuar informacionit shkresor të vënë në dispozicion nga Specialisti i IT i DPOP Tiranë, rezultoi si në tabelën më poshtë:

Nr	EMERTIMI	DREJTORIA
1	“I,”A” dhe “A21”	Dr. Ekonomike
2	Microsoft Office (Word & Excel)	Dr. Prokurimeve, B. Njerëzore e Performancës
		Dr. Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit
		Dr. Mirëmbajtje e Godinave Arsimore
		Dr. Mirëmbajtje e Lyerje Godinave Arsimore dhe Publike
		Dr. Impiante e Riparimit
		Dr. Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në Përdorim të Komuniteteve
		Dr. Shërbimi DDD
		Dr. Teknike dhe Transportit

Burimi: DPOP Tiranë

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike [DPOP] nuk disponon Server qendror për ruajtjen e të dhënave apo të sistemeve me të cilat ajo operon, pasi këto servera janë të hostuara në ambientet e Bashkisë Tiranë, e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre.

**c.** *Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës.* Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që

identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

### 3. Veprimtaritë/Aktivitetet e Kontrollit

**3.1** .Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e koston; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

- Në DPOP Tiranë për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive
		» Manuali i pasqyrave financiare
2	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Lloji i Kontrollit që duhet të zbatohet në një njësi publike janë: parandalues dhe pas faktit. Në DPOP Tiranë kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë Tiranë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit; ndërsa për ato parandaluese nga testimi i kryer, janë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

**a.** Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;

*e realizuar*

**b.** Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);

*e realizuar*

**c.** Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave);

*e realizuar*

**d.** Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.;

*e realizuar*

**e.** DPOP Tiranë nuk disponon rregullore për menaxhimin e aktiveve të saj (AAM);

pa realizuar

**e.** Rregulloret për Sistemet IT duhet t'i vihen në dispozicion çdo përdoruesi;

*e realizuar*

**f.** Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë njësisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik;

*e realizuar pjesërisht*

**g.** Komunikimi dhe trajtimi i urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni;

*e realizuar pjesërisht*

**h.** Ndarja e detyrave i referohet strukturës organizative institucionale, ku secili punonjës kryen detyrën sipas akt emërimit dhe Formularit të përshkrimit të punës;

*e realizuar*

**i.** Nuk ka delegim të funksioneve të NZ nga ana e NA;

*pa realizuar*

**j.** Institucioni përgjithësisht zbaton rregullat e përcaktuara në “Normat tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor” për ruajtjen e dokumenteve, për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës, por nuk ka një rregullore të veçantë dhe një plan veprimesh për mirëfunksionimin e arkivit dhe të shërbimeve që ajo ofron, të miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm;

*e realizuar pjesërisht*

**k.** DPOP Tiranë ka ngritur Njësine e Sinjalizuesit, ka miratuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit”, Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, në zbatim këto të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Për periudhën nën auditimi grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion raporte vjetore dërguar në ILDKPKI si dhe rezultoi pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; deri më 31.10.2022 në DPOP Tiranë, nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit.

*e realizuar pjesërisht*

**l.** DPOP Tiranë nuk ka faqen e saj zyrtare në internet, për vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve për publikun, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion, në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 “E drejta për Informim”;

*pa realizuar*

Çdo Njësi Publike edhe ato në varësi të NJVQV, duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësive të ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

**3.2** DPOP Tiranë si njësi publike e madhe dhe që shpenzon shuma të mëdha fondesh për të mundësuar ofrimin e shërbimeve kryesore për publikun, e bën të pamundur që menaxheri i lartë të kontrollojë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse njësia po e ushtron veprimtarinë në mënyrë efektive, duke bërë të nevojshme krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm brenda saj. Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e njësive publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësine publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të menaxhimit. Aktiviteti, misioni, objektivat e NJAB realizohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi: Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, VKM nr. 83 /2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me VKM nr. 353/2016.

Në DPOP Tiranë nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm, por aktivitetin e saj e realizon Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Tiranë. Nga auditimi rezultoi se frekuenca audituese e NJAB Bashkia Tiranë është e përvitshme në DPOP duke nënkuptuar që e ka klasifikuar kështu, në *subjekt me Risk* si në fushën e veprimtarisë publike (aktivitetin e saj), ashtu edhe në masën dhe përdorimin e fondeve publike. Gjithashtu rezultoi se, ndonëse NJAB të Bashkisë Tiranë ushtron mision auditues çdo vit në DPOP, nuk arrin të sigurojë mbulimin e çdo fushe apo sistemi të saj, të klasifikuar mbi bazë risku (i lartë, i mesëm, i ulët), plani strategjik apo vjetor i misioneve audituese të së cilës duhet të respektojë raportin [60% me 40%] mes sistemeve/fushave me risk



të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm çdo 3 vjet dhe me risk të ulët jo më shumë se 5 vjet. Kjo kushtëzon nevojën që në DPOP Tiranë të krijimit të NJAB të vetin. Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

#### 4. Informacioni dhe Komunikimi

*Komunikimi* është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet, ndërsa *Informacioni* është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Të gjithë punonjësit duhet të njihen me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Informacioni dhe komunikimi janë të brendshëm dhe të jashtëm. Informacioni përcillet vertikalisht nga poshtë lart për te NA, duhet të jetë i saktë, i vërtetë, i përshtatshëm dhe në kohën e duhur mbi të gjithë aktivitetin e njësisë. Niveli menaxherial i institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) ka *informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit*; si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e GMS dhe për rrjedhojë edhe e realizimit të takimeve të tij, e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësive brenda strukturës së DPOP Tiranë si dhe DPOP Tiranë me Bashkinë (si ndërmarrje në varësi të saj). Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. DPOP Tiranë disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miratuar mbështetur strukturës organizative me të cilën funksionon kjo njësi publike, sipas Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë Tiranë VKB-ve përkatëse. Komunikimi dhe informacioni për publikun bëhet në internet nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë publike. Nga auditimi rezultoi se DPOP Tiranë nuk ka një faqe të vetën në internet, por si njësi varësie e Bashkisë Tiranë, përdor faqen zyrtare të saj me adresë <https://tirana.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë <https://portavendore.al/bashkia-Tirane/pasaporta-e-bashkise-Tirane/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connection security) HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm. Në DPOP Tiranë nuk është caktuar *Koordinatori për Informim* dhe *Koordinatori i Transparencës* konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 “E drejta për Informim”;

Mungesa e faqes së vet zyrtare në Internet të DPOP Tiranë, bën që numri i informacioneve dhe njoftimeve që publikohen në WEB-in e Bashkisë Tiranë të jetë i kufizuar; Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit riskon të pasurit e një komunikimi efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

- a. Buxheti **nuk** diskutohet me njësitë përbërëse të strukturës brenda Institucionit, por mjaftohen me kërkesat buxhetore shkresore që paraqet çdo drejtori;
- b. Janë hartuar raportet mbi analizën vjetore të arritjeve të objektivave të DPOP Tiranë, por **nuk** janë zhvilluar takime dhe nuk ka dokumentim të tyre;
- c. Nëpërmjet Drejtorisë së Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës, si njësi përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme realizohet korrespondenca shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik sipas rastit). Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor

(komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;

d. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të njësisë (NA);

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

## **5. Monitorimi dhe Raportimi**

Mungesa GMS dhe i caktimit të një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit të Riskut, mos hartimi i regjistrit të riskut, strategjisë së riskut, gjurmëve të auditimit, ka sjellë mos efektivitet në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo në mungesën e GMS dhe si rrjedhojë mos hartimin e raporteve vjetore prej tij, të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët, të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetar i GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet në Bashkinë Tiranë. Raportimi i konsoliduar (aparati i bashkisë me njësitë e varësisë) bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” hartohet nga njësi përgjegjëse e Bashkisë Tiranë dhe dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE. Këto Raporte janë ato të monitorimit të buxhetit dhe ato mbi MFK që përmbajnë: Pyetësorin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksonimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK. Nga auditimi rezultoi se Raportet e monitorimit të buxhetit janë hartuar nga Drejtoria Ekonomike dhe dërguar në bashkinë Tiranë; ndërsa lidhur me raportimin mbi MFK ku përfshihen 4 seksionet e sipërcituara nga DPOP Tiranë nuk janë hartuar dhe si rrjedhojë nuk është raportuar në organin epror. Drejtoria e Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në përdorim të Komuniteteve raportojnë nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike/Sektorit i Financës në Bashkinë Tiranë, mbi vjeljen e të ardhurave nga ambientet sportive të shkollave dhe banesave sociale të dhëna me qira. Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të DPOP Tiranë, konstatojmë se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që del). Kjo arrihet duke krijuar GMS dhe forcuar aktivitetin e tij si rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, zgjedhjen e koordinatorit të riskut, që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

**Observacion i Subjektit – DPOP Tiranë/;** Me shkresën nr. 926 prot., datë 03.03.2023 dhe nr. 1007/5 prot., (KLSH) datë 03.03.2023, subjekti i audituar DPOP Tiranë ka paraqitur observacionet e tij lidhur me gjetjet dhe rekomandimet që grupi i auditimit i ka përcjellë në Projekt Raportin e Auditimit si më poshtë vijon:

Nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues Referuar Akt Konstatimit nr.1 datë 30.12.2022 për <mungesën e GMS dhe caktimin e një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit të Riskut > ju bëjmë me dije se me Urdhër të Brendshëm nr. 61 datë 09.01.2023 është caktuar Grupi i Manaxhimit Strategjik të Sistemit Financiar dhe kontrollit (MFK). Gjithashtu me urdhër të

brendshëm nr 66 datë 09.01.2023 u ngrit Grupi i Monitorimit të Përgjithshëm që lidhet me sistemin Financiar dhe kontrollin e brendshëm ne DPOP Tiranë.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Lidhur me observacionin e Drejtorit të DE grupi i auditimit vlerëson faktin e reflektimit të DPOP Tiranë për Gjetjen nr.7 mbi krijimin e GMS dhe Gjetjes nr. 14 mbi monitorimin dhe raportimin. Në periudhën në vijim në fazën e zbatimit të rekomandimeve do të auditohet mbi aktivitetin e tyre në zbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2 dhe “Manualin MFK”. Për sa më sipër observacioni juaj nuk ndryshon përmbajtjen e rekomandimit tonë i cili është përcjellë qartë edhe në Projekt Raportin e Auditimit.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi implementimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit të Brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur edhe nga mungesa e Raportit të Vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në DPOP Tiranë, u konstatuan mangësitë si vijon:

**Mjedisi i Kontrollit**

**1.** DPOP Tiranë për periudhën nën auditim nuk ka hartuar Kodin e Etikës, në moszbatim të Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

**2.** DPOP Tiranë për periudhën nën auditim, nuk ka hartuar Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” neni 4,5; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**3.** Nga auditimi rezultoi se Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e Komisionit të punësimit nuk janë regjistruar edhe në Regjistrin e protokollit të DPOP Tiranë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154/2003 “Për Arkivat”, “Normat Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr. 4, datë 19.6.2017 për Miratimin e “Rregullores së Njësuar të Punës me Dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”.

**4.** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në këtë periudhë, rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit e përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan edhe këto parregullsi apo mangësi:

- Formulari Tip “Fletë Inventari“ në disa raste nuk përmbante nënshkrimin e punonjësit; mungonte praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; nënshkrimi në formularin e Vetëdeklarimit, deklarata e kodit të etikës, dokumentacioni bazë në të shumtën e rasteve ishin fotokopje e pa njehsuar me origjinalin, kontrata e punës e pa shoqëruar me formularin “përshkrim i punës të pozicionit”, gjithashtu për pozicionet e veçanta në strukturë me profesionet elektrikist, hidraulik, drejtues mjeti teknologjik nuk përmbanin dokumentacionin e detyrueshëm në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive sipas rregullores së brendshme: arsimin e duhur profesional apo certifikata/dëshmi të kurseve profesionale elektrikist, hidraulik etj, si dhe leje drejtimi shoqëruar me Dëshmi Aftësie Profesionale [DAP] etj.,

- Dosjet e punonjësve të larguar nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar Kreu VII, XIV; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; “Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli” Kreu III Kap.3.1

**5.** Nga auditimi rezultoi se nga DPOP Tiranë, struktura përgjegjëse e saj [DPBNJP] nuk ka hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj të të gjitha kategorive (Iartë, e mesme, e ulët drejtuese dhe ekzekutive), përjashtim bëjnë vetëm punonjësit e kategorisë me klasa të njëjsteve të veçanta (të Drejtorisë DDD). Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve janë kuptuar dhe zbatuar nga stafi.

#### Regjistri i Eiskut

**6.** DPOP Tiranë deri më 31.10.2022 nuk ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Konsoliduar të Riskut në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**7.** DPOP Tiranë deri më 31.10.2022 nuk ka ngritur GMS dhe nuk ka caktuar Koordinatorin e riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; neni 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

**8.** Nga DPOP Tiranë nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”;

**9.** Nga auditimi rezulton se, Gjurmët Standarde të Auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e DPOP Tiranë, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.

**10.** DPOP Tiranë nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016; Udhëzimi nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr.21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

#### Veprimtaritë e Kontrollit

**11.** Nga DPOP Tiranë nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të neni 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”(sipas Aneksit 11);

**12.** Në DPOP Tiranë nuk është krijuar NJAB si pjesë e strukturës organizative të saj, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, VKM nr. 83 /2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njëjsteve të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me VKM nr. 353/2016;

#### Informacioni dhe Komunikimi

**13.** DPOP Tiranë si njësi e madhe publike në varësi të Bashkisë Tiranë, nuk ka faqen e vet zyrtare në internet dhe nuk ka caktuar Koordinatorin për Informimin Publik dhe të Transparencës të

njesisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 119/2014 “Për Informimin Publik” dhe Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 15;

#### Monitorimi dhe Raportimi

**14.** DPOP Tiranë nuk ka krijuar një praktikë të konsoliduar Monitorimi e Raportimi kryesisht mbi ato të implementimit dhe zbatimit të komponentëve të MFK që përmban Pyetësonin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksonimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK, në kundërshtim këto me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualin MFK”.

**Kriteri:** Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi shtator - 2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a, b, c; Ligji nr. 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 / 3,4,5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; Manuali për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016; VKM nr. 83 /2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me VKM nr. 353/2016; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; me VKM nr. 746/2018 VKM nr. 639 dt. 07.09.2016 ndryshuar me VKM nr. 596 dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”; Ligji nr. 9887 dt. 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ose Ligji nr. 138 dt. 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Ligji nr. 9049/2003 i ndryshuar, Ligji nr. 9367/2005 dhe Udhëzimi nr. 1 dt. 7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të “Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”; VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar; “Rregullore për Ndërtimin e Dhomës së Serverave” /2008; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

**Ndikimi:** Nga DPOP Tiranë nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen 5 (pesë) Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. duke rrishtuar kështu sigurinë e arritjes së objektivave institucionale nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

**Shkaku:** Gjatë periudhës nën auditim DPOP Tiranë nuk ka treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit edhe me dokumentacionin përkatës (krijimin e GMS dhe caktimin e Koordinatorit të Riskut, kodi i etikës, rregullore parandalimi e konfliktit të interesit, manuali i procedurave, gjurmët e auditimit, strategji risku, plan vjetor kontrolli të brendshëm, si dhe pasjen e një faqe zyrtare në internet për publikimin e programit të vet të transparencës etj) dhe miratimin e tyre nga NA – Drejtori i Përgjithshëm, të cilat orientojnë në zbatueshmërinë e gjithë procedurave të njësisë, konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim 1:** Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinatorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve dhe regjistrin e konsoliduar të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët standarde të auditimit me qëllim menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve në aktet ligjore/nënligjore dhe hapjen e faqes zyrtare në internet të DPOP Tiranë.

**Rekomandim 2:** Drejtorja e Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të marrë masa për të hartuar plane vjetore trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore.

**Rekomandim 3:** Nëpunësi Zbatues të ofrojë me përgjegjshmëri mbështetje të Nëpunësit Autorizues, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi, konform akteve ligjore/nënligjore për arritjen e objektivave institucionale.

## **2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

### **➤ Çështjet e audituara sipas pikës 2 të programit:**

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2020, 2021 dhe 2022 (8 mujori);

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

Fondet e shpenzuara nga DPOP Tiranë për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi;

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.);

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

### **➤ Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Bashkinë Tiranë;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Tiranë për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;

5. Shkresat përcjellëse në Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të pa likuiduara dhe të vendimeve gjyqësore;

6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar;

7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;

8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

**Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:**

**1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2021:**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2020-2022, PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, rezultoi se përgatitja e PBA – ve dhe e planeve vjetore janë realizuar duke u mbështetur në kërkesat buxhetore të drejtorive, pjesë e strukturës organizativet DPOP Tiranë. Fazat e përgatitjes nuk respektohen nga ana procedurale, por ka vetë respektim të afateve kohore. Kjo ngaqë në DPOP Tiranë nuk është ngritur GMS, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë përcaktuar në Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Titullari i institucionit, në cilësinë e NA duhet të krijojë GMS dhe të miratojë EMP. NA nuk ka krijuar dhe rrjedhimisht as mbledhur GMS për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve etj. Nga auditimi **u konstatua** se nuk janë ngritur dhe miratuar GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për DPOP Tiranë, të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku fokusohen në dy çështje kryesore: *së pari*, roli i ri i stafëve teknike në procesin buxhetor (përgatitja e PBA); *dhesë dyti*, aspektet konceptuale të programeve buxhetore, definimi i qëllimeve të politikave që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-se, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës. Referuar Fushës së Veprimtarisë së DPOP Tiranë, pasqyrohet një shpërndarje e programeve buxhetore për vitet 2020 e 2021 sipas funksioneve/nën funksioneve që NNJVQV/Bashkitë dhe njësitë në varësi të tyre janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuuar me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si në tabelë:

Ligji 139/2015-Neni	Funksionet e NJVQV / Bashki	Nën funksionet	Njësia në Strukturë/Programet Buxhetore për çdo nënfunkcion
Neni 23	Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike	<p>1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.</p> <p>2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.</p> <p>3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.</p> <p>4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.</p> <p>5. Ndriçimin e mjediseve publike.</p> <p>6. Transportin publik vendor.</p> <p>7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.</p> <p>8. Shërbimin e dekorit publik.</p> <p>9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.</p> <p>10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.</p> <p><b>11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.</b></p> <p><b>12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.</b></p> <p><b>13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</b></p> <p>14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>	<p><b>Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike</b></p> <p><b>Programi Buxhetor “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”</b></p>

Punoi: Grupi i Auditimit

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE/Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore”, VKB për dhënien me qera të ambienteve sportive të shkollave. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me njësitë e strukturës së DPOP, pasi nuk ka takime të dokumentuara, ku të vërtetohet.

➤ **Konsultimet me njësitë në strukturën e DPOP Tiranë dhe grupet e interesit:**

Nr.	PBA 2020-2022/ PV. Buxhet 2020	PBA 2021-2023/ PV. Buxhet 2021	PBA 2022-2024/ PV. Buxhet 2022
1	13.06.2019	27.10.2020	24.11.2021
	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

*Burimi: DPOP Tiranë*

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave nga drejtoritë dhe sektorët e strukturës së DPOP: Drejtoritë e strukturës, sektorët, drejtoritë e shkollave, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm, janë përzgjedhur ato më prioritare.

*Në lekë*

Njësitë në Strukturën e DPOP	PBA 2020-2022
	Vlera
Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Performancës	1.097.176.391
Drejtoria Ekonomike	
Drejtoria e Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit	PBA 2021-2023
Drejtoria e Mirëmbajtjes Godina Arsimore	Vlera
Drejtoria e Mirëmbajtjes, Lyerje, Godina Arsimore dhe Publike	1.072.685.429
Drejtoria e Mirëmbajtjes së Impianteve dhe Riparimit	
Drejtoria e Shërbimeve të DDD-së	PBA 2022-2024
Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në Përdorim të Komuniteteve	Vlera
Drejtoria Teknike dhe Transporti	1,350,681,037
<b>Totali</b>	<b>9</b>

*Punoi: Grupi i auditimit*

PBA-të dhe Buxheti Vjetor janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konform Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” .



## Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet:

Në lekë

Emërtimi	PBA 2020-2022		PBA 2021-2023		PBA 2022-2024		Buxheti 2020		Buxheti 2021		Buxheti 2022	
	Ardhur	Shpenz.	Ardhur	Shpenz.	Ardhur	Shpenz.	Ardhur	Shpenz.	Ardhur	Shpenz.	Ardhur	Shpenzime
Të ardhuratë trashëguara nga viti paraardhës												
Transferata e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës												
Trashëguar nga Transferata specifike												
Plani i të ardhurave ushtrimor	73.270.000		42.248.428		17.593.785		12.458.307		18.257.016.4		41,093,328	
Granti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transferata specifike		221.234.123		231.156.120		158.408.791		241.762.246		271.291.667		
Paga (600)		263.114.000		264.296.748		233.987.800		254.302.875		271.771.592		
Sigurime shoqërore (601)		80.847.000		82.740.629		62.967.937		80.036.000		85.468.444		579,352,500
Shpenzime operative (602)		355.877.000		358.685.000		368.500.000		576.141.967		520.065.920		
Transferata (604+606+609) Fondi Rezervë		22.002.000		23.272.643		1.527.749		1.877.739		2.166.032		400,000,000
Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtezuara		154.102.268		112.534.289		229.867.247		310.838.493		257.484.813		130,933,092
Investime nga FZHR e M. Linjës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)	-	--	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>73.270.000</b>	<b>1.097.176.391</b>	<b>42.248.428</b>	<b>1.072.685.429</b>	<b>17.593.785</b>	<b>1.055.259.524</b>	<b>12.458.307</b>	<b>1.464.959.320</b>	<b>18.257.016,4</b>	<b>1.408.248.468</b>	<b>41,093,328</b>	<b>1,151,713,410</b>

Burimi: DPOP Tiranë

Sipas të dhënave të pasqyrës, konstatohet se DPOP Tiranë plani i të ardhurave është në rënie, gjithashtu edhe plani i shpenzimeve ka trend rënieje. DPOP Tiranë si njësi varësie, burimin e financimit të shpenzimeve buxhetore e ka nga Bashkia Tiranë.

Viti	Plani Fillestar			Plani i ndryshuar (Progresiv)			Realizimi		
	Bashkia Tiranë	DPOP	%	Bashkia Tiranë	DPOP	%	Bashkia Tiranë	DPOP	%
<b>2019</b>	18,367,187,020	819,806,457	4.5	26,188,435,651	1,072,912,524	4.1	21,776,156,125	915,714,315	4.2
<b>2020</b>	20,404,027,959	1,064,372,689	5.2	33,951,456,682	1,464,959,320	4.3	24,533,116,535	1,155,104,823	4.7
<b>2021</b>	20,533,367,583	1,250,481,128	6.1	42,308,236,731	1,407,287,756	3.3	28,497,249,414	1,263,736,831	4.4
<b>2022</b>	23,608,964,062	1,110,285,592	4.7	41,503,833,124	1,350,681,037	3.3	21,608,970,195	1,151,713,410	5.3

Burimi: DPOP Tiranë

- Nga pasqyrimi i buxhetit të DPOP Tiranë dhe i Bashkisë Tiranë në tabelë më lart, rezulton se Plani i buxheti i Bashkisë Tiranë si ai fillestar, edhe i ndryshuar vjen në rritje nga viti në vit. Kështu në vitin 2020 është në vlerën 33,951,456,682 lekë me një diferencë prej (+) 13,547,428,723 lekë më shumë se ai fillestar; për vitin 2021 është në vlerën 42,308,236,731 lekë ose (+)21,774,869,148 lekë më shumë se ai fillestar; për vitin 2022 është në vlerën e 41,503,833,124 lekë ose (+)17,894,869,062 lekë më shumë se ai fillestar. Gjithashtu vërehet se kjo diferencë ka trend në rritje nga viti në vit.

- E njëjta situatë rezulton edhe për planet buxhetore të DPOP Tiranë. Plani i ndryshuar paraqitet në këto vlera të shtuara: për vitin 2020 me një diferencë (+)400,586,631 lekë , për vitin 2021 me një diferencë prej (+)156,806,628 lekë dhe për vitin 2022 me një diferencë prej (+)240,395,445 lekë. Plani fillestar i buxhetit të DPOP vjen me luhatje pasi vlera e tij rritet në vitin 2021 dhe zvogëlohet për vitin 2022; ndërsa vlera e planit buxhetor i ndryshuar vjen në rënie nga viti në vit;

- Realizimi i planit të buxhetit rezulton të jetë: për vitin 2020 realizimi faktik i buxhetit të DPOP është në masën 4.7% ndaj realizimit të buxhetit faktik të bashkisë; për vitin 2021 përbën 4.4 % dhe për vitin 2022 përbën 5.3% të realizimit faktik ndaj atij të bashkisë Tiranë. Ndërsa vetë Bashkia Tiranë paraqet këtë situatë realizimi: për vitin 2020 me 72.3%, për vitin 2021 me 67.4% dhe për vitin 2022 me 52.1%.

DPOP Tiranë për vitin 2020 ka planifikuar 1.464.959.320 lekë shpenzime, ndërsa për vitin 2021 ka planifikuar 1.408.248.468 lekë ose 56,710,852 lekë më pak se viti paraardhës.

*në mijë lekë*

N r	Burimet e Financimit	2020			2021			2022		
		Viti Plan	Fakt	%	Viti Plan	Fakt	%	Viti Plan	Fakt	%
1	Bashkia Tiranë	1,464,959,320	1,155,104,823	78.8	1,408,248,468	1,263,736,831	89.7	1,350,681,037	1,151,713,410	85.3

*Burimi: DPOP Tiranë*

Kështu shpenzimet me burim të ardhurat e Bashkisë, janë realizuar: për vitin 2020 në vlerën 1,155,104,823 lekë; për vitin 2021 në vlerën 1,263,736,831 lekë; për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 1,151,713,410 lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 309,854,497 lekë më pak se plani në vitin 2020 ose 78,8%; në vlerën 144,516,637 lekë më pak në vitin 2021 ose 89,7%; dhe në vitin 2022 janë shpenzuar 198,967,627 lekë më pak ose 85.3% e tij. Duke analizuar me kujdes shifrat në tabelë, vihet re se shpenzimet e planifikuara kanë një rënie prej (-)56,710,852 lekë më pak në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 dhe prej (-)57,567,431 lekë më pak në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021; ndërsa shpenzimet faktike kanë pësuar rënie me (-)108,632,008 lekë më pak se në vitin 2020 dhe me (-)112,023,421 lekë më pak se në vitin 2021. Nga analiza e të dhënave rezulton rënie e vlerave si në plan ashtu edhe në fakt të shpenzimeve të njësisë dhe raporti i tyre ka sjell luhatje të vlerave në realizimin e tyre.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, për çdo vit ushtrimor 2020, 2021 dhe 2022 rezulton se të ardhurat e shpenzimeve të planifikuara janë:

- Për vitin 2020 është 12,458,307.0 lekë (nga të ardhurat e bashkisë )
- Për vitin 2021 është 18,257,016.4 lekë
- Për vitin 2022 është 41,093,328.0 lekë

Viti	Plani fillestar	Plani i ndryshuar	Realizimi
2019	819.806.457	1.055.259.524	915.714.315
2020	1.064.372.689	1.464.959.320	1.155.104.823
2021	1.250.481.128	1.408.248.468	1.263.736.831
2022	1,110 285,592	1,350,681,037	1,151,713,410

*Burimi: DPOP Tiranë*

Pra buxheti fillestar për vitin 2020 është planifikuar në fillim në vlerën e 1,064,372,689 lekë, ka ndryshuar në 1,464,959,320 lekë dhe realizuar 1,155,104,823 lekë; për këtë vit kemi një rritje të planit të buxhetit me 400,586,631 lekë në krahasim me buxhetin fillestar;

Për vitin 2021 buxheti fillestar është 1,250,481,128 lekë dhe ai i ndryshuar në 1,408,248,468 lekë dhe realizuar me 1,263,736,831 lekë; në këtë vit kemi një rritje të vlerës së buxhetit me 157,767,340 lekë në krahasim me buxhetin fillestar. Ndërsa plani i buxhetit në vitin 2021 në krahasim me atë të vitit 2020 është *242,819,291 lekë më pak*.

Për vitin 2022 buxheti fillestar është 1,110,285,592 lekë dhe ai i ndryshuar në 1,350,681,037 lekë dhe realizuar me 1,151,713,410 lekë; në këtë vit kemi një rritje të vlerës së buxhetit me 240,395,445 lekë në krahasim me buxhetin fillestar. Ndërsa plani i buxhetit në vitin 2022 në krahasim me atë të vitit 2021 është *57,567,431 lekë më pak*.

Planifikimi i Buxheteve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 janë bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Tiranë.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Planit buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022 paraqiten sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Po kështu rezultoi se janë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitulli, artikulli e vlerë por **u konstatua** se transferimet/lëvizjet e ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor nuk janë shoqëruar me argumentimet e nevojshme si dhe për nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Të gjitha lëvizjet janë miratuar me Vendime të Këshillit Bashkiak.

**1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit periudhës nën auditim kemi këtë pasqyrë të buxhetit.

*Në lekë*

Nr i kodit	Emërtimi i Programit Buxhetor	2020		2021		2022	
		Viti Plan	Fakt	Viti Plan	Fakt	Viti Plan	Fakt
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1,824,334,642	1,263,199,100	2,974,122,038	1,653,478,734	1,248,370,271	1,151,713,410


*Burimi: DPOP Tiranë*

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.



Grafiku i planifikimit dhe realizimit të Buxhetit DPOP Tiranë

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitet 2020, 2021 dhe 2022 u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë viteve të periudhës nën auditim, buxheti i DPOP Tiranë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga qiratë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Tiranë janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Tiranë, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga sa më sipër, rezulton se kanë gjetur zbatim UMF nr. 1, datë 9.1.1996 “Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore” dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 “Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave”.

**Titulli i Gjetjes:** Planifikimi i programeve sipas nevojave institucionale.

**Situata 1:** Nga auditimi rezultoi se, nuk janë ngritur dhe miratuar GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për DPOP Tiranë, të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku fokusohen në dy çështje kryesore: *së pari*, roli i ri i stafeve teknike në procesin buxhetor (përgatitja e PBA); dhe *së dyti*, aspektet konceptuale të programeve buxhetore, definimi i qëllimeve të politikave që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-se, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës.

**2.** Për diskutimet rreth hartimit dhe prezantimin e PBA 2021-2023/ Projekt Buxheti Vjetor 2021 nga ana e DPOP nuk ka asnjë takim të dokumentuar me njësitë përbërëse të strukturës së saj apo dhe të DPOP me organin epror Bashkia Tiranë (fizik apo në platformën on-line), në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

**3.** Plani i buxhetit të DPOP në raport me planin e buxhetit të Bashkisë Tiranë, rezulton të jetë: për vitin 2020 plani fillestar i buxhetit të DPOP zë 5.2% të planit të Bashkisë Tiranë dhe 4.1 % ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2021 zë 6.1 % të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2022 zë 4.7% të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar. Pra vlera e raportit të planit buxhetor të ndryshuar të DPOP ndaj atij të Bashkisë Tiranë vjen në rënie;

**Kriteri:** Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualit MFK si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Tiranë.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e vëmendjes në planifikimin e fondeve në buxhetet vendore të organit epror- Bashkia Tiranë, për mallra/shërbime më prioritare në koherencë me nevojat e njësisë publike – DPOP si derivat i Planit të Zhvillimit Vendor dhe Strategjitë Kombëtare, ul efektivitetin në aktivitetin e funksioneve të Bashkisë për komunitetin, në moszbatim të përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.

**Shkaku:** Mungesa e GMS rezulton me mungesa të një analize të detajuar brenda njësisë lidhur me planifikimin dhe mos/realizimin të buxhetit në mbyllje të vitit ushtrimor dhe nxjerrja e detyrave për planifikimin e buxhetit vjetor dhe atë afatmesëm në vijim, të atyre programeve që i shërbejnë realizimit të objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Në DPOP Tiranë titullari i saj në cilësinë e NA të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik për realizimin e takimeve, ku të analizohet çdo tregues i mos/realizimit të buxhetit vjetor, të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato mallra e shërbime që janë pjesë e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së njësisë nga njëra anë dhe arritjes së objektivave të saj nga ana tjetër, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### **1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tiranë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktura nga transferata e

deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Emërtimi i shpenzimit	2020			2021			2022		
	Viti Plan	Fakt	%	Viti Plan	Fakt	%	Viti Plan	Fakt	%
600	496.065.121	441.403.114	89	543.063.259	481.581.445	88.7	624,639,487	619,385,487	99.2
601	80.036.000	72.571.468	90.1	85.468.444	76.197.515	89.2			
602	576.141.967	477.454.930	83	520.065.920	509.469.697	98	576,150,751	525,301,525	91.2
606-609	1.877.739	1.877.739	100	2.166.032	2.066.032	95.4			
230-231	310.838.493	163.946.286	52.7	257.484.813	196.797.035	76.4	149,890,799	84,248,231	56
	<b>1,464,959,320</b>	<b>759,953,537</b>	<b>51.9</b>	<b>1,408,248,468</b>	<b>1,266,111,744</b>	<b>90</b>	<b>1,350,681,037</b>	<b>1,151,713,410</b>	<b>85,3</b>
Mjete në ruajtje 466		6.953.033			3.590.832				

Burimi: DPOP Tiranë

#### ➤ Sipas burimeve të financimit:

Sipas burimeve të financimit: nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë, transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, nga transferta specifike, të ardhura të vetadhe donacione, treguesit e buxhetit janë realizuar si më poshtë:

Në lekë

Burimi i Financimit	%	Kap	Artikulli	Progresivi 12 mujor 2021		
				Plan	Celje	Fakt
<b>Nga Te Ardhurat e Bashkisë</b>				Planin_ Mujor	Celjen_ Mujore	Faktin_ Mujor
		5	600	271,771,592	265,720,192	261,422,575
		5	601	43,566,000	42,700,000	40,956,119
		5	602	520,065,920	520,065,920	509,469,697
		5	606	879,808	879,808	829,808
		5	231	243,804,871	184,746,050	184,578,149
		5	230		-	-
<b>Shuma</b>	<b>92.3</b>			<b>1,080,088,191</b>	<b>1,014,111,970</b>	<b>997,256,348</b>
<b>Nga Transferta e Pakushtëzuar</b>						
		1	600	-	-	-
		1	601	-		
		1	602	-		
		1	606	-		
		1	231	-		
		1	230	-		
<b>Shuma</b>	<b>0</b>			<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>Nga Transferta e Specifike</b>						
		1	600	271,291,667	271,248,877	218,125,041
		1	601	41,902,444	41,902,444	34,900,332

		1	602			
		1	606	1,286,224	1,286,224	1,236,224
		1	231	-	-	-
		1	230	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>80.8</b>			<b>314,480,335</b>	<b>314,437,545</b>	<b>254,261,597</b>
<b>Nga Transferta e Kushtezuar</b>						
		1	600	34,897,593		
		1	601			
		1	602			
		1	604			
		1	606			
		1	231			
<b>Shuma</b>	<b>0</b>			<b>34,897,593</b>	-	-
<b>Nga Burime te Veta</b>						
		6	600			
		6	601			
		6	602			
		6	606			
		6	231	12,719,230	12,218,886	12,218,886
		6	230			
		6	466			
<b>Shuma</b>	<b>96</b>			<b>12,719,230</b>	<b>12,218,886</b>	<b>12,218,886</b>
<b>Nga Donacione</b>			600	-		
			601			196,797,035
			602			
			606			
			231			
<b>Shuma</b>	<b>100</b>			<b>0</b>		196,797,035
<b>Totali</b>	<b>87.6</b>			<b>1,442,185,349</b>	<b>1,340,768,401</b>	<b>1,263,736,831</b>

Nga analiza e të dhënave në tabelë për *vitin 2021* rezulton se vlera totale e buxhetit të planifikuar është 1,442,185,349 lekë, ku burimi kryesor i financimit për buxhetin e DPOP është nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë në masën 1,080,088,191 lekë, transferta specifike 314,480,335 lekë dhe në vlera më të vogla nga burimet e veta dhe donacione; Ndërsa realizimi i buxhetit po sipas burimeve të financimit rezulton në total të jetë 1,263,736,831 lekë, ku peshën kryesore e zë ai nga burimet e veta në masën 96%, nga të ardhurat e bashkisë tiranë 92.3 % dhe transferta specifike 80.8%.

Burimi i Financimit	%	Kap	Artikulli	Progresivi 12 mujor 2022		
				Plan	Celje	Fakt
<b>Nga Te Ardhurat e Bashkisë</b>				Planin_Mujor	Celjen_Mujore	Faktin_Mujor
		5	600-601	282,673,549	277,419,549	276,741,447
		5	602-609	409,799,451	376,580,451	361,210,242
		5	230-231	149,390,455	86,053,033	84,248,231
<b>Shuma</b>	<b>62.7</b>			<b>841,863,455</b>	<b>740,053,033</b>	<b>722,199,920</b>
<b>Nga Transferta e Pakushtëzuar (Grant &amp; Transferta specifike)</b>						
		1	600-601	341,965,938	341,965,938	265,422,207
		1	602-609	166,351,300	166,351,300	164,091,283
		1	230-231	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>37.3</b>			<b>508,317,238</b>	<b>508,317,238</b>	<b>429,513,490</b>

<b>Nga Transferta e Kushtëzuar</b>						
		1	600-601	-	-	-
		1	602-609	-	-	-
		1	231	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>0</b>			<b>0</b>		
<b>Nga Burime te Veta</b>						
		6	600-601	-	-	-
		6	602-609	-	-	-
		6	230-231	-	-	-
		6	466	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>0</b>			<b>0</b>		
<b>Nga Donacione</b>		6	600	-	-	-
		6	602	-	-	-
		6	230-231	500,344	-	-
<b>Shuma</b>	<b>0</b>			500,344	-	-
<b>Totali</b>	<b>100</b>			<b>1,350,681,037</b>	<b>1,248,370,271</b>	<b>1,151,713,410</b>

Nga analiza e të dhënave në tabelë për vitin 2022 rezulton se vlera totale e buxhetit të planifikuar është 1,350,681,037 lekë, ku burimi kryesor i financimit për buxhetin e DPOP është nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë në masën 841,863,455 lekë, transferata e pakushtëzuar (grant & specifike) 314,480,335 lekë dhe në vlerë më të vogël nga donacione prej 500,344 lekë; Ndërsa realizimi i buxhetit po sipas burimeve të financimit rezulton në total të jetë 1,151,713,410 lekë, ku peshën kryesore e zë ai nga burimet të ardhurat e bashkisë Tiranë 62.7% dhe transferata e pakushtëzuar (grant & specifike) 37.3%.

#### ➤ Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore

Nga auditimi rezulton se Buxheti është realizuar: për vitin 2019 në vlerën 930,450,305 lekë; për vitin 2020 është planifikuar (progresivi) në vlerën 1.464.959.320 lekë dhe realizuar në vlerën 1,157,253,537 lekë me një diferencë të mosrealizimit prej (-)307,705,783 lekë ndaj planifikimit; Në këtë vit rezulton edhe vlera më e lartë e mosrealizimit.

për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 1.408.248.468 lekë dhe realizuar në vlerën 1,266,111,734 lekë me një diferencë të mosrealizimit prej (-)142,136,734 lekë ndaj planifikimit. Krahasuar me vitin 2019 dhe vitin 2020 është realizuar në vlera më të larta me 108,858,197 lekë më shumë se në vitin 2021 por me një plan buxheti që vjen në rënie.

për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 1,350,681,037 lekë dhe realizuar në vlerën 1,151,713,410 lekë me një diferencë të mosrealizimit prej (-)96,656,861 lekë ndaj planifikimit. Krahasuar me vitin 2019 dhe vitin 2020 është realizuar në vlera më të larta me 108,858,197 lekë më shumë se në vitin 2021 por me një plan buxheti që vjen në rënie.

në lekë

2019 Fakt	2020			2021			2022			Trend
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.	
930,450,305	1.464.959.320	1,157,253,537	307,705,783	1.408.248.468	1,266,111,734	142,136,734	1,350,681,037	1,151,713,410	96,656,861	↓

Burimi: DPOP Tiranë

#### ➤ Miratimi i buxhetit faktik:

Në fund të periudhës ushtrimore, DPOP Tiranë si njësi e varësisë së Bashkisë Tiranë ka miratuar buxhetin e përgjithshëm faktik në Këshillin Bashkiak, për vitet 2020, 2021 e 2022 bashkë me hartimin e PBA-së. Në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë të detajuar për nivelet e realizimit të fondeve si dhe me rekomandime për përmirësimin e situatës.



➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Bashkinë e Tiranës për raportimin në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt. 30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44<sup>9</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezultojnë të jetë bërë raportim në MFE çdo 4 mujor dhe raportimi vjetor sipas formateve të përcaktuara nga MFE, me informacion statistikor të plotë dhe të renditur në tabelat e miratuara nga MFE. Këto raportime janë dërguar në MFE dhe në Bashkinë Tiranë si organi epror i DPOP në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në afat dhe që grupit të auditimit iu vu në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike.

➤ **Realizimi i Investimeve:**

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2019, 2020 dhe 2021 për DPOP Tiranë, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara", pasqyrohet në tabelën më poshtë:

*Në lekë*

2019		2020		2021			2022		
Fakt	Plan	Fakt	Diferenca	Plan	Fakt	Diferenca	Plan	Fakt	Diferenca
206.201.487	310.838.493	163.946.286	133.440.403	257.484.813	184.578.149	59.454.873	149.890.799	84.248.231	1.804.800

*Burimi; DPOP Tiranë*

➤ **Fondet e shpenzuara nga njësitë vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga DPOP Tiranë gjatë vitit 2020 janë kryer shpenzime të nevojshme specifike të situatës në vlerën totale prej 107,399,787 lekë të vërtetuara me 20 Urdhër shpenzime; për vitin 2021 janë shpenzuar 196,100,863 lekë me 32 Urdhër shpenzime të cilat në total janë në vlerën e 303.500.650 lekë. Informacioni i detajuar mbi urdhër shpenzimet, përshkrimet dhe vlerën e shpenzimit pasqyrohet *Aneksin nr. 1, tabela 1.*

**1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministrinë e linjës etj).**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e bashkisë apo me burime të tjera, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

<sup>9</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive për vitet 2020, 2021 dhe 2022 paraqiten në pasqyrat e mëposhtme:

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi deri më 31.12.2019	Detyrimi krijuar gjatë vitit 2020	Total detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorit të parë të 2020	Detyrimi deri në 31.12.2020
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës					
b. Investime nga Bashkia	1.229.375	26.086.365	27.315.740	0	26.086,365
<b>Investime</b>	<b>1,229,375</b>	<b>26,086,365</b>	<b>27,315,740</b>	<b>0</b>	<b>26,086,365</b>
Mallra dhe shërbime	34,597,643		34,537,643	18,521,893	
Vendime gjyqësore					
Të tjera ...					
<b>Totali</b>	<b>35,767,018</b>	<b>26.086.365</b>	<b>61,853,383</b>	<b>18.521,893</b>	<b>26,086,365</b>

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi deri më 31.12.2020	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021	Total detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorit të parë 2021	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës	-	-	-	-	-
b. Investime nga Bashkia	26,086,365	14,118,941	40,205,306	9,523,920	14,118,941
<b>Investime</b>	<b>26,086,365</b>	<b>14,118,941</b>	<b>40,205,306</b>	<b>9,523,920</b>	<b>14,118,941</b>
Mallra dhe shërbime		1,218,215	1,218,215		1,218,215
Vendime gjyqësore					
Të tjera ...					
<b>Totali</b>	<b>26,086,365</b>	<b>15,337,156</b>	<b>41,423,521</b>	<b>9,523,920</b>	<b>15,337,156</b>

Burimi: DPOP Tiranë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total Detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorit te parë 2022	Mbetja në fund të vitit 2022
a	1	2	3=1+2		4
a. Investime nga Ministritë e linjës					
b. Investime nga Bashkia	14.118.941	3,291,840	17,410,781		
<b>Investime</b>	<b>14,118,941</b>	<b>3,291,840</b>	<b>17,410,781</b>	<b>0</b>	
Mallra dhe shërbime	1.218.215	728,857	1,947,072	1,218,215	728,857
Vendime gjyqësore					
Të tjera ...					
<b>Totali</b>	<b>15.337.156</b>	<b>4,020,697</b>	<b>19,357,853</b>	<b>1,218,215</b>	<b>728,857</b>

Burimi: DPOP Tiranë

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të vitit çdo viti ushtrimor, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha. Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojnë edhe vlerat e sakta të detyrimeve. Nga analiza e të dhënave vërehet se detyrime të prapambetura janë vetëm për “investime nga Bashkia Tiranë” dhe për “mallra e shërbime”; Rezultoni gjithashtu se nuk ka detyrime për “vendime gjyqësore” dhe “të tjera” pasi siç na u bë me dije nga institucioni çdo detyrim i ardhur për vendime gjyqësore të nisura më parë likujdohen nga fondet buxhetore që disponon në vitin ushtrimor.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike.

Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 106, ku citohet:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që **jo më vonë se data 10 Prill 2020** për tremujorin e parë, **10 Korrik 2020** për tremujorin e dytë, **10 Tetor 2020** për tremujorin e tretë dhe **30 Janar 2021** për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi.”

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

- Totali i detyrimeve të pa likuiduara për vitin 2019 është 35,767,018 lekë,

- për vitin 2020 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 26,086,365 lekë dhe janë shlyer 57.8% e vlerës totale të detyrimit.

- Për vitin 2021 vërehet krijimi i detyrimeve të reja në vlerën e 15,337,156 lekë dhe janë shlyer 63% e vlerës totale të detyrimit, duke trashëguar në vitin 2022 vlerën prej 15,337,156 lekë.

- Për vitin 2022 vërehet krijimi i detyrimeve të reja në vlerën e 4,020,697 lekë dhe janë shlyer 96% e vlerës totale të detyrimit, duke trashëguar në vitin 2023 vlerën e 728,857 lekë.

➤ **Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore:**

Nga auditimi i likuiditeteve rezulton se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022 për: “investime nga bashkia” dhe “shërbime e mallra”, kjo për arsye se nga DPOP nuk janë bërë planifikime të përllogaritura në mënyrë që të bëhet e mundur likuidimi i çdo fature shërbimi apo mallrash brenda vitit ushtrimor; gjithashtu kjo ndodh edhe për faktin e mungesës së konsultimeve dhe diskutimeve me bashkinë Tiranë për planifikimin e buxhetit të DPOP-së.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore.

**Situata 1** Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 52.7% deri në 100% për vitin 2020, nga 76.4% deri 98% për vitin 2021, nga 56 % deri 99.2% për vitin 2022; por gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit për llog. 600, llog. 601 dhe llog 606 vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022, ndërsa niveli i realizimit të po këtyre zërave vjen në rënie (përfshijtur llog 600-601); për llog 602 dhe llog 230-231 niveli i planifikimit vjen në rënie ndërsa niveli i realizimit vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe në rënie për vitin 2022. Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka DPOP dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2020 e zënë shpenzimet për llog. 602 e ndjekur nga llog. 600-601, për vitin 2021 e zënë shpenzimet e llog. 600 –601 e ndjekur nga llog 602; edhe për vitin 2022 peshën specifike e zë llog 600-601 e ndjekur nga llog. 602. Kjo tregon një rritje të planifikimit të shpenzimeve për zërin buxhetor “paga personeli” për shkak të trendit në rritje që paraqet planifikimi dhe realizimi për rekrutime si dhe për një planifikim të vlerave buxhetore në rënie për investime.

**2.** Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit e të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave nga bashkia dhe shpenzimeve të tyre, që do të thotë se nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, ka diferenca të dukshme të cilat janë pasqyruar edhe në tabelë, duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie.

**3.** Referuar tabelës rezultoi se, realizimi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta: për vitin 2019 është realizuar në vlerën e 206,201,487 lekë; në vitin 2020 në vlerën e 163,946,286 lekë ose 52.7% e fondeve të planifikuara dhe me një diferencë prej (-)42,255,201 lekë më pak nga viti 2019; ndërsa për vitin 2021 realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 184,578,149 lekë ose 71.7% e fondeve të planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të lartë realizimi se ajo në vitin 2020 me (+)20,631,863 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2020; ndërsa për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 84,248,231 lekë ose 56.2% e fondeve të

planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të ulët realizimi se ajo në vitin 2021 me (-)100,329,918 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2021.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia dhe njësitë e varësisë nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

**4.** Lidhur me detyrimet e prapambetura nga auditimi rezultoi se: likuiditeti i detyrimeve të prapambetura në total për “investime nga bashkia” dhe “mallra e shërbime” të marra së bashku, është i vogël por ka trend në rritje; situatën e përkeqëson krijimi i detyrimeve të reja për këta zëra buxhetorë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, Ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak;

**Ndikimi/Efekti:** Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të njësisë publike për një veprimtari normale në arritjen e objektivave të saj në shërbim të komunitetit, si dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe njësisive në varësi të saj, në drejtim të këtyre shërbimeve.

**Shkaku:** Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mos nxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi 1:** Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse të buxhetit në bashkinë Tiranë, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

**Rekomandimi 2:** Drejtoria Ekonomike pranë DPOP, Bashkia Tiranë, të marrë masa për likuidimin në kohë të detyrimeve vjetore ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu në planifikimin e buxhetit, më parë të planifikohen fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndër vite, sipas një plani të miratuar, me qëllim uljen në maksimum të tyre.

**2.2.6. “Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi dhe zbatimi i kontratave”.**

## **1.Kontratat për banesat sociale.**

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.33 datë 18.11.2013 “Për Menaxhimin e Banesave Sociale me Qira, në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social” në zonën e Shkozës, “ish Fonderia-Mek” të ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.52, datë 11.11.2015, është përgjegjëse për administrimin e Banesave Sociale në zonën e Shkozës, ish - “Fonderia-Mek”, funksion i cili mbështetet në një kuadër ligjor e nënligjor në fuqi.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 28 datë 13.08.2015 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 44 datë 06.07.2016 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish - “Fonderia Mek”, është bërë shpërndarja e banesave sociale për 385 përfituesit e programit social.

Enti menaxhues lidh kontratën e qirasë mes banorit përfitues dhe Bashkisë Tiranë, bazuar në Vendimet e Këshillit Bashkiak për *“Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish - “Fonderia Mek”*. Në këtë kontratë me afat 1 vjeçar janë të përcaktuara saktë të drejtat dhe detyrimet e palëve që lidhin një marrëveshje kontraktuale. Enti menaxhues bën rilidhjen vit pas viti të kontratës së qirasë për familjet që rezultojnë të rregullta me shlyerjen e detyrimeve. Akomodon familjet përfituese në banesat e përcaktuara sipas listës së miratuar në VKB përkatëse. Pas zbardhjes së VKB-së përkatëse bëhet akomodimi i familjeve përfituese në banesat e përcaktuara sipas listës së miratuar dhe nënshkrimi të akt-marrjes në dorëzim të banesës në të cilën është e përcaktuar inventari fizik i banesës (në momentin e dorëzimit të apartamentit inventari fizik duhet të jetë në përputhje me aktin e marrjes në dorëzim).

Zgjidh kontratën e qirasë, në rast të shkeljes së detyrimeve dhe kushteve të parashikuar në kontratë. Mbledhja dhe monitorimi i pagesave të qirasë. Familjet që janë përfitues të banesave sociale paguajnë një vlerë qiraje të miratuar në KB sipas të ardhurave të deklaruara dhe hapësirës në të cilën ato banojnë si dhe të subjekteve tregtare/zyra/OJQ etj në ndërtesë, nëse ka të tillë. Pagesa e qirasë bëhet çdo fillim muaji në bankë me një numër llogarie të miratuar sipas VKB-së Nr.52, datë 11.11.2015 për *“Hapjen e një numër llogarie ku do të bëhet pagesa e qirasë mujore”*.

Verifikon pagesat ndaj detyrimeve me operatorët ose ofruesit e shërbimeve që kanë kontratë me Bashkinë Tiranë (OSHEE-UKT, etj).

Administron dosjet e kontratave të qirave dhe raporteve të detajuara financiare të qiramarrësve.

-Struktura përgjegjëse për ndjekjen e kontratave të banesave sociale është Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, ku në bazë të rregullores së brendshme të institucionit:

- ✓ Ndjek dhe zbaton procedurat ligjore për kontratat e qirasë midis banorëve përfitues dhe BT sipas VKB respektive.
- ✓ Ka përgjegjësi për administrimin e procesit që lidhet me trajtimin e subjekteve të programit të përfituesve të banesave sociale me qira, kontrollit të kritereve, për përfituesit e këtij programi, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të qirave përfshirë të gjitha kushtet. Kriteret si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtyre kontratave.
- ✓ Koordinon punën për administrimin e kontratave të qirave dhe dokumentimin e vjeljes së të ardhurave, ndjekjen dhe mbrojtjen ndaj debive dhe çdo veprim tjetër në këtë drejtim, duke bashkëpunuar dhe përcjellë informacion me strukturat përgjegjëse dhe të financës, si dhe me institucionet dhe organet e tjera përgjegjëse për këtë proces, përfshirë dhe ato të Bashkisë Tiranë.

- ✓ Përgatit raport të prapambetjeve të qirave mujore, liston të gjithë debitorët e vonuar dhe shumat që ata detyrohen dhe tregojnë masat e mara për sigurimin e arkëtimit të shumave të papaguara, përfshirë edhe procedimin për ndërprerjen e kontratave të qirasë dhe lirim të ambienteve.
- ✓ Harton shkresa për anulimin e njëanshëm të kontratave për familjet të cilat nuk frekuentojnë banesën për një kohë të gjatë.
- ✓ Bashkëpunon me policinë bashkiake për hapje apartamenteve të braktisura.
- ✓ Harton dhe koncepton njoftimet individuale për familjet që janë debitorë në lidhje me qiranë.

*Struktura përgjegjëse, Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ka për detyrim të ndjekë dhe të marrë të gjitha masat për zbatimin e kontratave të qirasë, përfshirë edhe të drejtën për zgjidhjen e tyre në momentin e konstatimit të shkeljeve apo rinovimin e tyre pasi të jenë verifikuar kushtet dhe kriteret që e bëjnë të mundur rinovimin e kontratës së qirasë, pa e çuar procesin drejt një problematike të akumuluar, mekanizmat e së cilës gjenden në vetë përmbajtjen e kontratave të qirave.*

*Për qiramarrësit debitorë, qiradhënësi duhet të kishte vijuar me zgjidhjen e kontratave. në përputhje me pikën e) dhe f) të nenit 11.2 të kontratës, për shkaqet e zgjidhjes para kohe të saj.*

- **Efekti financiar i mosmenaxhimit efektiv të vjeljes së detyrimeve nga kontratat e dhënies me qera të Banesave sociale.**

Mungesa e bashkëpunimit mes DPOP Tiranë me Drejtorinë e Strehimit Social/Bashkia Tiranë, është arsyeja bazë e krijimit dhe thellimit të problematikës nga viti në vit. Nga ana e DPOP nuk rezultojnë të jenë bërë analiza pune mbi situatën e krijuar, por janë mjaftuar vetëm me vënien në dijeni të Organit Epror – Bashkia Tiranë. Kështu, për vitin 2017 janë 297 debitorë me vlerën e detyrimit 19,306,264 lekë; për vitin 2018 janë 330 debitorë me shumë e debisë prej 36,275,766 lekë, për vitin 2019 janë 331 debitorë me vlerën e detyrimit prej 57,472,830 lekë; për vitin 2020 janë 338 debitorë me vlerën e detyrimit në 28,445,386 lekë; për vitin 2021 janë 305 debitorë në vlerë të detyrimit prej 22,144,145 lekë. Në Total detyrimi për 5 vjet është në vlerën e 100,589,491 lekë. Rënia e numrit të debitorëve ka ardhur si rezultat i largimit nga banesa (boshatisjes së saj) nga ana e qiramarrësve dhe jo për marrjen e masave shtrënguese nga njësi përgjegjëse. Kjo ka sjellë dhe zvogëlimin e vlerës së detyrimit nga viti në vit, por ngelet e lartë vlera totale e detyrimit e akumuluar prej 5 vjetësh, shumë kjo e konsiderueshme për buxhetin e bashkisë, ndonëse përbëhet nga tarifa modeste të pajustificueshme për tu mos u paguar në kohë por edhe për tu mbartur nga ana e qiramarrësve.

**Titulli gjetjes:** Mbi menaxhimin dhe zbatimin e kontratave për dhënien me qira të banesave sociale. Detyrimet e prapambetura.

**Situata:** 1. Nga Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, nuk janë marrë masa për zgjidhjen e kontratave për subjektet përfituese të banesave sociale, të cilat nuk kanë likuiduar detyrimet e qirasë sipas kontratës së lidhur.

2. Kontratat e lidhura me afat 1 vjeçar, nuk janë rinovuar pas përfundimit të këtij afati. Nuk kanë bashkëpunuar strukturat e ngarkuara sipas VKB-së Nr.109 datë 27.09.2018, pasi Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, Komisionit të Strehimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë, nuk kanë dalë me vendimmarrje për rivlerësimin e mëtejshëm të kriterëve të përfituesve, kusht i cili përcakton edhe rinovimin e kontratave.

3. Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, rezulton se nuk administron apo evidenton braktisjen e banesave nga qiramarrësit në momentin e largimit të tyre, duke krijuar edhe detyrime fiktive përtej afatit 1 vjeçar të kontratës.

4. Nga auditimi, rezulton debi e akumuluar është në vlerën 100,589,491 lekë<sup>10</sup>, nga të cilat,

- Për vitin 2017 janë 297 debitorë me vlerën e detyrimit 19,306,264 lekë;
- Për vitin 2018 janë 330 debitorë me shumë e debisë prej 36,275,766 lekë;
- Për vitin 2019 janë 331 debitorë me vlerën e detyrimit prej 57,472,830 lekë;
- Për vitin 2020 janë 338 debitorë me vlerën e detyrimit në 28,445,386 lekë;
- Për vitin 2021 janë 305 debitorë në vlerë të detyrimit prej 22,144,145 lekë;

-Rezulton se është krijuar debi ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë.

-Nga ana e saj Drejtoria e Strehimit ka raportuar në Bashkinë Tiranë, por mbajtja e statusit “raportim” jo vetëm që nuk ka sjellë marrjen e masave për zgjidhjen e problemit, por ka rezultuar me rritjen e numrit të debitorëve dhe të vlerës së detyrimit. Ky detyrim i përket kontratave me tarifa të pa përditësuara, të cilat janë modeste dhe të përballeshme nga përfituesit. Mungesa e bashkëpunimit mes DPOP Tiranë me Drejtorinë e Strehimit Social/Bashkia Tiranë, është arsyeja bazë e krijimit dhe thellimit të problematikes nga viti në vit.

5. Rezulton se 12 familje<sup>11</sup> janë akomoduar duke mos qenë pjesë e listës sipas VKB-së Nr.28 datë 13.08.2015 dhe VKB-së Nr.44 datë 06.07.2016 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të Banesave Sociale me qira”, për të cilët nuk disponohet asnjë kontratë e lidhur dhe detyrimet bashkëlidhur saj.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. A. S. – Drejtor dhe znj. O. T., përgjegjëse sektori, në Drejtorinë e Administrimit të Banesave Sociale.

**Kriteri:** Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VKB Nr. 28 datë 13.08.2015 “Për përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish Fonderia Mek”; VKB Nr. 44 datë 06.07.2016 “Për përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish Fonderia Mek”; VKB Nr.62, datë 30.12.2015 për “Miratimin e Komisionit të Strehimit”; VKB nr.43, datë 20.11.2012 për “Miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e banesave sociale me qira dhe sistemin e pikëzimit për bonusin e strehimit” (i ndryshuar),

VKB nr.110, datë 27.09.2018 për “Përcaktimin e vlerës minimale e maksimale të të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira, në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social” në zonën e Shkozës, ish-Fonderia Mek”; Rregullorja e Brendshme e DPOP (ish Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit) miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 21334/1Prot., datë 15.06.2022 për “Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës të DPOP-së si dhe rregulloret e mëparshme të DPOP; VKB-ja nr.109 datë 27.09.2018 për “Miratimin e Draft Kontratës së Qirasë dhe Akt-Marrëveshjes Tip që do të lidhen midis Bashkisë Tiranë dhe Debitorëve Përfitues të Programit të Banesave Sociale me Qira, në Zonën e Shkozës, Ish-Fonderia Mekanike”; Kontratat e testuara nga grupi i auditimit.

**Ndikimi/Efekti:** Menaxhim jo efektiv i banesave sociale. Detyrime të prapambetura në vlera të konsiderueshme që lidhen me mungesën e likuidimit të qirave dhe të detyrimeve ndaj OSHEE dhe UKT.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

**Rekomandim 1:** Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, në bashkëpunim me strukturat e ngarkuara sipas VKB-së nr. 109, datë 27.09.2018, të marrë masa në drejtim të rivlerësimit dhe

<sup>10</sup> Lista e debitorëve në aneksin nr. 2, tabela 1.

<sup>11</sup> Lista e 12 familjeve në aneksin nr. 2, tabela 2

rinovimit të kontratave për përfituesit e qirave të banesave sociale, kjo për të përcaktuar edhe detyrimin e duhur të vlerës së qirasë për përfituesit e tyre.

**Rekomandim 2:** Për 12 familjet të cilat janë strehuar në banesat sociale të cilët nuk janë pjesë e listës së miratuar me VKB, t'i nënshtrohen procedurave përkatëse nëse e përfitojnë ose jo banesën sociale. Të evidentohen me procesverbalin përkatës nëpërmjet strukturave të ngritura pranë kësaj drejtorie, largimet/braktisjet e banesave nga përfituesit e tyre.

**Rekomandim 3:** Nga DPOP, Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Banësive Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të qerasë dhe të marrin masa për hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore, me qëllim arkëtimin e vlerave të debitorëve në shumën 100,589,491 lekë, dhe pagesën e vlerave të detyrimit ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

## **2.Kontratat e palestrave në kuadër të projektit “Shkolla qendër komunitare”**

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 7 datë 31.01.2018 “Për miratimin e e përdorimit të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”, është miratuar Projekti “Shkollat si Qendër Komunitare”, ku ndër të tjera:

- Në pikën 3 të vendimit, është miratuar se përdorimi i palestrave dhe ambienteve të tjera rekreative bëhet përkundrejt pagesës së tarifës së përcaktuar në vendimin nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës , të ndryshuar, dhe **struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit (sot DPOP)** dhe sipas akt-rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë në llogari të Bashkisë Tiranë.
- Në pikën 4 të këtij vendimi është miratuar **marrëveshja trepalëshe “Tip” ndërmjet Bashkisë së Tiranës, Drejtorisë së Shkollës dhe Federatës/ Shoqatës Sportive** që do të rezultojë fituese pas përfundimit të procesit të konkurrimit.

Projekti “Shkollat Qendër Komunitare”, në përdorimin e palestrave dhe hapësirave të tjera të dedikuara shkollave të ciklit 9 - vjeçar dhe atij të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas orarit të rregullt mësimor dhe në ditët e pushimit, ka si qëllim:

- Promovimi dhe implementimi i sporteve si një mundësi edukimi fizik dhe argëtimi për fëmijët e shkollave të ciklit 9 -vjeçar dhe atij të mesëm.
- Ndihmesën në zhvillimin e shëndetit, zhvillimin e cilësive fizike, shprehive motorike e koordinative si dhe në vlerat shoqërore të fëmijëve duke ushtruar një sport.
- Formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor, si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin dhe zhvillimin e miqësive ndërmjet nxënësve duke u përfshirë në aktivitete sportive.
- Rritja e mundësisë së përfshirjeve dhe realizimit të garave sportive në dobi të shëndetit dhe zhvillimit të aftësive motorike dhe në shërbim të rritjes së cilësisë.
- Rritja e interesit të fëmijëve ndaj sporteve.

Përgjatë viteve 2020-2022 janë lidhur 65 marrëveshje, të trajtuara gjerësisht në aneksin nr. 2, tabela 3.



**Në Rregulloren Nr. 14763/1 datë 12.04.2021, e në vijim** është përcaktuar struktura e ngarkuar për ndjekjen e Projektit “Shkolla qendër Komunitare”, përkatësisht Drejtoria e Aseteve, Inventarizimit dhe Koordinimit, e cila është përgjegjëse dhe mbikëqyr projektin duke menaxhuar veprimtaritë sportive në palestrat dhe fushat e sportit të institucioneve arsimore ku zhvillohen aktivitetet sportive dhe çfarë përmban realizimi i këtij projekti, duke zbatuar në terren marrëveshjet dhe zbatimin e detyrave të marra përsipër përmes kontratave të qirave me subjektet përkatëse. Ndërkohë Sektorit i Koordinimit të Objekteve shkollore ka të përcaktuar qartë detyrat në kuadër të projektit.

Janë administruar në drejtori, procesverbalet për çdo muaj të vitit 2020-2022, që pasqyrojnë kalendarin për datat dhe numrin total të orëve të zhvillimit të aktivitetëve sportive, pra shfrytëzimit të ambienteve sportive.

**Titulli gjetjes:** Mbi monitorimin e zbatimit të kontratave për përdorimin e palestrave të shkollave për aktivitetet sportive.

**Situata:** 1.Nga dokumentacioni konstatohet se në disa nga marrëveshjet e lidhura përgjatë viteve 2020 dhe 2021 mungon firma e Drejtorisë së Shkollës, gjë që bie në kundërshtim me pikën 4 të VKB Nr. 7 datë 31.01.2018, që ka vendosur miratimin e marrëveshjes trepalëshe “TIP” ndërmjet Bashkisë së Tiranës, Drejtorisë së Shkollës dhe Federatës/Shoqatës Sportive fituese.

2.Në kontratat e lidhura nga Bashkia Tiranë nuk është përcaktuar qartë ambienti (lloji dhe sipërfaqja e tij) i cili do jepet me qira, për të bërë të mundur saktësimin e vjeljes së tarifës përkatëse në bazë të nenit 73 të Vendimi Nr. 158 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.

3.Nga analiza e të dhënave në tabelë, rezulton parregullsi e vjeljes së detyrimit nga njësia përgjegjëse. *Mungesa e një baze të plotë rregullatore e DPOP Tiranë.* Lista e proceseve të punës, regjistri i riskut etj, ka sjellë si rezultat mos ndarje të qartë të detyrave për zbatim të kontratës së lidhur mes palëve për procedurën e vjeljes së qerasë nga personat qiramarrës. Nga ana e DPOP nuk rezultojnë të jenë bërë analiza pune mbi situatën e krijuar, por janë mjaftuar vetëm me vënien në dijeni të Organit Epror – Bashkia Tiranë. Për vitin 2018 janë 15 debitorë me shumën e detyrimit 232,130 lekë; për vitin 2019 janë 9 debitorë me shumën e detyrimit 59,475 lekë nga të cilët 3 debitorë janë të trashëguar nga viti 2018 në shumën e 29,475 lekë; për vitin 2020 janë 50 debitorë me shumën e detyrimit 1,012,025 lekë; për vitin 2021 janë 38 debitorë me shumën e detyrimit 514,500 lekë. Në total detyrimi i pa vjelë nga debitorët për 4 vjet është 1,526,525 lekë, shumë kjo e konsiderueshme për buxhetin e bashkisë, ndonëse përbëhet nga tarifa modeste të pajustificueshme për tu mos u paguar në kohë por edhe për tu mbartur nga ana e qiramarrësve.

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. K. L. - Drejtor dhe zj. A. S. – Përgjegjëse Sektori, Drejtoria e Koordinimit të Shkollave.*

**Kriteri:** Vendimi nr. 59 datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës, të ndryshuar; Vendimi Nr.205 datë 2017 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.

Vendimi Nr. 158 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës (Kreu XII, Neni 3 - Baza dhe niveli i tarifës (pikat 1.2.3.4.5). Kontratat e lidhura mes palëve.

**Ndikimi/Efekti:** Menaxhim jo eficient i dhënies së palestrave me qira, dhe detyrime të prapambetura në vlerën 1,526,525 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tiranë.

**Shkaku:** Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Biznes”, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të bashkisë, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga STTV Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandimi 1:** DPOP për kontratat e lidhura për palestrat, të qartësojë me Bashkinë Tiranë si organ epror, vlefshmërinë e tyre kur konstatohen parregullsi në mos përputhje me VKB Nr. 7 datë 31.01.2018, që ka të bëjë me marrëveshjen Tip dhe tarifën përkatëse sipas objektit për të cilën janë lidhur këto kontrata. Të gjitha kontratat që do lidhen në vijim, të përcaktojnë saktë edhe sipërfaqet e dhëna me qira, kjo për të përcaktuar vlerën e saktë që duhet të paguajnë përdoruesit e tyre.

**Rekomandimi 2:** Nga DPOP Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Aseteve e Koordinimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të tarifës për palestrat shkollore të dhëna në përdorim dhe të marrin masa në hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore me qëllim përmirësimin e situatës për të arkëtuar vlerën e plotë të detyrimit prej 1,526,525 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

### **3.Kontratrat e vendstrehimeve**

Ligji nr.7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ngarkon Ndërmarrjen Komonale Banesa (ndryshuar emërtimi në Drejtori Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit) sot DPOP, me të drejtën për të kaluar në proces privatizimi apartamentet shtetërore që administronte, duke bërë një ndarje të kategorive të banesave, e duke përcaktuar që për apartamentet e banimit të disponohej me privatizim në interes të familjarëve që i posedonin ato me kontratë të rregullt qiraje, në periudhën para daljes së ligjit, ndërsa për bodrumet me Udhëzim të Këshillit të Ministrave nr.1/1993 që doli për zbatimin e ligjit nr.7652/1992 “Për privatizimin e banesave” dhe konkretisht të pikës 20 të këtij udhëzimi u disponua që në lidhje me bodrumet të cilat posedoheshin nga subjektet në kontratë qiraje, këto të fundit ti nënshtroheshin privatizimit ndërsa për bodrumet që nuk reflektoheshin në kontratat e qirave, bodrumet të trajtoheshin në një kohë të dytë nga ana e bashkive ose komunave që i kishin ato në administrim.

Pra kështu u vendos një ndarje ndërmjet procesit të privatizimit që përfshinte apartamentet dhe bodrumet bashkëlidhur në kontratat e qirave dhe procesit të vijimit të administrimit në kuadrin e dhënies më kontrata qiraje për bodrumet që nuk ishin reflektuar në kontratat e qirave të apartamenteve që ju nënshtroan procesit të privatizimit. Ky rregullim i posaçëm u reflektua edhe me vendimmarrje nga ana e Bashkisë Tirane e cila me anë të shkresës nr.2365 datë 05.03.1994 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Privatizimit për Tiranën, u procedua që të bëhej privatizimi i bodrumeve për ata qytetarë të cilët i kishin të reflektuara në kontratat e qirave të apartamentit të banimit, ndërsa për bodrumet për të cilat nga ana e ndërmarrjeve komunale ishte lidhur kontratë provizore për strehim në këto bodrume (të përshtatura për banim), këto të fundit do të trajtoheshin në një kohë të mëvonshme (*theksojmë se në këtë periudhë Tirana kishte tre ndërmarrje komunale-banesa të cilat u bashkuan në një të vetme me VKB Nr.82/1 datë 28.06.1996, ndërsa një e katërt nga këto ndërmarrje i kaloi juridiksionit të Bashkia Kamëz*).

Me ndryshimet strukturore që preken ish-Ndërmarrjen Komonale Banesa,, me VKB Nr.15 datë 10.03.2004, Ndërmarrje Komonale Banesa ndryshon emërtim në Drejtori Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit (sot DPOP), ndërsa me VKB Nr.29 datë 29.08.2008, kësaj të fundit ju ri caktua përgjegjësia për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të privatizimit të (vetëm) të banesave shtetërore, ndërsa për bodrumet që parashikoheshin të trajtoheshin si më sipër, këto të fundit mund t'i nënshtroheshin procesit të privatizimit sipas specifikimeve të sqaruara më sipër, dhe që përfshinin vetëm bodrumet të cilat pasqyroheshin në kontratat e qirave të apartamentit ose bodrumet të cilat ishin përshtatur për banim dhe për të cilat, autorizimi provizor ishte kthyer me vendim të organit kompetent të bashkisë në autorizime definitive.

Pra në përmbledhje, bodrumet u janë nënshtruar dy lloj proceseve pas daljes së ligjit nr.7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, së pari, procesit të privatizimit që ka përfshirë bodrumet të cilat qytetarët i kanë poseduar dhe i kanë pasur të pasqyruara në kontratat e qirave të apartamentit të cilat janë privatizuar së bashku me apartamentin, përfshirë këtu edhe bodrumet e dhëna me autorizim provizor, të përshtatura për banim dhe ku më pas autorizimet janë kthyer në definitiv për t’i hapur rrugë procesit të privatizimit, dhe së dyti, procesit të qiradhënies për bodrumet të cilat kanë qenë në posedim të qytetareve të cilët nuk i kanë pasur të pasqyruara në kontratën e qirasë të apartamentit dhe për pasojë nuk i ka përfshirë procesi i privatizimit, përfshirë këtu edhe bodrume të cilat janë dhënë me autorizim provizor, të përshtatura për banim por që për gjatë viteve qytetarët që i kanë poseduar me autorizim provizor nuk kanë arritur t’i kthejnë në autorizime definitive (praktikë e ndjekur kjo nga Bashkia Tiranë për gjatë viteve pas 1992) dhe ku për pasojë kjo kategori bodrumesh nuk i është nënshtruar procesit të privatizimit dhe vijoje në trajtohen në kuadrin e kontratave të qirave.

**Bodrumet** të cilat nuk i nënshtroheshin procesit të privatizimit, mbetën në kuadrin e administrimit në nivel qiradhënie dhe nga periudha kur u procedua me Udhëzim të Këshillit të Ministrave Nr.1/1993 që doli për zbatimin e Ligjit nr.762/1992 “Për privatizimin e banesave”, bodrumet që nuk i nënshtroheshin privatizimit nuk u trajtuan dhe nuk u përcaktua për to ndonjë destinacion i ndryshëm i marrëdhënies juridiko-civile, dhe në këtë kuptim të gjitha bodrumet që rezultuan të mos i nënshtroheshin privatizimit administrohen në kuadrin e qiradhënies. ***Vlera e qirasë për këto ambiente është përcaktuar në VKM nr.324 datë 24.07.1992 “Për dyfishimin e çmimit të qirasë” dhe VKM Nr.313 datë 28.06.1993 “Për trefishimin e çmimit të qirasë”.***

Objektet të kategorisë Bodrum të cilat janë të trupëzuara me pallatet e ndërtuara para viteve ‘90 të cilat kanë qenë objekt i Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ndahen në:

1. *Bodrume që disponohen nga qytetarët me Autorizim Provizor për strehim.*
2. *Bodrume që disponohen nga qytetarët në dokumentacionin fillestar (Akti i Dhënies dhe Marrjes në Dorëzim të Banës Shtetërore dhe që nuk pasqyroheshin/hen në kontratën e qirasë) para viteve ‘90, të cilat janë send ndihmës (aksesor) i apartamentit (dhe posedohen faktikisht) i cili mund të jetë ose jo i privatizuar.*
3. *Ambiente të cilat identifikohen në Arkivin Tekniko-Ligjore të DPN3 si Zyra Fronti të cilat ndodhen në disa raste në bodrumet e pallateve ose në katet e para të tyre dhe për to qytetarët në disa raste disponojnë Autorizim Provizor ose nuk kanë asnjë dokumentacion.*

**Vendstrehimet** të cilat përbëjnë objekte fortifikuese dhe mbrojtje, në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes dhe që administrohen nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike në statusin juridik të ***qiradhënies, në përputhje me VKM Nr. 280 datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse’ (i ndryshuar), dhe Udhëzimit nr. 249 datë 07.07.1997 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 280 datë 15.01.1996”, si dhe VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfüteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*** përfshijnë:

4. *Objekte të cilat kanë qenë Vendstrehime, të trupëzuara me pallatet e ndërtuara para vitit 1990, të cilat e kanë humbur funksionin e tyre dhe janë në administrimin e pushtetit vendor.*

Nga kontrolli i kryer për periudhën objekt auditimi (2020-2022) u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, në raport me administrimin e objekteve nga të cilat sigurohen të ardhura nga kontratat e qirave dhe konkretisht, bodrumet dhe vendstrehimet, rezulton se: DPOP ka trashëguar apartamente dhe banesa të cilat kanë qenë në menaxhimin e ish-ndërmarrjes Komonale Banesa dhe si e tillë me daljen e ligjit nr.7652/1992 “për privatizimin e banesave shtetërore”, ngarkon këtë institucion me të drejtën për të kaluar në proces privatizimi apartamentet

shtetërore që administrojnë. Nga procesi i privatizimeve rezulton se ka një numër objektesh të cilat nuk janë përfshirë në proces privatizimi, objekte që përfshijnë kryesisht bodrume dhe vendstrehime, të cilat trajtohen me kontrata qiraje.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi administrimin e bodrumeve dhe vendstrehimeve

**Situata:** Nga kontrolli i dokumentacionit (dosje) të kontratave të qirave të vendstrehimeve (objekteve fortifikuese mbrojtëse), konstatohet se ka mangësi për monitorimin e tyre, që lidhet me mungesën e procesverbalit të gjendjes fizike të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës (shoqëruar dhe me pamje fotografike të momentit), në mospërputhje me germën a) të pikës 2, kreu VI i VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Në kontratat tip të dhënies me qira të vendstrehimeve mungon një përcaktim i plotë dhe posaçëm i të drejtave dhe detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se mungon një data bazë ose një liste e saktë e numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, me qëllim arkëtimin konstant të detyrimeve nga qiraja.

Rezulton të mos ketë publikime të mundësive apo hapësirave ligjore që qytetarët kanë për marrjen me qira të bodrumeve apo vendstrehimeve, me qëllim mirëmbajtjen, vënien në ruajtje si edhe krijimin e të ardhurave për institucionin.

**Kriteri:** VKM Nr.280 datë 15.01.1996 “Për ruajtjen mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse ( i ndryshuar)”; VKM Nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Ndikimi/Efekti:** Mos evidentimi dhe mirëmbajtja, nga e cila Bashkia Tiranë mund të krijojë të ardhura.

**Shkaku:** Neglizhencë e strukturave përkatëse.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandimi 1:** Njësia përgjegjëse, në vijim, në lidhjen e kontratave me subjektet përkatëse, të procedojë me hartimin e dokumentacionit shoqëruar të këtyre kontratave në funksion të përcaktimit të sipërfaqes dhe rrjedhimisht edhe të vlerës së qerasë.

**Rekomandimi 2:** DPOP të krijojë një data bazë të numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, si dhe të mundësohet publikimi i këtyre objekteve me qëllim krijimin e të ardhurave për Bashkinë Tiranë.

#### **4. Procedura e marrjes me qira të ambienteve magazinë (Midis DPOP dhe z. B. Xh.; DPOP dhe Shoqëria E. 2. shpk )**

##### **I.Përshkrimi i veprimeve të brendshme të Autoritetit Kontraktor**

*a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.*

Me shkresën nr. 2996 datë 27.06.2020, Drejtoria e Financës dhe Aseteve i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me kërkesë për pajisjen me ambient magazinimi me qira, sipas kritereve të mëposhtme:

- Sip e përgjithshme e ambientit 1500 m<sup>2</sup>,
- Sip e brendshme 1000 m<sup>2</sup>, me lartësi jo me të vogël se 4m,
- Sip e jashtme 500 m<sup>2</sup>.
- Hapësira e brendshme të ketë dy ambiente shërbimi si zyrë me sipërfaqe jo me shumë se 50m<sup>2</sup>.

- Ambienti të ketë shërbimin e monitorimit me kamera, brenda e jashtë dhe sistem alarmi.
- Ambienti të jetë në rrugë kryesore dhe jo më larg se 10 km nga qendra e qytetit të Tr.
- Afati i përdorimit gusht-dhjetor 2020.
- Vlera e fondit të përgjithshëm është 4,500,000 lekë me TVSH (Sipas VKB 96 datë 06.08.2020 “Për miratimin e fondit për marrjen me qira të magazinës).

Kërkohen magazina pasi fluksi i bazës materiale është trefishuar me shtimin e funksioneve. Në kuadër të gjendjes së magazinave ekzistuese të cilat nuk plotësojnë kushtet e kërkuara nga ligji dhe nuk janë në gjendje të për të kryer funksionin. Gjithashtu është miratuar kërkesa jonë për fondin për asgjësimin e mbulesës së këtyre magazinave me material eternit. Asgjësimi i këtij materiali është në proces dhe gjatë këtij procesi kërkohet që magazinat të jenë të boshatisura.

*Nuk është specifikuar në kërkesë sasia, lloji i mallrave që do të magazinohen. Në dosje nuk rezulton dokumentacion për përfundimin e procesit të asgjësimit të mbulesës së magazinave ekzistuese (shkak i të cilave është inicimi i kësaj kërkesë).*

*b)Për kontratën e lidhur me Shoq. E. 2. sh.p.k*

Me shkresën nr.3412 dt.22.09.2020, Drejtorja e Financës dhe Aseteve (Zj. V. L. dhe zj. S. B.) i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me kërkesë për pajisjen me ambient magazinimi me qira, sipas kriterëve të mëposhtme:

- Sip e përgjithshme e ambientit për magazinim afërsisht 4000-6000 m<sup>2</sup>,
- me lartësi jo më të vogël se 4m,
- Sip e jashtme 500 m<sup>2</sup>.
- Ambienti të jetë jo më larg se 10 km nga qendra e qytetit të Tiranës.
- Afati i përdorimit për një afat të pacaktuar për arsye se furnizimi nga Bashkia e Tiranës bëhet i përvitshëm.
- Vlera e fondit të përgjithshëm është 4,000,000 lekë me TVSH për 4 muaj, Shator- Dhjetor (Sipas VKB 95 datë 06.08.2020 “Për miratimin e fondit për marrjen me qira të magazinës).

*Nuk është kërkuar kriteri që lidhet me sigurinë, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr.564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht: Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisa me sisteme alarmi për zjarret.*

Kërkohen magazina në kuadër të Kontratës nr. 20379/6 datë 14.08.2020 me objekt “pajisje dhe orendi mobilimi për shkollat” me bazë materiale të re, dhe se lind nevoja për magazinimin e bazës materiale të vjetër të këtyre shkollave.

*Nuk ka një dokumentacion për sasinë apo të asgjësimit të bazës materiale të vjetër, nëse është vlerësuar dhe nëse janë vërtetë të nevojshme këto ambiente aktualisht.*

## **II. Testimi i tregut /vlerësimi i ofertave nga komisioni**

*a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.*

■ Me Urdhrin e brendshëm nr. 2996/1, datë 27.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi për testimin e tregut për marrjen e një ambienti si magazinë me qira, si dhe përfundimi i raportit për përzgjedhjen e varianteve dhe subjekteve sipas kriterëve të përcaktuara, brenda datës 28.08.2020, me përbërje:

1. z. A. U. (Kryetar)
2. z. K. L. (Anëtar)
3. z. M. S. (Anëtar)

Komisioni ta bazojë punën për arritjen e qëllimit në kriteret e lartpërmendura.

- Urdhri nr. 2996/2 datë 28.08.2020 për një ndryshim (ndryshimi i komisionit të testimit të tregut të qirave) të urdhrimit nr. 2996/1 datë 27.08.2020. Data e përfundimit të raportit për përzgjedhjen e varianteve dhe subjekteve 31.08.2020, me përbërje:
  1. z. A. U. (Kryetar)
  2. z. K. L. (Anëtar)
  3. z. V. K. (Anëtar)

▪ Më datë 31.08.2020 grupi i punës për studimin e tregut të qirave nëpërmjet një relacionit mënyrë të përmbledhur shprehet se: nga grupi i punës u krye vlerësimi i ofertave të mbledhura në treg dhe u përzgjedh ajo me vlerë më të ulët, e Operatorit ekonomik/person fizik B. Xh. me vlerën 899 000 lekë në muaj, si dhe ambientet e magazinimit janë të përshtatshme për magazinimin e materialeve mirëmbajtëse si dhe ofrojnë mundësinë e sistemimit të rregullt të tyre.

▪ Procesverbal për testimin e tregut më datë 31.08.2020, ku grupi i punës shprehet se i është drejtuar tre subjekteve për të marrë oferta.

Janë administruar 3 oferta:

1. L. Sh. – Sipërfaqe magazinimi 744 m<sup>2</sup> brenda dhe 468 m<sup>2</sup> jashtë, çmimi -vlera e qirasë mujore 900.000 lekë në muaj;

2. F. Q. – Sipërfaqe magazinimi 660 m<sup>2</sup> brenda dhe 957 m<sup>2</sup> jashtë, çmimi -vlera e qirasë mujore 899.500 lekë në muaj;

3.B. Xh.– Sipërfaqe magazinimi 941 m<sup>2</sup> brenda dhe 500 m<sup>2</sup> jashtë, sip e zyrave 55 m<sup>2</sup>, çmimi -vlera e qirasë mujore 899.000 lekë në muaj;

▪ Raport përshkrimor më datë 31.08.2020, për operatorin me ofertën më ekonomike shprehen se ambientet e magazinimit të tij janë të përshtatshme për magazinimin e materialeve.

- Në dosje është administruar Akti i pronësisë/certifikatë pronësie;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Vërtetim që subjekti ka likuiduar detyrimet për pronën arë;
- Relacion Teknik arkitekturor për objektin kabanon industrial

▪ Urdhër nr.2996/3 datë 31.08.2020 “Masat që duhet të merren mbi procedurën e marrjes me qira të magazinë”, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Financës dhe Aseteve (zj. S. B. dhe zj. V. L.) ku ndër tjera shprehen se magazina e propozuar në raportin përshkrimor të vlerësimit të ambientit të magazinave nga komisioni, plotëson kriteret dhe kërkohet të vijohet me procedurat e marrjes me qira të ambientit.

*b)Për kontratën e lidhur me Shoq. E. 2. sh.p.k*

▪ Me Urdhër brendshëm nr. 3412/1, datë 22.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi për testimin e tregut për marrjen e një ambienti si magazinë me qira, si dhe përfundimi i raportit për përzgjedhjen e varianteve dhe subjekteve sipas kriterëve të përcaktuara, me përbërje:

1. z. K. L. (Kryetar)
2. z. I. K. (Anëtar)
3. z. E. H. (Anëtar)

Komisioni ta bazojë punën për arritjen e qëllimit në kriteret e lartpërmendura.

▪ Më datë 08.10.2020 grupi i punës për studimin e tregut të qirave nëpërmjet një relacionit, në mënyrë të përmbledhur shprehet se: është kryer testimi i tregut për marrjen e magazinës me qira dhe propozojnë:

1. H. shpk (4600 m<sup>2</sup>) qiraja mujore 12.880 euro;
2. S. shpk (sip 4000 m<sup>2</sup>) qiraja mujore 13.000 euro;
- 3.E. 2. shpk (4600 m<sup>2</sup>) qiraja mujore 10.580 euro;

- Procesverbal për testimin e tregut më datë 16.08.2020, ku grupi i punës shpreh se i është drejtuar tre subjekteve për të marrë oferta dhe se oferta me vlerë më të vogël është ajo e operatorit ekonomik Shoq E. 2. shpk, 2.3 euro/muaj me tvsh (4600 m<sup>2</sup>) 10,580 euro në muaj.
- Raport përshkrimor më datë 16.08.2020, për operatorin me ofertën më ekonomike shprehen se ambientet e magazinimit të tij janë të përshatshme për magazinimin e materialeve.

Janë administruar kopje të tre ofertave të testimit të tregut.

Në dosje është administruar dokumentacioni i shoqërisë E. 2. sh.p.k :

- ✓ Vendim (kopje) nr. 576/3 për shtyrje e afatait të lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 57 datë 02.02.2010 të KRR T Qarku Tiranë, për miratimin e shtyrjes së lejes së ndërtimit (faza e dyte) për fabrikë për prodhim paketim e tregtim të produkteve blegtorale. Afati i shtyrjes për një periudhë 9 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit. Vërtetimi i certifikatës së pronësisë (kopje) së pasurisë “ARË” nr. 79/36 me sip 13600 m<sup>2</sup> në emër të shoq E. 2. SHPK.
- ✓ Vërtetimi i certifikatës së pronësisë (kopje) së pasurisë “ARË” nr. 79/37 me sip 5800 m<sup>2</sup> në emër të shoq E. 2. SHPK.
- ✓ Miratim nga KRRT Qarku Tiranë për planimetrinë e sheshit të ndërtimit të shoqërisë E. 2. Shpk.

*Nuk rezulton të jetë ngritur një grup tjetër për vlerësimin e ofertave, i ndryshëm nga ai i testimit të tregut. Në të dyja praktikat rezulton se nuk ka publikim të njoftimit në median e shkruar apo në web-in e DPOP (i cili mungon në këtë institucion), për marrjen me qira të ambienteve për magazinë. Gjithashtu, nuk është përcaktuar dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin ofertuesit. Në të dyja praktikat konstatohet se nga Titullari i Institucionit, mbështetur në nenin 5, 8, 16 si dhe pikën 4 të nenit 9, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nuk është nxjerrë një urdhër i brendshëm që të përcaktonte në mënyrë shteruese gjithë proceset e punës për marrjen me qira të ambienteve magazinë, duke përfshirë testimin dhe vlerësimin e tregut e deri në lidhjen e kontratës, me qëllim eficientë, efektivitetin dhe transparencën e kësaj procedure.*

### **III. Lidhja e kontratës ndërmjet palëve**

a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.

- ✓ Akt Marrëveshje 2996/4 Prot., datë 01.09.2020, ndërmjet qiradhënësit B. Xh. dhe Drejtorit të Përgjithshëm të DPOP (Hyn në fuqi në po këtë datë)
- ✓ Nr. Pasurie 148/80 ND Zonë Kadastrale (ZK) 2376, vol 5, faqe 201
- ✓ Nr. Pasurie 148/80 ND Zonë Kadastrale (ZK) 2376, vol 5, faqe 191
- ✓ Kontrata e Qirasë nr. 5324 Rep 1320 Kol datë 29.09.2020 ndërmjet qiradhënësit B. Xh. dhe DPOP (përfaqësuar nga z. A. U.).

b) Për kontratën e lidhur me Shoq. E. 2. sh.p.k

- Kontrata e Qirasë nr. 5447 Rep 2326 Kol datë 19.10.2020 ndërmjet qiradhënësit Shoq E. 2. shpk dhe DPOP (përfaqësuar nga z. E. B.), për një periudhë 1 vjeçare 20.10.2020-19.10.2021, me vlerë 1,311,920 lekë të reja në muaj. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë: ambienti për magazinim me sip 4600 m<sup>2</sup>, i cilësuar objekt nr. 1 e përshkruar në relacionin nr.3412/2 prot., dt 08.10.2020, e përcaktuar magazinë miratuar me vendimin nr. 57

datë 02.02.2010 si dhe vendimit nr. 576/3 për shtyrje e afatit të lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 57 datë 02.02.2010 të KRRT Qarku Tiranë, të ndërtuara mbi pasuritë “ arë” 13600 m<sup>2</sup> ( e regj me nr. 79/36 ZK 2952 Vol 3 Fq12 në Pezë e Vogël Tiranë dhe “arë” me sip 5800 m<sup>2</sup> ( e regj me nr. 79/37 ZK. 2952 Vol 3 Fq 15 në Pezë e Vogël Tiranë).

*Nuk rezulton të ketë certifikatë pronësie për objektin në momentin e lidhjes së kontratës. Është administruar më tej kartela e pasurisë së paluajtshme nr. 548 datë 10.11.2022, me të dhënat e pasurisë: ZK nr. 2952, lloji i pasurisë truall, nr. i pasurisë 79/67, sip. totale 19400 m<sup>2</sup>, nga të cilat truall 19400 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 6928.9 m<sup>2</sup>, Pezë e Vogël. Në kushtet kur ambienti i marrë me qira nuk ka certifikatë pronësie dhe nuk dihet statusi juridik, nuk garantohej gëzimi i qetë i saj gjatë periudhës së qirasë, në kundërshtim me nenin 4 të kontratës së qirasë nr. 5447 Rep 2326 Kol datë 19.10.2020, si dhe pikës 3 të nenit 802 të Kodit Civil.*

#### **IV.Marrja në dorëzim e ambienteve**

##### ***a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.***

- Urdhër nr.2996/3 datë 31.08.2020 “Masat që duhet të merren mbi procedurën e marrjes me qira të magazinë”, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga Drejtoria e Financës dhe Aseteve (zj. S. B. dhe zj. V. L.) ku ndër tjera shprehen se magazina e propozuar në raportin përshkrimor të vlerësimit të ambientit të magazinave nga komisioni, plotëson kriteret dhe kërkohet të vijohet me procedurat e marrjes me qira të ambientit, si dhe pas procedurave për marrjen e çelësave të magazinës, propozohet që transferimi të kryhet nga komisioni, me përbërje:
  1. z. K. K.
  2. z. G. B.
  3. Magaziniери i magazinës që transferohet
- Urdhër nr.2996/5 datë 01.09.2020 “Për ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të objektit magazinë, në Lalm, Tiranë”, i cili pas marrjes në dorëzim të magazinës, t’i dorëzoje çelësat me proces- verbal magazinierit të magazinës, me përbërje:
  1. z. K. Ko.
  2. z. G. B.
  3. z. E. S.

Urdhër Nr. 3532 datë 30.09.2020 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës nr. 5324 Rep 1320 Kol datë 29.09.2020 për objekti magazinë në Lalm, Tiranë, ku urdhërohet ndër të tjera që Drejtoria e Financës dhe Aseteve, nëpërmjet strukturës së vartësisë të marrë në dorëzim objektin e kontratës së qirasë, si dhe pagimin e detyrimeve të parashikuara në të.

##### ***b)Për kontratën e lidhur me Shoq. E. 2. sh.p.k***

- Urdhër nr.3797/1 datë 19.10.2020 “Për ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të objektit magazinë, në Pezë e Vogël, Tiranë”, i cili pas marrjes në dorëzim të magazinë (objekt i kontratës së qirasë nr. 5447 Rep 2326 Kol datë 19.10.2020), t’i dorëzojë çelësat me proces-verbal magazinierit të magazinës, me përbërje:
  1. z. K. K.
  2. z. G. B.
  3. z. E. S.
- Urdhër Nr. 3797 datë 19.10.2020 “Për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës nr. 5447 Rep 2326 Kol datë 19.10.2020 për objekti magazinë në Pezë të Vogël, Tiranë, **ku urdhërohet ndër të tjera që Drejtoria e Financës dhe Aseteve, nëpërmjet strukturës së vartësisë të marrë në dorëzim objektin e kontratës së qirasë**, si dhe pagimin e detyrimeve të parashikuara në të.



Në të dyja dosjet mungon proces-verbali i dorëzimit të çelësave, sikurse dhe vlerësimi i gjendjes së magazinës të marrë me qira (sipas kushteve të Kontratës, detyrimet e qiramarrësit: të marrë në dorëzim ambientin në gjendje të përshtatshme për të filluar aktivitetin).

Nuk dokumentohet gjithashtu kriteri që lidhet me sigurinë, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht: Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisa me sisteme alarmi për zjarret).

## **V. Rinovimi i Kontratës**

a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.

- Kontratë qiraje Nr. Rep 6455 Nr. Kol 2864 datë 09.09.2021- afati 1 vjeçar 08.09.2021-07.09.2022, qiraja mujore 899.000 lekë (e pandryshuar), lidhur midis qiradhënësit B. Xh. dhe DPOP (përf. nga z. E. B.)
- Kontratë qiraje nr. 6731 Rep, Nr. 3642 Kol, dt 14.09.2021. Afati –fillon më 28.09.2022- deri më 27.09.2023, referuar Amendimit të Kontratës së Qirasë me Nr. Rep 7200 Nr. Kol 3165 datë 29.09.2021. Vlera 899.000 lekë e pandryshuar, sipas kontratës së qirasë Nr. Rep 6455 Nr. Kol 2864, së lidhur më datë 09.09.2021.
- Kontratë Qiraje Nr. Rep 7200 Nr. Kol 3165 datë 29.09.2021 (Amendim Kontrate), e kontratës së qirasë datë Nr. Rep 6455 Nr. Kol 2864 datë 09.09.2021). – për ndryshimin e afatit të kontratës: Afati i kontratës do të fillojë datë 29.09.2021- deri në 28.09.2022.

b) Për kontratën e lidhur me Shoq. E.A 2. sh.p.k

- Kontratë qiraje nr. 7966 Rep. nr. 3430 Kol. Datë 19.10.2021 për objektin magazinë me sip 4600 m2, me adrese Pezë e Vogël), me afat 1 vjeçar 20.10.2021-19.10.2022, lidhur midis qiradhënësit Shoq.E. 2. sh.p.k dhe DPOP (përf. nga z. E. B.), me të njëjtat kushte.
- Urdhër nr. 4364 datë 19.10.2021 për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së qirasë nr. 7966 Rep. nr. 3430 Kol. Datë 19.10.2021 për objektin magazinë me sip 4600 m2, me adrese Pezë e Vogël.

## **VI. Pagesat e kryera sipas urdhër shpenzimeve:**

a) Për Kontratën e lidhur me Z. B. Xh.

- ✓ Pagesë e qirasë mujore datë 04.11.2020, në shumën 524,760 lekë, pranë Bankës C.

b) Për kontratën e lidhur me Shoq. E. 2. sh.p.k

- ✓ Pagesë e qirasë mujore datë 25.10.2021, për periudhën Tetor- Dhjetor 2021, në shumën 3 935,760 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë. (**Mungon firma e urdhëruesit në urdhër shpenzim**);
- ✓ Pagesë e qirasë mujore datë 11.02.2022 për periudhën Janar- Tetor 2022, në shumën 13 119,200 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë. (**Mungon firma e urdhëruesit në urdhër shpenzim**)

Në kontratën me Shoq. E. 2. sh.p.k nuk është përcaktuar që shumat e qirasë mujore të parapaguhet për disa muaj (kushtet, kriteret dhe afatet sikurse përcaktuar edhe në urdhrin nr. 4364 datë 19.10.2021), pra pagesa është bërë në kundërshtim me nenin 3 të kontratës “shuma do të paguhet nga qiramarrësi në fillim të çdo muaji dhe jo më vonë se data 5 e çdo muaji”.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi kontratat për marrjen me qira të ambienteve magazina.

**Situata:** - Nga kontrolli i dokumentacionit (dosje) të kontratave të qirave, konstatohet se ka mangësi në procedurën e marrjes me qira, në mospërputhje me nenin 5, 8, 16, si dhe pikën 4 të

nenit 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nga ana e Titullarit të Institucionit nuk është nxjerrë një urdhër i brendshëm që të përcaktonte në mënyrë shteruese të gjithë procedurën e marrjes me qira, me qëllim përdorimin eficient, efektiv dhe me ekonomi të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

-Rezultoni të mos ketë publikime të njoftimit për marrjen me qira të ambienteve për magazinë, si dhe nuk është përcaktuar dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin ofertuesit.

-Nga kontrolli i dosjeve nuk dokumentohet kriteri që lidhet me sigurinë, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht: Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisa me sisteme alarmi për zjarret).

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar VKM nr. 564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, kontratat e lidhura, VKB 95 datë 06.08.2020 “Për miratimin e fondit për marrjen me qira të magazinës”, VKB 96 datë 06.08.2020 “Për miratimin e fondit për marrjen me qira të magazinës”.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në menaxhimin eficient të burimeve financiare.

**Shkaku:** Neglizhencë e strukturave përkatëse.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi 1:** Drejtori i Përgjithshëm i DPOP dhe personat e ngarkuar sipas urdhrave të miratuar prej tij për lidhjen e kontratave për qiratë e ambienteve, të përcaktojnë në mënyrë shteruese elementët kryesorë që kanë të bëjnë me objektin e qirave, kjo për të rritur eficientë e përdorimit të fondeve. Të merren masa në vijim për publikimin e kërkesave për marrje ambientesh me qira.

### **2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020 dhe 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.**

**2.3.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

**2.3.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

**2.3.3.** Opinioni mbi pasqyrat financiare.

#### **▪ Për Vlerësimin e raportimit financiar, u kërkua dhe u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

1. Pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 të DPOP Tiranë;
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave (borderotë), të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj.
3. Praktika e Inventarizimit të aktiveve, regjistri i aktiveve;
4. Urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur;
5. Akt rakordimet me degën e thesarit Tiranë;
6. Dokumentacion mbështetës për vendimet gjyqësore, investimet, shpenzimet e të ardhurat etj.

#### **▪ Hartimi i pasqyrave financiare**

Drejtorja e Përgjithshme e Objekteve Publike për të dy vitet ushtrimore 2020 dhe 2021 ka plotësuar pasqyrat financiare sipas formateve nga 1-8, të cilat i ka dorëzuar në Bashkinë Tiranë për plotësimin e pasqyrës Format 9 – Pasqyrat financiare të Konsoliduara dhe në Degën e Thesarit Tiranë.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon:

Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar,

Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare,

Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare,

Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto,

Format 5 – Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese,

Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit,

Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike,

Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto,

Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021 janë bërë duke kryer paraprakisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga DPOP gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në programin *Microsoft Excel*;

#### ▪ **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ ; janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë për vitin ushtrimor 2020 me shkresën nr. 1115 prot., datë 31/03/2021 dhe me nr. 2219 datë 31.03.2021 të Degës së Thesarit Tiranë; për vitin ushtrimor 2021 me shkresën nr. 1335 prot., datë 30.03.2022 dhe me nr. 2226 prot., datë 30.03.2022 të degës së Thesarit Tiranë.

#### ▪ **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitet ushtrimore 2020 e 2021 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ekstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

#### ➤ **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues;
- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin “Microsoft Excel”;
- Përgjithësisht janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin; përjashtim bën llog.215 dhe llog.212 të cilat paraqesin një vlerë jo reale të tyre në kontabilitet si në regjistrim ashtu edhe në shkarkime të vlerës, pa plotësi e llog. 602 për nënvlerësim të nënllogarisë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 26,492,956 lekë;
- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe partitarët për llogaritë kreditore e debitorë etj.

➤ **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomik –financiar të viteve 2020 e 2021. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës së Drejtorisë Ekonomike. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive (të specifikuar më lart) dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të viti ushtrimor 2020 e 2021, rezulton se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

**1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

Aktiviteti neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2021</u>
Aktivitet	2,434,304,879 lekë	2,608,235,536 lekë
Pasivitet	157,520,409 lekë	171,828,677 lekë
Aktiviteti neto	2,276,784,470 lekë	2,436,406,859 lekë

**Aktiviteti afatshkurtra**

Aktiviteti afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën 603,780,145 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 12,354,409 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 431,951,468 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 144,137,112 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 15,337,156 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën e 10,784,524 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 12,354,409 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI

“Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-flow), sipas metodës direkte. përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca
				2021-2020
531	Mjete monetare në arkë		-	-
512	Mjete monetare në bankë		-	-
520	Disponibilitete në thesar	12,354,409	10,784,524	1,569,885
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>12,354,409</b>	<b>10,784,524</b>	<b>1,569,885</b>

**Vlera e llogarisë 520** “Disponibilitete në thesar” në shumën 12,354,409 lekë, përbëhet nga gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 12,354,409 lekë. Llog.466 “Mjetet në ruajtje” përbën garancinë e punimeve e cila e shpërndarë sipas viteve është: *për vitin 2019* ka vlerën e 1,870,756 lekë, *për vitin 2020* ka vlerën e 8,809,779 lekë dhe *për vitin 2021* ka vlerën e 3,544,630 lekë.

**Llogaritë e klasës 5**, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**Llogaritë e Klasës 3** “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	149,686,705	134,330,995	15,355,710
32	Objekte inventari	282,264,763	262,591,734	19,673,029
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle në rritje e majmeri			
37	Gjendje të pambritura ose pranë të tremeve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit(-)			
<b>Totali</b>		<b>431,951,468</b>	<b>396,922,729</b>	<b>35,028,739</b>

**Llogaritë e Klasës 3**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të DPOP Tiranë në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 431,951,468 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 149,686,705 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 282,264,763 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 35,028,739 lekë.

**Llogaria 312** “Materiale”, në fillim të vitit 2021 ka vlerën 134,330,995 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	134,330,995
Hyrje gjatë vitit 2021	431,326,448.9
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	415,970,739.2
Gjendja në 31.12.2021	149,686,705

Burimi: DPOP Tiranë

**Llogaria 327** “Objekte inventari”, ka vlerën 282,264,763 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në
Gjendja në 01.01.2021	262,591,732
Hyrje gjatë vitit 2021	51,220,476
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	31,547,445
Gjendja në 31.12.2021	282,264,763

*Burimi: DPOP Tiranë*

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Titullari i DPOP ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve që klasifikohen të dëmtuara.<sup>12</sup>

**Llogaritë Klasës 4** “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>144,137,112</b>	<b>120,649,520</b>	<b>23,487,592</b>
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	53,600	-	53,600
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			
44	Institucione te tjera publike			
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			
468	Debitorë të ndryshëm	100,689,492	79,939,823	20,749,669
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	43,394,020	40,709,697	2,684,323
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>15,337,156</b>	<b>26,086,365</b>	<b>(10,749,209)</b>
409	Furnitore(Debitor),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	15,337,156	26,086,365	(10,749,209)
	<b>Totali</b>	<b>159,474,268</b>	<b>146,735,885</b>	<b>12,738,383</b>

*Burimi: DPOP Tiranë*

“Llogari të arkëtueshme” për vitin 2021 është në shumën 144,137,112 lekë dhe në vitin 2020 është 120,649,520 lekë me një diferencë prej 23,487,592 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i rritjes së llog. 468 “debitorë të ndryshëm” prej 20,749,669 lekë, llog. 4342 “të tjera operacione me shtetin (debitor)” me shumën 2,684,323 lekë dhe llog. 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” me 53,600 lekë.

<sup>12</sup> Trajtohet në rubrikën për procedurën e inventarizimit

**Llogaria 468** “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 është 100,689,492 lekë e cila përbëhet: nga shuma e pa vjelë e qerasë nga banesat sociale, nga palestrat, detyrim i punonjësve në rekomandimet e lëna nga KLSH etj.<sup>13</sup>

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	79,939,823
Gjendja në 31.12.2021	100,689,492
Diferenca	20,749,669

Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie vjen në rritje në shumën e 20,749,669 lekë. Shuma e detyrimeve debitohet në llogarinë 468 dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor). **Konstatohet** se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

**Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 43,394,020 lekë me kundërparti Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 58,784,776 lekë, me një diferencë 15,390,756 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	40,709,697
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	599,751,006
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	556,795,344
Gjendja në 31.12.2021	43,394,020

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	15,228,724
Paga personeli llog 42	31,271,127
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	1,402,050
Sigurime shoqërore llog.435	9,029,346
Sigurime shëndetësore llog.436	1,253,139
Organizma të tjerë shtetërorë	0
<b>Totali</b>	<b>58,184,386</b>

Pra siç rezulton, vlera totale prej 58,184,386 lekë (me llog.402-408) që përfaqëson vlerën analitike të llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” ka një diferencë prej 600,390 lekë me atë të llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” dhe është e barabartë me shumën në llog. 467 të pasivit.

**Llogaria 486** “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,337,156 lekë. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie në shumën 15,337,156 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera mallra dhe shërbime, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer veçmas në përpunje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të pa financuara". Në këtë llogari nuk është përfshirë shuma prej 108,432 lekë e cila përfaqëson detyrimin për shërbimet e 3 automjeteve, shumë e cila përfshihet në llog. 467 të pasivit. **Pra konstatohet** se kjo llog. është nëvlerësuar për shumën 108,432 lekë.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

<sup>13</sup> Trajtuar në rubrikë të veçantë të të Ardhurat

### **Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20** “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 10,320,733 lekë. Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është në lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	10,320,733
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	10,320,733

Kjo vlerë rakordon me vlerën e regjistrit të Aktiveve për llog. 202 të vitit 2021. Projektet janë në proces.

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21** “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 1,978,782,312 lekë. Në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,853,306,616 lekë, me një shtesë të AAM-ve në 575,870,272 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në mirëmbajtjen e objekteve arsimore, ne territorin që mbulon Bashkia e Tiranës dhe NJ.A me ndikim në vlerën e llog. 212 në rritje me shumën e 24,912,720 lekë, në llog. 214 shtuar ne vlerën e 46,540,645 lekë, llog. 218 në rritje me shumën 60,945,184 lekë dhe ulje të vlerës së llog. 215 për kalime dhe amortizime; llog. 24 është në vlerën e 3,064,673 lekë me një rritje prej 42,000 lekë nga viti 2020 dhe që përfaqëson vlerën e aktiveve të dëmtuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,981,846,985</b>	<b>1,856,329,289</b>	<b>Diferenca</b>	<b>125,517,696</b>
210	Toka, Troje, Terrene	75,000	75,000		0
211	Pyje, Plantacione				0
212	Ndërtesa e Konstruksione	1,320,551,686	1,295,638,966		24,912,720
213	Rruge, rrjete, vepra ujore				0
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	149,775,729	103,235,084		46,540,645
215	Mjete Transporti	42,481,415	49,404,268		-6,922,853
216	Rezerva Shtetërore				0
217	Kafshe pune e prodhimi				0
218	Inventar ekonomik	465,898,482	404,953,298		60,945,184
24	Aktive afatgjata te dëmtuara	3,064,673	3,022,673		42,000
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata				0

Gjendja e llogarive të klasës 21 të Aktivit rakordojnë në vlera me ato të pasqyrës format 7/a - Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

**Llogaria 215** “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të DPOP Tiranë më datë 31.12.2020 në shumën 49,404,268 lekë dhe në 31.12.2021 në shumën 42,481,415 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm është zvogëluar në vlerën (-)6,922,853 lekë në të cilën ka ndikuar amortizimi në vlerën (10,402,853) lekë .

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	49,404,268
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	3,480,000
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	42,481,415



DPOP Tiranë ka 51 mjete transporti<sup>14</sup>, ndërsa regjistri i aseteve për vitin 2021, pasqyrohet në Aneksë.

**Llogaria kontabël 218** “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga DPOP Tiranë. Sipas pasqyrave financiare të DPOP Tiranë, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 404,953,298 lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është shtuar në vlerën 60,945,184 lekë. Një përmbledhje e llogarive sipas lëvizjeve dhe amortizimit pasqyrohet *aneksin nr. 3, tabela 2*.

*Ky shtim ka ardhur si rezultat i blerjeve gjatë vitit 2021.*

Blerje me pagesë janë 170,710,670 lekë, ndërsa shtesa pa pagesë jashtë sistemit 3,088,818 lekë dhe brenda sistemit 402,070,784 lekë. Pra në total shtesat në llog.218 paraqiten në shumën e 575,870,262 lekë.

Levizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2021, vlera në lekë	
Çelje me 01.01.2020	3,028,910,111
Blerje me pagesë (D)	170,710,670
Dalje (K)	291,184,249
Gjendja me 31.12.2020 (D)	3,313,596,134

**Llogaria 219** “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të DPOP Tiranë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën (1,321,428,416) lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet në vlerën e (1,162,260,089) lekë me një shtesë prej (159,168,327) lekë.

#### **Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akivet afatgjata me vlerë neto”**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga DPOP Tiranë, janë si më poshtë:

ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5 %
inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20 %
për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
për mjetet e transportit	20%
për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15 %

**Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 10,320,733 lekë dhe 1,981,846,985 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 196,797,035 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Aftagjata materiale	196,797,035
<b>Totali</b>		196,797,035

<sup>14</sup> Lista e mjeteve, pasqyruar në aneksin nr. 3, tabela 1.

Për investimet e kryera gjatë vitit 2021, është *debituar* llogarinë 231 dhe *kredituar* llogaritë e klasës 4 në shumën 456,385,087 lekë. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është *kredituar* llogaria 231 dhe është *debituar* llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata". Në mënyrë analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në *Aneksin nr.3, tabela 7*.

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

**Llogaritë e klasës 4**, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e DPOP-së më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ ndryshimi
<b>401-408</b>	Furnitorë e llogari të lidhura me to	15,228,724	26,086,365	-10,857,641
<b>42</b>	Detyrime ndaj personelit	31,271,127	29,610,169	1,660,958
<b>431</b>	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,402,050	1,392,550	9,500
<b>435</b>	Sigurime shoqërore	9,029,346	8,528,577	500,769
<b>436</b>	Sigurime shëndetësore	1,253,139	1,178,401	74,738
<b>466</b>	Kreditorë për mjete në ruajtje	12,354,409	10,784,524	1,569,885
<b>467</b>	Kreditorë të ndryshëm	600,390		600,390
<b>4341</b>	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	100,689,492	79,939,823	20,749,669
	<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<b>171,828,677</b>	<b>157,520,409</b>	<b>14,308,268</b>
	<b>Të tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>C</b>	<b>F (A-B)</b>	<b>2,436,406,859.00</b>	<b>2,276,784,470.00</b>	<b>159,622,389</b>
<b>D</b>	<b>FONDI KONSOLIDUAR I</b>	<b>2,436,406,859.00</b>	<b>2,276,784,470.00</b>	<b>159,622,389</b>
<b>101</b>	Fonde bazë	2,401,378,120.00	2,181,770,394.00	219,607,726
<b>85</b>	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	35,028,739.00	43,788,591.00	-8,759,852
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVIT</b>	<b>2,608,235,536</b>	<b>2,434,304,879</b>	<b>173,930,657</b>

**Llogaria 401-408** "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2021 është në vlerën 15,228,724 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga DPOP Tiranë më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Celje e vitit 2021	26,086,365
Shtesa (K)	637,765,345
Pakësime (D)	618,577,773
Gjendja në 31.12.2021 (K)	15,228,724

Gjendja e **llogarisë 401-408** në shumën 19,097,245 lekë përbëhet nga fatura të pa likuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës në shumën 563,558 lekë.

**Llogaria 42**, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë DPOP Tiranë, paraqitet në vlerën 31,271,127 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe rezultojnë të jenë paguar në muajin janar 2022 në shumën 31,271,127 leke.

Konkretisht, sipas dokumentave të bankës të muajit Janar 2021, ka rezultuar:

Urdhër pagesa		Vlera
Numër	Datë	
1	06.01.2022	13,824,956
2	06.01.2022	1,353,409
3	06.01.2022	522,085
4	06.01.2022	3,245,483
5	06.01.2022	1,264,629
6	06.01.2022	715,799
7	06.01.2022	63,929
8	06.01.2022	3,906,492
9	06.01.2022	3,722,380
10	06.01.2022	1,513,429
11	06.01.2022	104,570
12	06.01.2022	236,611
13	06.01.2022	668,937
14	06.01.2022	128,418
<b>Totali</b>		<b>13,824,956</b>

**Llogaria 431**, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,402,050 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar 2022.

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
15	07.01.2022	806,485
16	07.01.2022	595,565
<b>Totali</b>		<b>1,402,050</b>

**Llogaria 435**, “Sigurime shoqërore” dhe **llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 9,029,346 lekë për sig. shoqërore dhe 1,253,139 lekë sig. shëndetësore.

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
15	07.01.2022	4,565,756
16	07.01.2022	4,463,590
<b>Nëntotali</b>		<b>9,029,346</b>
15	07.01.2022	633,616
16	07.01.2022	619,523
<b>Nëntotali</b>		<b>1,253,139</b>
<b>Totali</b>		<b>10,282,485</b>

**Llogaria 466** “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të DPOP Tiranë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,354,409 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ka mos përputhje të vlerës së saj, për të cilën nga Sektori i financës na u dha ky sqarim: *Shuma e 5% e investimeve të kryera për vitin 2018, 2019, 2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPN3), nga*

ana e drejtorisë së financës dhe asetëve në këto vite nuk regjistroheshin si vlerë e plotë investimit ne objekte te sektori i asetëve, por në vlerën 95% ku iu zbritej 5% i garancisë dhe pse investimi është kryer në masën 100%. Në vitin 2021 investimet e kryera nga DPOP edhe pse 5 % i investimeve nga operatorët ekonomik janë të bllokuara si fond garancie deri ne marrjen e përhershme në dorëzim, vlera e Investimit të ri i është shtuar asetit (shkollave ose objekteve parashkollore ) në vlerën 100 %. Dhe në bilancin e vitit 2022 këto 5% të cilat nuk janë të regjistruar në vlerën e asetit do të sistemohen dhe do ti pasqyrohet si vlerë e shtuar asetëve të cilat mbajnë të regjistruar vetëm vlerën 95% te investimit aktualisht.

**Llog. 467** “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e pa likuiduara për: shërbime automjetesh (për 3 copë) në shumën 108,432 lekë, pagesa UKT në shumën 52540 lekë, OSHEE tani FSHU në shumën 207,985 lekë, taksa te DPT në shumën 170,433 lekë, shërbime postare 7,400 lekë, ndalesë page në shumën 12,000 lekë, ndalesë sindikale në shumën 41,600 lekë, të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në total në shumën 600,390 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2021	-
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	600,390
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	-
Gjendja në 31.12.2021	600,390

**Llogaria 85** “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me teprice kreditorë në vlerën 1,801,992,540 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që DPOP Tiranë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

- Përsa i përket objekteve të cilat janë në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe i kanë kaluar për mirëmbajtje DPOP Tiranë, të cilat aktualisht janë të pasqyruara në bilancin kontabël të datës 31.12.2020 dhe 31.12.2021, referuar regjistrin të asetëve, ato figurojnë me çmimin e blerjes, nuk kanë vlerë të krijimit, apo vitin kur janë krijuar. Gjykojmë se pasqyrimi i zërave me vlerat e viteve kaq të largëta nuk japin një pamje reale të vlerës së ndërtesave dhe rrjedhimisht nuk pasqyrojnë vlerën aktuale të tregut. Tabela në Aneks pasqyron informacionin e plotë mbi vlerën kontabël të përlllogaritur nga sektori i financës.<sup>15</sup>

Nga regjistri i Asetëve rezultojnë 53 objekte që nuk e kanë vlerën e objektit (godinës) por është kontabilizuar me vlerën e investimit të kryer mbi të. Pra rezulton se vlera e **llog. 212** në kontabilitet nuk është reale.

**Konstatim 1:** Vlera e **llog. 212** që përfaqëson vlerën e objekteve që Bashkia e Tiranës i ka kaluar për mirëmbajtje DPOP Tiranë, nuk pasqyron vlerën reale të objekteve.

**Konstatim 2** Vlera e **llog. 215** përmban edhe vlerën e mjeteve të vlerësuara për jashtë përdorimit, dhe si e tillë nuk përfaqëson vlerën reale të tyre.

➤ Pasqyra e Performancës Financiare

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat<sup>16</sup> dhe rubrikën B- Shpenzimet<sup>17</sup>.

<sup>15</sup> Me gjerësisht trajtohen te rubrika procedura e inventarizimit

<sup>16</sup> Tabela për të ardhurat, trajtuar gjerësisht në Aneksin nr. 3, tabela 3.

<sup>17</sup> Tabela për të ardhurat, trajtuar gjerësisht në Aneksin nr. 3, tabela 4.

Nga pasqyra rezulton se të Ardhurat për vitin 2021 janë në shumën 1,103,271,891 lekë dhe në krahasim me vitin 2020 ka një rritje në vlerën 106,090,138 lekë. Të Ardhurat e DPOP Tiranë përbëhen nga:

- *Të Ardhurat jo tatimore* në shumën 18,257,016 lekë që përbëhet nga shuma 11,897,821 lekë “nga të ardhurat e pronësia” që në krahasim me vitin 2020 ka një rritje prej 1,284,587 lekë dhe që përfaqëson të ardhurat nga privatizimi i vendstrehimeve; “shërbime administrative dhe të ardhura sekondare” në shumën 6,359,195 lekë me një rritje 4,514,122 lekë nga viti 2020 dhe përfaqëson të ardhurat nga qiratë e banesave sociale dhe palestrave;
- *Grante Korente /Grant Korent i Brendshëm* në shumën 1,085,014,875 lekë që përbëhet nga “nivele të tjera qeverisje” në shumën 254,261,597 lekë në krahasim me vitin 2020 ka një rritje prej 5,396,074 lekë; “Financim shtese për të ardhurat e krijuara brenda sistemit” në shumën e 771,968,502 lekë me një diferencë (+) 102,906,641 nga viti 2020; “financim i pritshëm nga buxheti” në shumën e 58,784,776 lekë dhe në krahasim me vitin 2020 ka një zvogëlim të vlerës me (-)8,011,286 lekë.

Nga pasqyra rezulton se Shpenzimet për vitin 2021 janë në shumën 1,068,243,152 lekë dhe në krahasim me shpenzimet e vitit 2020 ka një rritje me (+)114,849,990 lekë. Shpenzimet përbëhen nga:

**Llog. 600** - “*Paga dhe përfitime të punonjësve*” për vitin 2021 është në shumën 481,581,445 lekë dhe 40,178,331 lekë më shumë nga viti 2020, që ka ardhur si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve si atyre të përhershëm ashtu edhe atyre të përkohshëm, *pasqyruar nw aneksin nr. 3, tabela 5 & 6.*

**Llog. 601** – “*Kontribute të sigurimeve (shoqërore & shëndetësore)*” për vitin 2021 është në shumën 76,197,515 lekë dhe 3,626,047 lekë më shumë se viti 2020, që ka ardhur si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve si atyre të përhershëm ashtu edhe atyre të përkohshëm, *pasqyruar nw aneksin nr. 3, tabela 5 & 6.*

**Llog. 602** – “*Blerje mallra e shërbime*” është në shumën 511,050,942 lekë dhe që në krahasim me vitin 2020 paraqitet me 68,266,182 lekë më shumë. Në rritjen e vlerës së Llog. 602 ka ndikuar: “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 325,325,206 dhe 128,366,199 lekë më shumë se viti 2020, që përfaqëson shpenzime për kancelari, materiale për pastrim e dezinfektim, etj; “materiale dhe shërbime speciale” në shumën 15,479,484 lekë dhe 2,100,565 lekë më shumë se viti 2020, që përfaqëson shpenzimet për uniforma e veshje speciale, materiale dhe lëndë për drejtorinë e DDD ; ndërsa kanë patur zvogëlim në vlerë: “shërbime nga të tretë” në shumën 4,771,152 lekë dhe (-)5,979,597 lekë më pak se viti 2020, që përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim, shërbime printimi e publikimi, etj; “shpenzime transporti” në shumën 17,678,678 lekë dhe (-)38,258,780 lekë më pak se viti 2020, që përfaqëson blerje karburant e vaj për mjetet, pjesë këmbimi, siguracione etj; “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 142,947,879 lekë dhe (-)14,790,801 lekë më pak se viti 2020, që përfaqëson shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, rrjetit ujqor, elektrik, telefonik, ngrohje, mirëmbajtje aparate, pajisje teknike e pune, mjete transportit e pajisjet e zyrave; “shpenzime të tjera operative” në shumën 4,848,543 lekë dhe (-)3,171,404 lekë më pak se viti 2020, përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor por që janë të nevojshme të kryhen gjatë periudhës buxhetore, si shpenzime për pritje dhe përcjellje, shpenzime për taksat vendore, shpenzime të tjera operative.

<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>511,050,942</b>	<b>442,784,760</b>	Diferenca 68,266,182
602	Mallra dhe shërbime te tjera			0
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	325,325,206	196,959,007	128,366,199
6021	Materiale dhe shërbime speciale	15,479,484	13,378,919	2,100,565
6022	Shërbime nga te trete	4,771,152	10,750,749	-5,979,597
6023	Shpenzime transporti	17,678,678	55,937,458	-38,258,780
6024	Shpenzime udhëtimi			0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	142,947,879	157,738,680	-14,790,801
6026	Shpenzime për qiramarrje			0
6027	Shpenzime për detyrime per kompensime legale			0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua			0
6029	Shpenzime te tjera operative	4,848,543	8,019,947	-3,171,404

**Llog. 606** – “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”/ “Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor” paraqitet në shumën 2,066,032 lekë dhe 188,293 lekë më shumë se viti 2020, që përfaqëson raste sëmundjesh, dalje në pension një rast, pagesë kalimtare, pjesëmarrje ne komisione etj;

**Llog. 63** - “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën 35,028,739 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes se inventarit sipas aktivitet të bilancit.

**Llog. 85** - “Teprica ose deficiti i periudhës” në vlerën 35,028,739 lekë. Kjo tepricë debitore përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, diferencën midis totalit të operacioneve të njësisë me totalin e shpenzimeve, në përputhje me Udhëzimin 14 datë 28.12.2016 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” e pasivitet të pasqyrave financiare.

Aktivet Neto janë te barabarta me Fondin e Konsoliduar	✓
Totali i Aktiveve është i barabarte me = Totalin e Pasiveve	✓
Te Ardhurat janë te barabarta me Shpenzimet + Rezultatit e vitit Ushtrimor	(-) 26,492,956
Llogaria 85 e Pasqyrës F2 është e barabarte me Llog. 85 ne Pasqyrën F1	✓
Llogaria 63 ne Pasqyrën F2 është e barabarte me Ndryshimin e Gjendjeve te Klasës 3 ne Pasqyrën F1	✓

**Observacione nga subjekti i Audituar - DPOP Tiranë:** Në shkresën nr. 326 prot., datë 03.03.2023 dhe nr. 1007/5 prot. (KLSH) datë 03.03.2023 lidhur me pikën 3 të “programit pasqyrat financiare 2021”, shprehet si vijon: **Drejtoria Ekonomike** po ju përcjell observacionin lidhur me

rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që ndikojnë drejtpërdrejtë me drejtorinë Ekonomike. Referuar Akt konstatimit nr. 11 datë 30.12.20222 ju sqarojmë si më poshtë: **Gjetja nr 1:** Persa i përket shumës 108,432 lek fatura të tre shërbimeve te automjeteve, janë fatura të cilat janë evidentuar si fatura te palikujduara (si detyrim i prapambetur), pas momentit të dërgimit të detyrimit e prapamatura për vitin 2021 të DPOP në thesar, kjo ndodhi pasi këto fatura nuk janë pjesë përbërëse e kontratave të shërbimit, por të faturave qe lindin si detyrim duke u bazuar ne garancitë e mjeteve të blera gjate vitit 2020 nga DPOP. Në momentin e konstatimit të këtyre faturave është njoftuar Dega e thesarit Tiranë, por duke u nisur që afati i deklarimeve të detyrimeve të prapambetura ishte tejkaluar, nuk mund të regjistroheshin në sistemin e thesarit si detyrime. U be njoftimi dhe në drejtorinë e Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Tirane dhe me kërkesën nr 1040 prot me tonën datë 08.03.20220. Ky detyrim ne pasqyrat financiare ne Bilanc të DPOP, është regjistruar në pasiv në nënlllogarinë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën **108,432** lek. **Gjetja nr 5:** Për pasqyrimin e llogarise 602 shpenzime operative për nën llogarinë 6026 “Shpenzime për qiramarrje “ në shumën 26,492,956 lek kjo

shumë është regjistruar gabimisht në nënllogarinë 6020 “Materiale zyre të përgjithshme” e cila në bilanc është shumën :

1. Pasqyra e pozicionit Financiar “ **Materiale zyre e te përgjithshme** “**32,5325,206 lek** kjo vlerë është e përbërë si më poshtë :

“**Materiale zyre e te përgjithshme**”: me vlerën **297,722,467 lek** e pasqyruar dhe ne evidencën e muajit Dhjetorit 2021

**Detyrim i prapambetur i operatorit ekonomik Alcani për vitin 2021:** me vlerën 1,109,783 lek “**Shpenzime për qiramarrje** “: me vlerën **26,492,956 lek** për vitin 2021

Për sa i përket zërit “**Shpenzime për qiramarrje**” për vitin 2022 do të pasqyrohet me nënllogarinë përkatëse në bilancin e vitit 2022 te DPOP Tirane. *Përsa i përket rekomandime të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën e Auditimit të Drejtorisë Ekonomike (pasqyrat financiare), po merren masat e duhura për zbatimin e tyre.*

**Oëndrimi i Geupit të auditimit:** Lidhur me konstatimet të cilat janë formuluar si gjetje nr.1 e nr.5, konkludohet se pavarësisht shpjegimit të dhënë nga ju sa më sipër, rekomandimet e përcjella në Projekt Raportin e Auditimit qëndrojnë.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi auditimin e pasqyrave financiare.

**Situata: 1. Llogaria 486** “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,337,156 lekë. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie në shumën 15,337,156 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera mallra dhe shërbime, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: “Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të pa financuara”. Në këtë llogari nuk është përfshirë shuma prej 108,432 lekë e cila përfaqëson detyrimin për shërbimet e 3 automjeteve, shumë e cila përfshihet në llog. 467 të pasivit. Pra kjo llog. është nënvlerësuar për shumën 108,432 lekë;

**2.** Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet **llog. 470** “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” në vlerën 100,689,492 lekë me kundërparti llog.468, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar;

**3.**Përsa i përket objekteve të cilat janë në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe i kanë kaluar për mirëmbajtje DPOP Tiranë, të cilat aktualisht janë të pasqyruara në bilancin kontabël të datës 31.12.2020 dhe 31.12.2021, referuar regjistrin të asetëve, ato figurojnë me çmimin e blerjes, nuk kanë vlerë të krijimit, apo vitin kur janë krijuar. Gjykojmë se pasqyrimi i zërave me vlerat e viteve kaq të largëta nuk japin një pamje reale të vlerës së ndërtesave dhe rrjedhimisht nuk pasqyrojnë vlerën aktuale të tregut. Nga regjistri i Asetëve rezultojnë 53 (pesëdhjetë e tre) objekte që nuk e kanë vlerën e objektit (godinës) por janë kontabilizuar me vlerën e investimit të kryer mbi to.

Pra rezulton se vlera e **llog. 212** në kontabilitet nuk pasqyron vlerën reale të objekteve;

**4.** Gjithashtu nga regjistri i aktiveve të njësisë për periudhën nën auditim, rezultojnë 51 mjete transporti, ku përfshihen edhe 7 (shtatë) mjete tejet të amortizuara teknikisht dhe që janë vlerësuar në pamundësi qarkullimi në rrugë. Vlera kontabël në total e tyre është 11,270,000 lekë. Këto mjete nuk i janë nënshtruar procedurës së çregjistrimit dhe çuarjes për shkatërrim/skrup, duke bërë që vlera e tyre të gjendet e pasqyruar në vlerën e llog. 215 në kontabilitet, duke pasqyruar një vlerë jo reale të kësaj llogarie.

**5.** Në **llog. 602** nuk është pasqyruar vlera e nënllogarisë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë për vitin 2021, e cila përfaqëson shpenzimin e 12 muajve për ambiente (magazina) të marra me qira nga DPOP Tiranë. Pra rezulton se llog. 602 është nënvlerësuar në shumën 26,492,956 lekë, që përfaqëson shpenzime qiramarrje të ambienteve për nevojat e njësisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022; UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël”; UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligji Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

**Ndikimi:** Mos paraqitja e situatës së vërtetë dhe të drejtë në vlera reale të llogarive në Pasqyrat financiare, cenon paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të gjendjes financiare, performancës, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë të njësisë ekonomike.

**Shkaku:** Mos zbatimi me përpikmëri i akteve ligjore / nënligjore të mësipërme nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe e sektorit të financës, për regjistrimin e shumave në llogaritë përkatëse për të patur një pasqyrim real të pasqyrave financiare me vlera reale kontabël.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi 1** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të sistemuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 486 për shumën 108,432 lekë;

**Rekomandimi 2** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të plotësuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 602 në nënlllogarinë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë;

**Rekomandimi 3** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës të plotësojë në pasqyrat financiare llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në shumën 100,689,492 lekë;


**Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e NA, NZ si menaxheri i Drejtorisë Ekonomike, menaxheri i Drejtorisë së Aseteve dhe ai i Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të DPOP në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për të përmbyllur procesin e çregjistrimit të mjeteve të amortizuara me qëllim shkarkimin e tyre nga kontabiliteti në vlerën e 11,270,000 lekë dhe pasqyrimin me vlerë reale të llog. 215 “mjete transporti”;

**Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e NA, NZ si menaxheri i Drejtorisë Ekonomike, menaxheri i Drejtorisë së Aseteve dhe ai i Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të DPOP në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për të përmbyllur procesin e çregjistrimit të objekteve që *de jure* janë por *de facto* nuk janë në pronësi të Bashkisë Tiranë e për mirëmbajtje nga DPOP Tiranë, me qëllim shkarkimin e tyre nga kontabiliteti dhe pasqyrimin me vlera reale të llog. 212 “ndërtesa e konstruksione”.

## **I. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në procedurën e Inventarizimit të Njësisë Publike – DPOP Tiranë**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPOP, në përgjigje të kërkesave që grupi i auditimit u parashtrori lidhur me Procedurën e inventarizimit të aktiveve, referuar Udhëzimit nr.30 date 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Nga auditimi në DPOP, u kërkuan praktikatat e procedurave të inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021.





Skema e Procedurës së Inventarizimit

I. Mbi praktikat e Inventarizimit të DPOP Tiranë, nga auditimi rezultoi se:

Referuar Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, praktika e procedurës së Inventarizimit përmban:	
Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e NA	<i>zbatuar</i>
Përmbledhëse Inventarë për gjithë objektet shkollore dhe zyrat e DPOP Tiranë	<i>zbatuar</i>
Relacioni ose Raporti përmblyës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Verifikimit Fizik / Vlerësimit të Inventarëve;	<i>zbatuar</i>
Bazuar në Raportin e Komisionit të Verifikimit Fizik të Inventarëve dhe të Vlerësimit, vijohet me hapat e mëtejshme: me krijimin e Komisionit e Asgjësimit të Vlerave materiale, zbatimi i procedurave të tyre monitorohet nga NZ	<i>Pa zbatuar</i>

II. Një përmbledhëse e akteve administrative të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i DPOP Tiranë, vlera e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit dhe statusi i procedurës, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Viti	Urdhrat për Komisionet e Inventarit Fizik	Urdhrat për Komisionet e Vlerësimit	Urdhrat për Komisionin e Asgjësimit	Vlera e aktiveve vlerësuar për asgjësim	Statusi Procedurës se nxjerrjes jashtë përdorimit
2019	U. 135 dt.11.01.2019	U. 136 dt. 11.01.2019	U.137/1 dt. 14.01.2019	4,370,150.05 lekë	Pa realizuar
	U. 135/1 dt.12.03.2019	U. 136/1 dt. 14.01.2019	U.138 dt. 11.01.2019		
	U. 135/2 dt. 12.11.2019	U. 137 dt. 11.01.2019			
	U. 3621 dt.18.10.2019	U. 136/1 dt. 14.01.2019			
	U. 3621/1 dt.19.10.2019				
	5	4	0		
2020	U. 178 dt.16.01.2020	U. 193 dt. 17.01.2020	Nuk ka	31,788,774 lekë	Pa realizuar
	U. 178/1 dt.19.02.2020	U. 193/1 dt. 20.07.2020			
	U. 178/2 dt.29.05.2020	U. 193/2 dt. 13.11.2020			
		U. 194 dt. 17.01.2020			
		U. 194/1 dt. 19.02.2020			
	U. 194/2 dt. 13.11.2020				
	3	6	0		
2021	U. 32 dt. 07.01.2021	U. 34 dt. 07.01.2021	Nuk ka	49,708,220.28 lekë	Pa realizuar
	U. 32/1 dt. 18.05.2021	U. 35 dt. 07.01.2021			

	U. 32/2 dt. 08.09.2021	U. 35/1 dt. 18.05.2021			
	U.5120 dt. 10.12.2021				
	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>0</b>		
<b>2022</b>	U. 37 dt. 06.01.2022	U. 35 dt. 06.01.2022		<b>deri ne 31.10.2022 procedura në proces</b>	<b>proçedura në proces</b>
	U. 37/1 dt. 05.05.2022	U.36 dt. 06.01.2022			
	U. 37/2 dt. 06.05.2022	U.36/1 dt. 06.06.2022			
	U. 37/3 dt. 22.08.2022	U.36/2 dt. 07.06.2022			
	U. 37/4 dt. 14.11.2022	U.35/1 dt. 24.11.2022			
	<b>5</b>	<b>5</b>			

*Punoi: Grupi i auditimit*

**III.** Nga auditimi i praktikave dokumentare të inventarëve dhe informacionit elektronik që disponon ky institucion **u konstatuan** si më poshtë:

Për vitin 2019: Nuk është realizuar procedura e asgjësimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit dhe si rrjedhojë nuk ka praktikë të saj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV;

Për vitin 2020: - Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve për 2 shkollat: Gjimnazi “Partizani” dhe “Sabaudin Gabrani”, janë pa nënshkrimin e drejtuesve të shkollave; Mungon nënshkrimi i anëtarit të katërt të komisionit znj. L. Y. te relacioni - në 2 raste, për zbatim të UB. 178/2 dt.29.05.2021 dhe Relacioni i dt.24.12.2021; Mungon nënshkrimi i specialistes së Financës (në 2 raste): te kartela e inventarëve për propozim dhe përmbledhëse e inventarëve; Nuk kanë dalë Urdhra të Brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për hapin III -procedura e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jeten e dobishme 0; Për sa më lart nuk janë zbatuar Ligji 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimi nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Për vitin 2021: - Për aktivitetin e komisionit të ngritur me U- 32/2 dt.18.05.2021, mungon Relacioni i Inventarit Fizik të aktiveve; Procesverbalet e përpiluara nga komisioni i vlerësimit në 3 raste nuk janë origjinale: UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacioni dt.29.09.2021; UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacioni dt.01.11.2021; UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacioni i komisionit mungon; Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit; Nuk kanë dalë Urdhra të Brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për procedurën e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jeten e dobishme 0, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit;

Për vitin 2022 (deri më 31.10.2022): - Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154/2003 “Për arkivat”, “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr.4/2017 “Për Miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”; Procedura e Inventarizimit është në proces.<sup>18</sup>

**IV.** Nga verifikimi në terren i automjeteve që ka në përdorim DPOP Tiranë referuar listës së inventarëve (për llog.215), për realizimin efektiv të tij u kërkuan: Pasqyrat përmbledhëse të qarkullimit të mjeteve të transportit; dosja e çdo mjeti transporti; praktikat e lëvizjes së tyre ku përfshihen kërkesa për transport, autorizimi, fatura e shërbimit, procesverbali; lista emërore e drejtuesve të mjetit me mjetin e transportit në ngarkim.

<sup>18</sup> Regjistri konsoliduar i aktiveve të DPOP Tiranë pasqyrohet në Aneksë.

**a. Mbi inventarizimin e Aseteve - AFGJM mjeteve të transportit të DPOP Tiranë.**

Nga auditimi rezultoi se DPOP Tiranë ka 51 mjete transporti: motomjete (çiklomotorë dhe motorë) dhe automjete të ndryshme të klasifikuara sipas përdorimit, të cilat rezultuan të gjitha fizikisht në të gjitha ambientet e DPOP Tiranë; Praktika dokumentare e lëvizjes së mjeteve është e rregullt, në dosje gjenden fizikisht fotokopje e lejes së qarkullimit, certifikata e pronësisë së mjetit, fotokopje e certifikatës së kontrollit teknik dhe kopje e siguracionit. Ka automjete në gjendje fizike dhe teknike tejet të amortizuara, që nuk i plotësojnë kushtet teknike për përdorim, dhe që gjenden në ambientet e njësisë; Një informacion i përmbledhur mbi disa problematika që u konstatuan, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Statusi i mjetit	Targa	nr. copë
Çregjistrim i përhershëm	TR 3296 I TR 5242 K, TR 774 C=TR 048 H, TR 776 C	4
Çregjistrim i përkohshëm	AA 470 GP	1
Humbur (denoncim vjedhje) dhe aktiv në sistem (me taksa pa paguar)	CAH 716, CAH 697	2
Pa status apo mungesë targe, identifikohen me shasi	TR 775 C , Ford - 6FPxxMJ2PKT427U5, Ford - 6FPXXMJ2PLY38104	3
I papërdorshëm dhe aktiv në sistem	TR 0681 G	1

*Punoi: Grupi i auditimi*

Nga komunikimi verbal me personat përgjegjës të Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve, Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Ligjore, na u komunikua që DPOP ka kompetencë të saj vetëm mirëmbajtjen dhe përdorimin e mjeteve të transportit për ushtrimin e veprimtarisë së saj, ndërsa për demolimin (shkatërrimin e tij për skrap) e mjeteve jashtë çdo parametri teknik, i cili kushtëzon mos lëvizjen e mjetit në rrugë, është kompetencë e Bashkisë Tiranë. Për të përfunduar procedurën e inventarizimit në të gjitha hapat e saj, kemi dërguar në Bashkinë e Tiranës shkresat përcjellëse me praktikën bashkëngjitur saj për mjetet e vlerësuara për jashtë përdorimit: me shkresën nr. 1028 prot., datë 24.03.2021 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Z. E. V. dhe me nr. 1028/1 prot., datë 24.03.2021 Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë Juridike, Aseteve dhe Licencimit Z. A. D. Në përgjigjen e këtij të fundit rikujtohet zbatimi i Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 dhe i udhëzon që praktikat tia drejtojnë Kryetarit të Bashkisë për të marrë vendim. Duhet theksuar se edhe sot e kësaj dite nuk është kthyer përgjigje, por edhe nga ana e saj DPOP Tiranë nuk ka rikërkuar zyrtarisht në bashkinë Tiranë referuar relacionit të inventarizimit për vitin 2021, deri në kthimin e një përgjigjeje.

- Lista e mjeteve të vlerësuara të amortizuara dhe propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit - (çregjistrim të përhershëm në DRSHTRR Tiranë dhe çuarja për shkatërrim)

N r	Emertimi	Tipi	Targa	Nr. Shasis	Vlera kontabël në lek
1	Autobot	Man	TR 1752 E	533700W35050	7,500,000
2	Motorkarro	Shefeng	TR 775 C	TPYJZ1675P*51007711	500,000
3	Motorkarro	Shefeng	TR 776 C	TPYJZ1675P*51007707	500,000
4	Motorkarro	Shefeng	TR 774 C	TPYJZ1675P*5050187146X	500,000
5	Kamion	Benz	TR 3296 I	3187214769751 (ZA673402A6)	880,000
6	Autoveturë	Benz-190	TR 0681 G	NDB 20102210005341	700,000
7	Autoveturë	Benz - 300	TR 5242 K	DHDB 124301A386421	690,000
	<b>Totali</b>				<b>11,270,000</b>

*Burimi: DPOP Tiranë*

**b. Mbi inventarizimin e Aseteve – AAGJM objekteve shkollore, terreneve, konstruksioneve të DPOP Tiranë**

Nga auditimi i regjistrit të Aseteve, rezulton se DPOP Tiranë ka në mirëmbajtjen e saj 132 objekte të klasifikuara **1** (një) lulishte/terren te “Konferenca e Pezës” dhe **131** (njëqind e tridhjetë e një) ndërtesa dhe konstruksione, ku përfshihen shkolla, kopshte, çerdhe, magazina, zyra, qendra të ndryshme etj . një pasqyrë e detajuar e tyre jepet në Anekse.

Nr	Emërtimi	Njësia	Nr për njësi
<b>1</b>	Lulishte		1 / 75,000 lekë
<b>NËNTOTAL / LLOGARI 210</b>		<b>1</b>	
<b>1</b>	Ndërtesë /Shkolla	cope	88
<b>2</b>	Ndërtesë/ kopshte & çerdhe	cope	6
<b>3</b>	Ndërtesë/ zyra, magazina, qendra, të ndryshme	cope	20
<b>4</b>	Konstruksione	cope	12
<b>5</b>	Ndërtesë/garda, banesa sociale, strehime	cope	3
<b>NËNTOTAL / LLOGARIA 212</b>		<b>131 /</b>	<b>9,613,267 lekë</b>
<b>TOTALI</b>		<b>132/</b>	<b>9,688,267 lekë</b>

- Lista e Objekteve shkollore/ godina të papajisura me çerifikatë pronësie:

Nr.	Emërtimi i Objektit		Nr
1	Marie Logoreci	Betim Muça	12
2	Sandër Prosi	Naim Frasheri	13
3	Mustafa Gebrelleshi	Pjetër Budi	14
4	Ibrahim Broja	Gabrani i Vjetër	15
5	Andon Zako Çajupi	Gustav Majer	16
6	Ardian Klosi	Drita Pelingu	17
7	Edit' h Durham	Sinan Tafaj	18
8	Vasil Shanto	Qazim Turdiu	19
9	Shyqyri Peza	Aleks Buda	20
10	Kongresi i Manastirit	Gjergj Fishta	21
11	Karl Gega		

Burimi: DPOP Tiranë

Për sa më lart këto mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Ligj nr. 111/2018 datë 7.2.2019 “Për kadastrën”, Ligj nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, VKM nr. 329 datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, Vendim nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, Ligj nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi njohjen dhe zbatimin e Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe paketës ligjore mbi pasuritë e paluajtshme, në procedurën e inventarizimit të Aktiveve të DPOP Tiranë.

**Situata:** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në procedurën e inventarizimit të aktiveve në DPOP Tiranë, nisur nga evidencat që i'u vunë në dispozicion grupit të auditimit nga DAIK, u konstatuan këto mangësi:

**1. Për vitin 2020:-** Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve për 2 shkollat: Gjimnazi “Partizani” dhe “Sabaudin Gabrani”, janë pa nënshkrimin e drejtuesve të shkollave; Mungon nënshkrimi i anëtarit të 4 të komisionit znj. L. Y. te relacioni në 2 raste për zbatim të UB. 178/2 dt.29.05.2021 dhe Relacion i dt.24.12.2021; Mungon nënshkrimi i specialistes së Financës (në 2 raste): te kartela e inventarëve për propozim dhe përmbledhëse e inventarëve; Nuk kanë dalë Urdhra të Brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për procedurën e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0; Për sa më lart nuk janë zbatuar Ligji 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Për vitin 2021:-** Për aktivitetin e komisionit të ngritur me U- 32/2 dt.18.05.2021, mungon Relacioni i Inventarit Fizik të aktiveve; Procesverbalet e përpiluara nga komisioni i vlerësimit në 3 raste nuk janë origjinale: UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacion dt.29.09.2021; UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacion dt.01.11.2021; UB-32/2 dt.18.05.2021 Relacion i komisionit mungon; Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit; Nuk kanë dalë Urdhra të Brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për procedurën e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

**Për vitin 2022:-** Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154/2003 “Për arkivat”, “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr.4/2017 “Për Miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”;

**2. Mjetet (çiklomotora) me targa CAH 716 dhe CAH 697, janë denoncuar në Drejtorinë e Policisë Tiranë të humbur/ vjedhur. Për këto mjete nuk janë bërë procedurat e çregjistrimit të përkohshëm pranë DRSHTRR Tiranë me qëllim shmangien e detyrimeve vjetore: taksa e qarkullimit dhe gjoba e kolaudimit, të cilat edhe pse në shuma të vogla (4 vjet \*200 lekë+1,000 lekë = 1,800 lekë dhe 6 vjet \*200 lekë +1,000 lekë =2,200 lekë) duhet të zbatohen praktikisht për të shmangur pagesat e panevojshme të cilat çojnë në shpërdorimin e fondeve në rastin se do të gjendeshin në të njëjtat kushte për mjetet me detyrime vjetore (taksa e kolaudim) në vlera të konsiderueshme; Gjithashtu e njëjta praktikë vlen edhe për mjetin me targë TR 0681 G, i cili nuk rezulton në listën e mjeteve që përdoren nga njësia, por rezulton aktiv që do të thotë se detyrimet vjetore janë në rritje progresive me kalimin e kohës. Për sa më lart nuk është zbatuar Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”;**

**3. DPOP Tiranë në cilësinë e subjektit që përdor, mirëmban dhe pasqyron çdo shpenzim në bilancin e saj për mjetet e transportit, ndonëse në vitin 2021 ka kërkuar pranë bashkisë Tiranë mundësinë e çregjistrimit të përhershëm të mjeteve të amortizuara me vlerë kontabël 11,270,000 lekë, duhet të rikërkojë në mënyrë të vazhdueshme që nga ana e bashkisë Tiranë të mbyllet procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të amortizuara (teknikisht), me qëllim largimin e tyre nga ambientet e DPOP, çuarjen e tyre për skrap dhe pët të bërë të mundur shkarkimin e tyre nga kontabiliteti i njësisë.**

**4. Drejtoria e Transportit në DPOP nuk ka hartuar një bazë të dhënash elektronike mbi informacionin teknik, shpenzimet e detyrueshme vjetore dhe shpenzimet për shërbimet teknike të mirëmbajtjes, me qëllim fleksibilitet në marrjen e informacionit dhe ushtrimin e shërbimit në kohë ndaj mjetit, për të shmangur penalitete të panevojshme me pasoja financiare në buxhetin e DPOP.**

**5. Komisioni i Inventarizimit në relacionin përmbledhës ka konkluduar se: njësia publike – DPOP Tiranë ka në mirëmbajtjen e saj 131 objekte (godina) me destinacion të ndryshëm përdorimi nga**

të cilat 22 (njëzetë e tre) nuk janë de facto të DPOP; Nga këto 17 (shtatëmbëdhjetë) në vlerën kontabël 9,613,267 lekë në total, nuk janë fizikisht nën administrimin dhe mirëmbajtjen e saj (në Llog. 212); ndërsa 5 (pesë) godina përdoren nga DPOP Tiranë për nevojat e saj. Në relacionin e komisioneve të inventarizimit, që prej vitit 2017 është bërë identifikimi i tyre në listën e aktiveve, por në terren ato janë tjetërsuar pasi pronarët e tyre i kanë përfunduar dhe i kanë zhvilluar sipas nevojave apo interesave të tyre private. Ndonëse nga ana e Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës në DPOP Tiranë me shkresë zyrtare i është drejtuar ZRPP Tiranë (sot ASHK) për çregjistrimin e tyre nga DPOP Tiranë, nuk ka patur feedback nga ana e tyre për bashkëpunim. Kjo ka sjellë që këto objekte të mbeten në pronësi *de jure* të Bashkisë Tiranë dhe vlera e tyre në kontabilitetin e DPOP Tiranë.

**6.** Gjithashtu në Regjistrin e Aseteve për llog.212 disa objekte (godina) nuk e kanë vlerën e tyre fillestare (të krijimit), por kanë të regjistruar vlerën e investimit të realizuar për mirëmbajtjen e tyre; disa objekte u përkasin periudhave të hershme të krijimit (para viti 1990). Nga auditimi rezulton gjithashtu se 20 (njëzetë) objekte inventarë AAGJM- janë të pa pajisura me certifikatë pronësie; dhe se të gjitha objektet nuk e kanë aktin e vlerësimit të tyre.

**7.** DPOP Tiranë nuk i ka përcjellë zyrtarisht organit epror – Bashkia Tiranë relacionin me listën e objekteve të ‘zëna forcërisht’ nga ish- pronarët e tyre, me qëllim që Drejtoria Ligjore pranë saj t’i drejtohet zyrtarisht ASHK- së Tiranë për çregjistrimin e tyre nga pronësia e DPOP Tiranë, pasi ato rezultojnë të tjetërsuara si nga statusi juridik i pronësisë, ashtu edhe fizikisht apo nga destinacioni i përdorimit (funksionalitetit).

**8.** Mungesa e Grupit të Menaxhimit Strategjik ka bërë që njësi të ushtrijë funksionet e veta pa hartuar dhe pa miratuar një strategji dhe një rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale të DPOP si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, që do të rriste efektivitetin në aktivitetin e Drejtorisë së Aseteve, Inventareve dhe Koordinimit.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; “Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Ligjin nr. 9154/2003 “Për arkivat”, “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr.4/2017 “Për Miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Ligj nr. 111/2018 datë 7.2.2019 “Për kadastrën”, Ligj nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, VKM nr. 329 datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, Vendim nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, Ligj nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”. Udhëzimi nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi i vitit 2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

**Ndikimi:** Nga DPOP Tiranë rezulton të mos jenë përmbushur detyrimet lidhur me të gjitha hapat e procedurës së inventarizimit veçanërisht krijimin e komisionit të asgjësimit të atyre inventarëve të vlerësuar si të papërdorshme apo me jetën e dobishme 0 (për jashtë përdorimi) dhe atyre që nuk janë *de facio* në mirëmbajtje dhe administrim të njësisë, sipas përcaktimeve ligjore/nënligjore, duke mos paraqitur kështu në bilanc vlerën reale në llog. 212 (godina të zëna forcërisht dhe ato pa vlerë të krijimit) dhe llog. 215 të mjeteve të cilat janë në kushte teknike qarkullimi dhe për të cilat shpenzohet një fond i caktuar vjetor për mirëmbajtje; Gjithashtu mungesa e Grupit të Menaxhimit Strategjik ka sjellë mos hartimin/ miratimin e një strategjie për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre; mungesa e të cilës riskon efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi aktivet e njësisë.

**Shkaku:** Gjatë periudhës nën auditim 2020, 2021 dhe 2022 Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur në përmbushjen e detyrimeve ligjore/nënligjore lidhur me procedurën e inventarizimit të aktiveve të Njesisë dhe pasjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm sa më efektiv mbi aktivet e njesisë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi 1:** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njesisë kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të transportit të amortizuara, me qëllim që vlera e llog. 215 të jetë sa më reale dhe të përfaqësojë ato mjete transporti të cilat realisht janë në gjendje teknike për të qarkulluar.

**Rekomandimi 2:** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për çregjistrimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) objekteve që janë ‘të zëna forcërisht’, për vlerësimin kryesisht të atyre pa vlerë fillestare të krijimit, për pajisjen me certifikatë pronësie të 21 (njëzetë e një) objekteve shkollore, për të pasqyruar një vlerë sa më reale të llog. 212 dhe llog. 210 në kontabilitetin e njesisë.

**Rekomandimi 3:** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre, miratimin e një Rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njesisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

## II. Auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2020 – 31.10.2022 në DPOP Tiranë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike është njësi në varësi të Bashkisë Tiranë. Struktura Organizative dhe buxheti për zhvillimin e aktivitetit të saj miratohen nga Bashkia (kryetari dhe këshilli bashkiak), në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Për një ushtrim efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave institucionale dhe në arritjen e objektivave të bashkisë Tiranë në realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative, DPOP ka kompozuar struktura organizative për të arritur këto objektiva.

Viti	Nr. i Drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit Plan / Fakt	
2019	5	17	358	355
2020	5	17	375	400
	5	18	400	
	8	18	400	
2021	9	20	415	415
	9	20	415	
	9	21	415	
	9	21	415	
2022	9	22	425	425

Burimi: DPOP Tiranë

Struktura e DPOP Tiranë si njësi në varësi të Bashkisë Tiranë, emërimet e personelit përbërës të saj, janë kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm bazuar në Ligjin nr.7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” neni 19; ndërsa Këshilli Bashkiak ushtron kompetencat e tij bazuar në nenin 54/ç, dh të po këtij ligji në miratimin e nivelit të pagave dhe buxhetit ku konfirmohet edhe

numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturë.<sup>19</sup> Personeli në Strukturat organizative të DPOP Tiranë për periudhën që auditojmë ka një shpërndarje si në tabelë:

Nr	Emërtesa për pozicion në Strukturë	Nr. Personeli 2019 (1 strukturë)	Nr. Personeli 2020 (3 struktura)	Nr. Personeli 2021 (4 struktura)	Nr. Personeli deri më 31.10.2022 (1 strukturë)
1	Drejtori I Përgjithshëm	1	1 1 1	1 1 1 1	1
2	Drejtor Drejtorie	5	5 5 8	9 9 9 9	9
3	Përgjegjës Sektori	8	8 8 8	9 9 9 9	9
4	Përgjegjës Sektori (mirëmbajtje prodhimi)	9	9 10 10	11 11 12 12	12
5	Specialist I	19	19 20 20	22 23 22 25	27
6	Specialist II	14	15 16 16	18 19 19 21	22
7	Specialist III	7	7 7 7	9 10 10 7	7
8	Administrator ne shkolla	50	50 50 49	49 48 48 48	55
9	Teknik i mesem (inventarizues, preventivues, arketar, arkivist)	25	30 32 32	31 30 30 29	29
10	Shofer mjete teknologjik	2	2 3 3	5 5 5 6	6
11	Shofer mjete mbi 2.5 t	2	2 2 2	2 2 2 2	2
12	Punëtor mirembajtjeje (hidraulik, elektrikist, cbllokues, marangoz, muator, bojaxhi, punëtor vendstrehimi ddd)	87	91 108 106	110 109 109 111	111
13	Shofer	8	10 12 12	12 12 12 12	12
14	Magaznier	4	4 4 4	5 5 5 5	5
15	Punëtor	19	24 24 24	24 24 24 20	20
16	Pastruese	98	98 98 98	98 98 98 98	98
<b>Totali</b>		<b>358</b>	<b>375 400 400</b>	<b>415 415 415 415</b>	<b>425</b>

Burimi: DPOP Tiranë

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesat të përshatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Njesisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. [SBNJ] nga ana e tij pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimit ligjorë në fuqi, “Kodit të punës”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar. Gjithashtu [SBNJ] harton Formularët e

<sup>19</sup> Vendimet e Kryetarit lidhur me Strukturat organizative të DPOP janë pasqyruar në Akt konstatimin për pikën e programit nr.1 mbi “Njohjen dhe implementimin e komponentëve të MFK”



Përshkrimin të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke e bërë pjesë të dosjes në zbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike.

- Strukturat e institucionit janë hartuar/miruar sipas kërkesave të Ligjit nr.139/2015 neni 64/j, ku specifikohen elementët që duhet të përmbajë Struktura organizative e NJVQV: pozicioni, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, numrin e personelit për çdo pozicion, në përputhje kjo me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu nga tabela rezulton se ka rikompozime të njësisë të strukturës, lëvizje të numrit të personelit dhe qarkullim të tyre brenda njësisë.

Viti	Numri i Drejtorive	Numri i Sektorëve	Numri i Punonjësve		Diferenca
			Plan	Fakt	
2019	5	17	358	358	0
2020	8	18	400	400	0
2021	9	21	415	415	0
2022	9	22	425	425	0

Burimi: DPOP Tiranë

Si rezultat i ristrukturimeve të Drejtorive apo sektorëve që janë shoqëruar edhe me pozicione të reja, ka patur efekte të cilat si vende vakante që janë në DPOP Tiranë, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Viti	Numri sipas planit	Numri në fund viti	Vende Vakante
1	2019	375	372	3
2	2020	400	400	0
3	2021	415	415	0
4	2022	415	415	0

Burimi: DPOP, Tiranë

- Nga auditimi i lëvizjeve dhe i ndryshimeve në strukturat organizative të DPOP Tiranë, pasqyruar në tabelën e mësipërme, vihet re se në vitet 2020, 2021 dhe 2022 nuk ka vende vakante, pasi në gjykimin tonë meqë procedurat e punësimit me Kod Pune janë më fleksibël dhe kërkesa për punë e lartë, bëhet i mundur plotësimi brenda një afati kohor të shkurtër i tyre. Vendet vakante janë krijuar si rezultat i ristrukturimeve dhe i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Arsyet e largimit	2019	2020	2021	2022	TOTAL I
Pension	0	0	4	3	7
Doreheqje	4	30	23	12	69
Me procedurë	1	6	3	0	10
Përfundim kontratë	3	1	4	1	9
KMCAP	0	0	1	0	1
Transferim	0	3	0	0	3
Ndarje nga jeta	0	1	1	0	2
<b>TOTALI</b>	8	40	36	16	101

Burimi: DPOP Tiranë

[DPBNJP] si struktura përgjegjëse për personelin, njofton për çdo rast Drejtorin e Përgjithshëm mbi vendet vakante në strukturën organizative të njësisë publike, i cili nga ana e vet në fillim të çdo viti nxjerr Urdhrat për ngritjen e Komisionit që ndjek procedurën e punësimit: njoftimi,

konkurrimi, shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesit, etj, dhe ka afat një vjeçar.. Për vitin 2020 është Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 43 datë 08.01.2020; për vitin 2021 është Urdhri nr. 05 datë 05.01.2021 i ndryshuar me nr 05/1 datë 01.03.2021 për arsye të zëvendësimit të njërit prej anëtarëve të komisionit, “për largim nga puna”; për vitin 2021 me Urdhrin nr. 02 datë 05.01.2022 i ndryshuar me nr. 1897 datë 04.05.2022 për arsye të zëvendësimit të njërit prej anëtarëve të komisionit, “për largim nga puna”.

Nr.	Përbërja e komisionit viti 2020	Përbërja e komisionit viti 2021	Përbërja e komisionit viti 2022
1	R. B. kr.	R. B. kr.	R. B. kr.
2	E. B.	E. B.	E. B.
3	M. B.	A. J. ≠ E. F.	M.B.
4	R. N.	R. N.	R. N.
5			E. F. ≠ V. H.

Burimi: DPOP Tiranë

- Nga auditimi i procedurës së rekrutimit, rezultoi se punësimi për pozicione të veçanta (pozicionet me klasa), janë punësuar persona pa plotësuar kriteret që duhet të plotësojë pozicioni në strukturë, kjo në gjykimin tonë rezulton pasi kriteret bazë që duhet të plotësojë aplikuesi për punësim duhet të shoqërohen me kriteret specifike domosdoshmërisht të përcaktuara nga DPOP Tiranë. Pozicionet e kësaj kategorie janë: hidraulik, elektrikist, marangoz, saldator, murator, kaldaist dhe shofer.

- Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e DPOP Tiranë rezulton se nuk ka pozicione të caktuara me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptiane etj.) si personel administrativ apo të atyre me klasa. Por në DPOP Tiranë ka të punësuar me këtë status, konform kjo me Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”. Pra rezulton se nga DPOP Tiranë, janë respektuar aktet ligjore e nënligjore për dhënie përparësie rekrutimit të personave të grupit të veçantë, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi
1	O. T.	Roje	Invalid
2	M. J.	Punëtor	Komuniteti Rom
3	E. S.	Zhblllokues	Komuniteti Rom
4	S. Z.	Sanitare	Invalid i pjesshëm
5	I. T.	Roje	Invalid i pjesshëm

Burimi: DPOP Tiranë

Procedura e punësimit në DPOP Tiranë i nënshtrohet përcaktimeve të Ligjit nr.7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nga auditimi rezultoi se njoftimet për punësim bëhen me vendosjen e tyre në stendat e mjediseve të njësisë, dhe nuk ka publikim të tyre në AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), web-in e Bashkisë pasi vet DPOP nuk ka, në median e shkruar apo vizive, në rrjetet sociale.

**2. Strukturat Organizative paraqesin informacion të qartë mbi klasifikimin, kategorinë dhe grupin të cilit i përket çdo pozicion. Në tabelë pasqyrohen kategoritë dhe grupi i pagave:**

Njësitë e punës	Grupi
Drejtor i Përgjithshëm	II a
Drejtor Drejtorie	II b
Përgjegjës Sektori	III a
Specialist I	III b
Specialist II	IV a

Specialist III	IV b
Pastrues	Klasa I
Magaznier	Klasa V
Furnitor	Klasa VI
Punëtor	Klasa III
Administrator në shkolla	Klasa X
Teknik	Klasa VI
Hidraulik	Klasa IV
Elektricitist	Klasa IV
Marangoz	Klasa IV
Murator	Klasa IV
Bojaxhi	Klasa IV
Saldator	Klasa IV
Zhblllokues	Klasa IV
Kaldaist	Klasa IV
Preventivues	Klasa IV
Shofer mjeti deri në 2.5 t	Klasa IV
Shofer mjeti mbi 2.5 t	Klasa VIII
<b>Nr. Kategori</b>	<b>23</b>

Burimi: DPOP Tiranë

- Nga auditimi rezultoi se në strukturën e DPOP Tiranë, referuar fushës së aktivitetit të saj, ka pozicione që kanë shkallë vështirësie dhe punonjësit e këtyre pozicioneve përballen me këto vështirësi në përditshmërinë e tyre në përmbushje të detyrës gjatë orarit zyrtar. DPOP Tiranë i ka kushtuar vëmendjen e duhur kësaj kategorie, për ta trajtuar konform VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar;

- DPOP Tiranë çdo vit sipas nevojave të saj, emëron punonjës me kontratë provizore dhe me kohë të plotë, konform ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe trajtimi me pagë, pagesa e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet konform ligjit 7705/1995 “Për sigurimet shoqërore”, VKM nr. Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”;

Nr i punonjësve me kontrate te përkohshme 2019	Nr i punonjësve me kontrate te përkohshme 2020	Nr i punonjësve me kontrate te përkohshme 2021	Emërtimi
4	4	3	Specialist
1	0	1	Inventarizues
<b>5</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>Total</b>

Burimi: DPOP Tiranë

- DPOP Tiranë nuk ka punonjës të punësuar me kohë të pjesshme;  
- Në librin e kontabilizimit të pagave, nuk rezultojnë punonjës të paguar jashtë strukturës së miratuar.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2020 – 31.10.2022 në DPOP Tiranë.

**Situata : 1.** Nga DPOP Tiranë njoftimet për punësim nuk realizohen nëpërmjet komunikimit me mjetet dhe në strukturat përgjegjëse - SHKPA, në mos zbatim kjo të Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19/2;

**2.** DPOP Tiranë nuk ka hartuar listën e kriterëve specifike që u bashkëngjitet kriterëve bazë për punësim dhe rrjedhimisht ka punësuar persona që nuk plotësojnë kërkesat profesionale e teknike që kërkon efektiviteti i aktivitetit të njësisë (profesionet e përcaktuara në material); “Kodit të punës”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe

klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**3.** DPOP Tiranë ndonëse ka punësuar persona me status nga “grupi i veçantë” (numër i kufizuar i tyre -5-) nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione me status “Grup i veçantë”, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”.

**4.** DPOP Tiranë lidhur me trajtimin e punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, rezulton në moszbatim të VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”. Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

**Kriteri :** Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar; VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”; VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Ligjit 7705/1995 “Për sigurimet shoqërore”, VKM nr. Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”; VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

**Ndikimi:** Mungesa e politikave efektive të burimeve njerëzore ka cenuar garantimin e kriterëve dhe kërkesave të përshtatshme mbi bazën e kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit.

**Shkaku:** Mungesa e vlerësimit real të rëndësisë së përcaktimit të kriterëve profesionale në rekrutimin dhe emërimin e stafit nga ana e NA dhe Drejtorisë ligjore, të burimeve njerëzore dhe performancës.

**Rëndësia :** E lartë

**Rekomandim:** NA dhe Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe e Performancës të marrin masa për të përdorur SHKPA si i vetmi organ përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e njoftimeve për punësim; hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të caktojnë në strukturën organizative pozicione për kategorinë ‘grup i veçantë’; si dhe të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, të gjitha këto për motivimin e punonjësve rritjen e efektivitetit të shërbimeve nga ana e tyre në dobi të komunitetit.

## **2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

### ***Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrimit të prokurimeve***

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vitet ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka DPOP për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB të Bashkisë Tiranë sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2020 – 30.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

<b>Procedura 01/01/2020 - 30/12/2022</b>	<b>Nr.</b>	<b>Vl.Fond Limit</b>	<b>Vl.Kontrate</b>
<b>GJITHESEJ</b>	<b>64</b>	<b>1,229,793,301</b>	<b>1,182,112,972</b>
-Të hapura	25	1,056,182,070	1,016,024,467
- Kërkesë me propozim/E Hapur e Thjeshtuar	38	156,297,481	148,950,675
- Negocim pa shpallje	1	17,313,750	17,137,830
<b>Sipas objekteve</b>	<b>64</b>	<b>1,229,793,301</b>	<b>1,182,112,972</b>
-Objekte në fushën e investimeve	8	150,076,679	146,465,354
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	56	1,079,716,622	1,035,647,438

*Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.*

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2020 – 30.12.2022, janë realizuar gjithsej **64** procedura<sup>20</sup> me vlera të larta me fond limit 1,229,793 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 1,182,112 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 47,681 mijë lekë ose 4%, nga e cila: **për vitin 2020** janë realizuar gjithsej **33** procedura me fond limit 809,779 mijë lekë dhe vlerë kontrate 777,978 mijë lekë, **për vitin 2021** janë realizuar **17** procedura me fond limit 224,394 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 217,240 mijë lekë pa TVSH dhe për **vitin 2022** janë realizuar **14** procedura me fond limit 195,618 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 186,894 mijë lekë pa TVSH.

Kanë marrë pjesë në procedura **181** OE/BOE dhe janë s'kualifikuar **105** OE/BOE.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **8** procedura me fond limit 150,076,679 mijë lekë ose 12% e kontratave të lidhura dhe në të tjera (shërbime/blerje mallrash) janë **56** procedura me fond limit 1,079,716 mijë lekë ose 88%.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **19** procedura ose 29% e procedurave të zhvilluara.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **64** procedura me fond limit 1,229,793 mije lekë janë vlerësuar për auditim **47** procedura me fond limit 1,190,582 mijë lekë ose 97% e fondit limit, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

**Titulli i gjetjes: KLSH-ja**, konstatohet se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2020 - 30.12.2022, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

**Situata:** Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2020 – 30.12.2022, janë realizuar gjithsej **64** procedura me fond limit 1,229,793 mije lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 1,182,112 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 47,681 mijë lekë ose 4%, nga e cila: **për vitin 2020** janë realizuar gjithsej **33** procedura me fond limit 809,779 mijë lekë dhe vlerë kontrate 777,978 mijë lekë, **për vitin 2021** janë realizuar **17** procedura me fond limit 224,394 lekë pa TVSH

<sup>20</sup> Trajtuar gjerësisht në Aneksin nr. 4, tabelat 1, 2 dhe 3

dhe vlerë kontrate 217,240 mijë lekë pa TVSH dhe për **vitin 2022** janë realizuar **14** procedura me fond limit 195,618 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 186,894 mijë lekë pa TVSH.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **64** procedura me fond limit 1,229,793 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **47** procedura me fond limit 1,190,582 mijë lekë ose 97% e vlerës së fondit limit, nga e cila: për vitin 2020 nga **33** procedura me fond limit 809,779 mijë lekë janë audituar **23** procedura me fond limit 785,358 mijë lekë ose 97% e vlerës së fondit limit, për vitin 2021 nga **17** procedura me fond limit 224,394 mijë lekë janë audituar **13** procedura me fond limit 217,503 mijë lekë ose 97% e vlerës së fondit limit dhe për vitin 2022 nga **14** procedura me fond limit 195,618 mijë lekë janë audituar **11** procedura me fond limit 187,721 mijë lekë ose 96% e fondit limit të prokuruar.

Nga auditimi i **47** procedurave me fond limit **1,190,582** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, **14** procedura ku kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, në **2** raste procedura duhej të ndahej në lote, në **2** raste Specifikimet Teknike nuk janë në përputhje me rregullat e LPP, dhe në **13** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **111,008 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61 konkretisht sipas periudhave:

- a- **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i **23** procedurave me fond limit 785,358 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, **7** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, në **2** procedura specifikimet teknike janë kufizuese dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.
- b- **Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i **13** procedurave me fond limit 217,503 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, **3** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura, në **2** rast procedura duhej të ndahej në lote dhe në **3** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.
- c- **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i **11** procedurave me fond limit 187,721 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, **4** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 20, “Mosdiskriminim”, Neni 23, “Specifikimet teknike”, Neni 24, “Anulimi i një procedure”, Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, pika 5, “Kontratat për punë publike”, Neni 27, pika 3, “Kontratat e mallrave”, Neni 28, pika 2, “Kontratat e shërbimeve”, Neni 61, pika 2, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” Neni 74, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të ndryshuara me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**Shkaku:** Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

**Ndikimi:** Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST për vlerën **111,008 mijë lekë**.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurime publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2020 – 31.12.2020**

*-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01/01/2020 – 31/12/2018, nga DPOP referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **33** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 809,779 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 777,978 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 31,801 mijë lekë pa TVSH ose 4 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2020 - 31/12/2020	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
<b>GJITHESEJ</b>	<b>33</b>	<b>809,779,968</b>	<b>777,978,190</b>
-Të hapura	12	712,585,772	683,198,020
- Kërkesë me propozim	20	79,880,396	77,642,340
- Negocim pa shpallje	1	17,313,750	17,137,830
<b>Sipas objekteve</b>	<b>33</b>	<b>809,779,968</b>	<b>777,978,190</b>
-Objekte në fushën e investimeve	2	38,215,847	37,649,074
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	31	771,564,121	740,329,116

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **92** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **51** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **11** procedura ose 33 % e procedurave të zhvilluara. Nga auditimi i **23** procedurave me fond limit 785,358 mijë lekë, u konstatuan në shkëlqje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, **7** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, në **2** procedura specifikimet teknike janë kufizuese dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimin të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre., *si më poshtë vijon:*

#### **1. Tenderi me objekt: “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”, me këto të dhëna:**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.37, datë 05.11.2019	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 37, datë 05.11.2019 1. K. Ll. – Jurist 2. V. K. – Inxhinier 3. A. S. – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.37/1, datë 05.11.2019 1. R. B.-(Kryetar) 2. A. U. – (Anëtar) 3. R. R. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	6.Oferta fituese: OE “A.” shpk” me ofertë 45,239,079 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 22.01.2020, me afat 24 muaj,	7.Diferenca me fondin limit: 3,582,651 - lekë pa tvsh
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 48,821,730 - lekë pa tvsh		

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 24.12.2019	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Për sa i përket pikës 2.3 g) të DST kërkesa për me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet për ngrohje në objektet arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në pajisjet në të cilat do të përdoret (soba me pellet dhe kaldaja me pellet), pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte pajisjet teknike.*

**Shpjegim shtesë:** *Grupi i auditimit e konsideron gjetjen të një rëndësie të lartë që ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por nga shqyrtimi i dokumentacionit të 5 (pesë) operatorëve ekonomikë ofertues rezulton që të gjithë operatorët ekonomikë ofertues e plotësojnë këtë kriter dhe asnjë prej tyre nuk rezulton i skualifikuar për mospërmbushje të këtij kriteri. Në procedurat e mëparshme autoriteti kontraktor në një mendim me gjetjen e audituesve për këtë pikë e ka kërkuar këtë analizë që të ishte të paktën e tre muajve të fundit që të lidhej me furnizimin e fundit të operatorit ekonomik lidhur edhe me sasinë e kërkuar në preventiv por rekomandimet e APP e kanë konsideruar këtë kriter kufizim për operatorët ekonomikë dhe jemi detyruar ta zgjasim vlefshmërinë kohore të analizës për 12 muajt e fundit.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

1. Pranohen pretendimet e observuesve, pasi argumentohet se afati 12 muaj për raport testimet, nuk ka ndikuar në numrin e OE pjesëmarrës.

## **2. Tenderi me objekt: “Shërbim Mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm”, me këto të dhëna:**

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim Mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm”</b>		
1. Urdhër Prokurimi : Nr.36, datë 05.11.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.36, datë 05.11.2019 1. K. Ll. – Jurist	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.36/1, datë 05.11.2019 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. V. K. – Inxhinier 3. A. Xh. – Inxhinier	2. A. U. – (Anëtar) 3. I. P. – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 50,375,000 - lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: BOE C. shpk & A. shpk me ofertë 49,912,410 lekë - me lidhje kontrate datë 06.01.2020, me afat 24 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 462,590 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.12.2019	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka



**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve 1.** Kërkesa e pikës **3.4 e DST** e cila kërkon që të paktën njëri nga inxhinierët e OE ofertues të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi PLC për pajisjet inverter të kontrollit të sistemeve industriale, automatike dhe mekanike, është kërkesë e tepërt. Objekti i kontratës është mirëmbajtja e impianteve, dhe punimeve të riparimit të cilat duhet të kryhen nga staf i kualifikuar. Kërkesat për inxhinierët me certifikata trajnimi të posaçme nuk është në raport me kontratën dhe qëllimin e saj. Përbën kufizim për OE.

2. Kërkesa e pikës **3.6 e DST** e cila kërkon nga OE të disponojë specialistë termodinamikë, saldatorë, elektrikistë dhe hidraulikë, ka kërkuar që të disponojnë certifikata trajnimi për fushën ngrohje/ftohje dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik minimumi niveli I, II apo i III. Kërkesa që dëshmia e sigurimit të jetë sipas niveleve, I, II, III, përbën kufizim, pasi AK nuk ka argumentuar specifikisht nevojën që stafi krahas profilit të kërkuar, të disponojë edhe nivelin e kategorisë certifikuese.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NjP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Për sa i përket pikës 3.4 (b1) të DST, kërkesa e përcaktuar me anë të këtij kriteri cilëson që operatorët ekonomikë të kenë në stafin e tyre minimalisht 1 (një) inxhinier ndërtimi për shkak të natyrës së punimeve që parashikohen të kryhen gjashtë zbatimit të kësaj kontrate. Në preventivin e publikuar krahas DST, nuk ka punime ndërtimore të mirëfillta por për shkak të nevojës për ndërhyrje në infrastrukturë në rastet kur nevojitet ndërrimi i tubave përcjellës të ujit të instaluar përgjatë gjithë sipërfaqes së objektit, në shumë raste nën dysheme apo mure, në shërbimet e mëparshme të realizuara nga autoriteti kontraktor është konstatuar nevoja e ekspertizës së kualifikuar nga një inxhinier ndërtimi. Shpjegim shtesë: nga shqyrtimi i preventivit për të gjithë objektet arsimore ku realizohet shërbimi i kërkuar në pikën II të preventivit pasqyrohet se.... Riparim i tubacione ujë ngrohtë dërgim-kthim te dëmtuara (përfshi edhe saldime).....nga përvoja me shërbimet e mëparshme pasi kjo kontratë është periodike dhe ky shërbim realizohet çdo vit buxhetor është konstatuar se në shumicën e rasteve tubacioni përcjellës i ujit të kaldajës në radiatorët në të gjithë sipërfaqen e ndërtesave ndodhet brenda në mur i mbuluar me materiale inerte dhe nuk kalon nëpër kanalizime të veçanta me akses ndërhyrje. Në disa raste kur ka patur nevojë për ndërhyrje në mure dhe dysheme është konstatuar kryqëzim i tubacioneve të ujit të pijshëm dhe në disa raste dhe kabullave elektrikë prandaj ka qenë e pamundur ndërhyrja pa ekspertizën e specializuar të një inxhinieri ndërtimi.*

*Për sa i përket pikës 3.4 të DST, kërkesa që të paktën njëri nga inxhinierët e operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi PLC për pajisjet inverter të kontrollit të sistemeve industriale, automatike dhe mekanike (ose ekuivalent në bazë të ligjit) është vendosur bazuar realisht në nevojat konkrete të autoritetit kontraktor. Sistemet e reja të kontrollit të kaldajave të montuara në vitet e fundit dhe sobave me pellet të instaluar në disa nga objektet shkollore dhe parashkollore në Bashkinë e Tiranës janë pajisje të sistemit inverter dhe nevoja që njëri nga inxhinierët të ketë një certifikim të tillë nuk është e ekzagjeruar. Shpjegim shtesë: nga shqyrtimi i preventivit për të gjithë objektet arsimore ku realizohet shërbimi i kërkuar në Kreun II të preventivit pasqyrohet se.... RIPARIM-MIRËMBAJTJE SOBA ME PELLET....nga shqyrtimi i këtij Kreu konstatohet se janë për tu mirëmbajtur dhe riparuar sipas nevojave 100 copë soba me pellet të shpërndara në njësitë administrative të Bashkisë Tiranë ku pjesa më e madhe e tyre në zonat rurale. Nga shqyrtimi Shtojcës 9 Specifikimet teknike, konstatohet se këto soba me pellet janë të gjitha të tipit PLC Inverter, ku nevoja për ekspertizën e një specialisti me kualifikimin e kërkuar është i domosdoshëm. Për sa i përket konstatimit që ky specialist mund të mos jetë patjetër inxhinier por mjafton kualifikimi i përkatës sipas kërkesave të DST, pranohet ky konstatim dhe do të pasqyrohet në procedurat e mëvonshme periodike që do të realizojë autoriteti kontraktor.*

*Për sa i përket pikës 3.6 të DST, ku kërkohen specialistë të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve të parashikuara të pajisur me çertifikata trajnimi dhe kualifikime profesionale ky është një kriter në përputhje me objektin e prokurimit. Për sa i përket konstatimit tuaj për tejkallim të nevojave reale në përcaktimin e niveleve të kualifikimit profesional të specialistëve, ky konstatim pranohet dhe do të merren masat e nevojshme që ky kriter në të ardhmen të vendoset në përputhje me rekomandimet tuaja në këtë auditim.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

**1.** Pranohet pjesërisht observacioni juaj lidhur me pikën 1, për inxhinierin e ndërtimit, pasi argumentoni ekspertizën e tij, ndërsa për pikën 2, pavarësisht argumentimeve të dhëna, sqarohet se kërkesa që OE të disponojë pikërisht një inxhinier me këtë kualifikim për pajisjet inverter, rendon pozitat e OE. Edhe vetë observuesit, e kanë trajtuar në observacionet termin specialist me kualifikim, dhe jo domosdoshmërisht inxhinier.

**3. Tenderi me objekt: “Blerje automjet Pick Up”, me këto të dhëna:**

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjet Pick Up”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.14, datë 26.06.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.14, datë 26.06.2020 1. K. Ll. – Juriste	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.14/1, datë 26.06.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për Propozim”	2. I. P. – Inxhinier 3. E. A. – Ekonomiste	2. A. U. – (Anëtar) 3. V. K. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 2,915,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “A.” sh.a me ofertë 2,677,500 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 03.08.2020, me afat 20 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 237,500 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.07.2019	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve, specifikimeve teknike dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3/a e DST** e cila kërkon nga OE të jenë të pajisur me licencë me Kodin VII.3.B.1, është kërkesë jo në përputhje me objektin e prokurimit, pasi kjo licencë është për Autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ndërkohë që licenca e cila përmban objektin e aktivitetit, është licenca me Kod VII.3.B.2 e cila ka për objekt *Shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove të reja ose të përdorura.*

**Specifikimet teknike:** -Lidhur me specifikimet teknike të vendosura për dimensionet e përgjithshme, audituesit konstatojnë se dimensionet e përcaktuara janë me diferenca minimaliste si lartësia 180 cm – 182 cm, gjerësia pa pasqyra 197 cm -198 cm, lartësia nga toka 23 cm – 24 cm, gjatësia e karrocërisë 161 cm – 162 cm, gjerësia e karrocërisë 156 cm – 157 cm dhe lartësia e spondit të karrocërisë 51 cm – 52 cm. Siç konstatohet, dimensionet e kërkuara kanë diferenca minimaliste ndërmjet vlerës minimale dhe maksimale të kërkuar me pothuaj 1 ose 2 cm, diferenca të cilat nuk janë konkurruese, dhe potencialisht pengojnë OE për paraqitjen e ofertave. Specifikimet teknike të vendosura, janë në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE “A.” sha, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore. Sipas ekstraktit të QKB, ky OE ka adresë kryesore në Vlashaj, Durrës, ndërkohë nuk figuron të ketë likuiduar taksat vendore pranë kësaj bashkie.

2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3/ë të DST e cila kërkon nga OE të paraqesin katalogun/ fragmente katalogu ose skeda teknike të publikuara nga prodhuesi. Dokumentacioni i kërkuar duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik.

-Lidhur me këtë kërkesë, është paraqitur dokumenti Katalog\_Ford\_Ranger, i cili rezulton në gjuhë të huaj dhe i pa përkthyer dhe noterizuar, në kundërshtim me DST.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, specifikimet teknike dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NjP, KVO dhe Komisionit për Hartimin e Specifikimeve Teknike.**

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Për sa i përket pikës 2.3 a) të DST kërkesa që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin zyrtar që vërteton të jetë i pajisur me licencë me kodin VII.3.B.1 për blerje, shitje, e mjeteve me motor dhe rimorkio sipas legjislacionit në fuqi, të lëshuar nga organet kompetente shtetërore është bazuar në bazën ligjore në fuqi. Pajisja me këtë licencë garanton dhe të drejtën për shërbimet gjatë periudhës së garancisë për automjetin. Konstatohet se rekomandimi juaj për përfshirjen e licencës me kodin VII.3.B.2 është i drejtë pasi duhej vendosur si kërkesë alternative, krahas kërkesës për licencën e kërkuar në DST. Në procedurat e ngjashme në të ardhmen do të hartohet ky kriter sipas rekomandimit tuaj.*

**Shpjegim shpresë:** *nga shqyrtimi i licencës VII.3.B.1 rezulton se me anë të kësaj licencë jepet e drejta që përveç riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve dhe e drejta për shitjen e automjeteve. Për sa i përket diapazonit të vendosur në dimensionet e përcaktuara në specifikimet teknike për automjetin, pranojmë rekomandimin tuaj për rritjen e këtij diapazoni dhe në procedurat e ngjashme në të ardhmen do të hartohet këto specifikime sipas rekomandimit tuaj.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Sqarimet e dhëna janë të njëjta me ato të paraqitura mbi Akt Konstatimin e mbajtur dhe të trajtuara në Projekt Raport. Kërkesa për licencën me kodin VII.3.B.1 nuk përputhet me objektin e prokurimit.

#### 4. Tenderi me objekt: “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore”, me këto të dhëna:

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore”.		
1. Urdhër Prokurimi : Nr.20, datë 20.07.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.20, datë 20.07.2020 1. K. Ll. - Jurist	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.20/1, datë 20.07.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. V. K. - Inxhinier 3. E. B.- Ekonomist	2. A. U. – (Anëtar) 3. I. P. – (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 35,848,238 - lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: BOE R.-Er sha & K. group sha me marzh fitimi 8%, me lidhje kontrate datë 05.10.2022, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 20.08.2020	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, 1.R. sha, nr. 2730 prot., datë 03.08.2020 (për kriteret)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1.Nr. 2730/4 prot., datë 05.08.2020	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës 2.3/4 e DST e cila kërkon nga OE depozita me kapacitet më të madh 3000m<sup>3</sup> dhe në Bashkinë Tiranë me kapacitet minimumi 150m<sup>3</sup>, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në raport me volumin e pritsëm furnizimit të kërkuar nga AK. Konkretisht janë kërkuar rreth 300,000 litra lëndë djegëse gazoil për 12 muaj, ndërkohë që kapaciteti i kërkuar është për depozita 3 milion litërshe dhe 150,000 litërshe në bashkinë Tiranë, pra janë depozita relativisht të mëdha, për sasi shumë më të mëdha se ato të kërkuara për furnizim nga AK, çka potencialisht mund të përbëjë kufizim për OE për paraqitje oferte.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 5. Tenderi me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim”, me këto të dhëna:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.24, datë 10.08.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.24, datë 10.08.2020	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.24/1, datë 10.08.2020 1. R. S. –(Kryetar) 2. S. S. – (Anëtar) 3. Xh. L. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese me Propozim”	1. K. Ll. – Juriste 2. O. T. – ekonomist 3. Y. Ç. – specialist DDD	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 8,000,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “F.” shpk” me ofertë 7,840,000 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 08.10.2020, me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 160,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.09.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, 1. Nr. 2946 prot., datë 25.08.2020 – I. shpk (për kriteret)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. Nr. 2946/4 prot., datë 26.08.2020	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1.OE nuk përmbush specifikimet teknike për sipas pikës 2 për preparat dezinfektimi kundër viruseve, baktereve dhe kërpudhave sipas të cilit kërkohet:

Gjendja fizike: i lëngshëm

Ngjyra: verdhë/kafe e kthjellët

Vlera e pehashit (pH): ≈ 4

Pika e zierjes: ≥ 90 °C

**Pika e ngrirjes:** ≥ -13 °C është -13.5

Densiteti: 1 ± 0,1 kg/litër

Tretshmëria në ujë: 100%

Biodegradimi: ≥ 95% (në përputhje me kriteret e biodegradimit, të përcaktuara në Rregulloren (KE) Nr.648/2004 për kimikatet.)

**Viskoziteti kinematik:** 2,250 - 2,260 mm<sup>2</sup>/s

**Viskoziteti dinamik:** 2,7 -2,9 mPa/s (20 °C)

-Për të përmbushur këtë kriter është paraqitur fleta e analizës së lëshuar nga C. shpk, lëshuar të subjektit të autorizuar “M.” shpk me të cilin ka lidhur kontratë OE “F.” shpk. Në fletën e analizës, mungojnë të dhënat ose parametrat teknike si *Pika e ngrirjes, Viskoziteti kinematik dhe Viskoziteti dinamik* të kërkuar nga NJP në DST.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO.**

**Ndikimi:** Nuk jep garanci për produktin sipas kërkesës në DST.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 6. Tenderi me objekt: “Mobilimi i magazinës me rafte metalike”, me këto të dhëna:

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mobilimi i magazinës me rafte metalike”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.26, datë 17.08.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.26, datë 17.08.2020 1. M. S. – Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.26/3, datë 14.09.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese me Propozim”	2. I. P. - ekonomiste 3. D. Sh. - inxhiniere	2. K. L. – (Anëtar) 3. E. I. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 3,560,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “F. 2.” shpk” me ofertë 3,500,000 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 06.10.2020, me afat 10 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 60,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 14.09.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3.5/b e DST** e cila kërkon nga OE 1 specialist të pajisur me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga fabrika prodhuese për antisizmitetin, është kërkesë diskriminuese, kufizuese e cila pengon OE. Lidhur me antisizmitetin e produktit është përgjegjësi e fabrikës prodhuese, e cila duhet të japë garancitë përkatëse, ndërsa stafi i kualifikuar pikërisht nga këto fabrika prodhimi përbën kërkesë të tepërt dhe të pambështetur ligjërisht. Njëkohësisht, certifikime të tilla, nga subjekte të cilat nuk janë të akredituara nga RSH, që mund të lëshohen nga institucione apo organe tjera jashtë vendit, mund të rezultojnë në kërkesa të cilat cenojnë procedurat e prokurimit publik në RSH, duke ndikuar në barazinë mes ofertuesve.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5/c të DST** e cila kërkon nga OE të kenë të regjistruar në listëpagesë projektuesin e saj me kohë të plotë, është kërkesë e pa plotë, evazive e cila nuk i shërben procedurës por përbën kufizim për OE. Së pari AK duhet të specifikonte të dhënat e nevojshme për projektuesin, se çfarë projektuesi duhet, dhe njëkohësisht dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë ai, certifikatë/diplomë etj.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE “F.” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2020 sipas kësteve. Në ekstraktin historik të shoqërisë, në rubrikën 13 *Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit*, ky OE ka deklaruar adresën Vorë, ndërkohë nuk figuron të ketë likuiduar detyrimet vendore sa kërkuar në DST për vitin 2020.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

**7. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë në Qendrën Komunitare Shkozë dhe ambientet ndihmëse”, me këto të dhëna:**

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë në Qendrën Komunitare Shkozë dhe ambientet ndihmëse”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.31, datë 02.09.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.31, datë 02.09.2020 1. K. Ll. – Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.31/3, datë 02.11.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese me Propozim”	2. E. B. – Inxhinier 3. J. C. – Ekonomiste	2. A. Xh. – (Anëtar) 3. K. L. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,997,569 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE A. shpk & C. shpk me ofertë 5,817,575lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 27.11.2020, me afat 60 dite	7.Diferenca me fondin limit: 179,994 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.11.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, 1. Nr. 3741 prot., datë 15.10.2020, H. shpk (Për kriteret)	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. Nr. 3741/4 prot., datë 20.10.2020	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.5 e DST** e cila kërkon nga OE të përcaktojnë drejtuesin teknik të punimeve, i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, është kërkesë në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **6 milion lekë**, vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik të punimeve në kantier dhe të paangazhuar në kontrata tjera.

2.Kërkesa për 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE “A.” shpk nuk përmbush kriterin për pikën **2.3.2 të DST** për stafin inxhinierik dhe **2.3.5 të DST** për stafin e punonjësve, pasi pavarësisht se sipas akt marrëveshjen ka deklaruar marrjen përsipër të 10% të punimeve, nuk ka paraqitur asnjë punonjës sa më sipër.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe nuk garanton që BOE ka kapacitet e nevojshme për zbatimin e kontratës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 8. Tenderi me objekt: “Blerje materiale higjino - sanitare”, me këto të dhëna:

8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale higjino – sanitare”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.43, datë 23.09.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.43, datë 23.09.2020 1. K. Ll. – Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.43/3, datë 23.09.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. E. B. – ekonomist 3. Y. Ç. – kimiste	2. E. Ll. – (Anëtar) 3. K. L. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 140,364,176 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “P. S.” shpk” me ofertë 133,887,038 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 02.12.2020, me afat 2 vjet.	7.Diferenca me fondin limit: 6,477,138 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 26.10.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës 2.3/a e DST e cila kërkon nga OE të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi, është kërkesë e fryrë dhe jo në përputhje me qëllimin e procedurës. Në listën e mallrave, janë 27 produkte të kërkuara nga AK, të cilat janë lehtësisht të gjindshme në treg, të cilat mund të prodhohen nga një numër i madh subjektësh që kanë për fushë aktiviteti prodhimin e tyre. Potencialisht kjo mund të çojë OE të paraqesin një numër të madh prodhuesish ose distributorësh zyrtar për produkte të cilat gjenden lehtësisht në treg. AK, paralelisht ka kërkuar nga OE paraqitjen e mostrave për të verifikuar nëse janë në përputhje me specifikimet teknike, dhe në këto kushte kërkesat që të paraqiten edhe autorizimet e mësipërme, përbën pengesë për OE që kanë për objekt këtë lloj aktiviteti, përmbushin kriteret teknike, ekonomike etj të përcaktuara në DST. Është kërkesë kufizuese.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NjP.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit: Shpjegim shtesë:** Me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

*Kjo kërkesë alternative (janë konsideruar të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.*

*Vendosja e këtij kriteri nuk duhet të gjykohet në kushtet normale të zhvillimit të një procedure prokurimi sepse kjo procedurë është zhvilluar në kulmin e Pandemisë Covid-19 ku mallrat objekt prokurimi nuk ishin lehtësisht të aksesueshme në treg duke patur mungesa të theksuara dhe vetëm një pjesë e vogël e operatorëve ekonomikë në treg mund të siguronin mallra higjienizuese në një periudhë të tillë. Autoriteti kontraktor ka në detyrat e tij thelbësore funksionale mirëmbajtjen e objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe mos realizimi i përmbushjes së detyrimeve të kontratës do të passillte rrezikun e moszhvillimit të aktivitetit mësimor në të gjitha objektet arsimore.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Lidhur me sqarimet e dhëna, ato nuk pranohen. Siç është cituar edhe nga ana juaj, kërkesa për këto mallra është bërë gjatë situatës së pandemisë, ku tregu vendas dhe global ka hasur vështirësi me lëvizjen e lirë të mallrave. Në këto kushte, kërkesat që për një listë prej 27 mallrash të paraqiten njëkohësisht edhe autorizime prodhuesish apo të distributorëve, përbën kërkesë që vendos në vështirësi OE të cilët disponojnë produktet e kërkuara.

### **9. Tenderi me objekt: “Blerje automjet kamionçinë ATP 5+1/6+1 vende me bagazh hermetik”, me këto të dhëna:**

<b>9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjet kamionçinë ATP 5+1/6+1 vende me bagazh hermetik”</b>		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.50, datë 11.11.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.50, datë 11.11.2020 1. K. Ll. – Jurist 2. I. P. – Inxhinier 3. E. A. – Ekonomiste	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.50/1, datë 11.11.2020 1. E. Ll. – (Kryetar) 2. G. N. – (Anëtar) 3. V. K. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për Propozim”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 7,500,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “A.” shpk” me ofertë 7,380,000 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 10.12.2020, me afat 10 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 120,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.11.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vendosjen e specifikimeve teknike.

**Situata:** Hartimi i specifikimeve teknike: *Qëllimi i procedurës është blerja e 2 mjeteve kamionçinë me 5+1 ose 6+1, me 0 (zero) kilometër dhe të jenë të vitit 2020.*

Konstatohet se shumë prej parametrave/specifikimeve të përcaktuara që lidhen përgjithësisht me masën maksimale të autorizuar të mjetit 3000-3300 kg, masën bruto të ngarkesës 900-1100 kg, vëllimin e motorit 1900-2200 cc, fuqinë motorike 75-95 kW, gjatësinë 5300 mm – 5500mm, gjerësinë 1900mm – 2100mm, lartësinë totale 1900mm – 2100mm etj.. krijojnë një panoramë komplekse të llojit të mjetit, i cili vështirëson mundësinë e konkurrimit ndërmjet OE. Në kushtet kur mjeti kërkohet i ri, i vitit përkatës që është 2020, AK duhej të përcaktonte specifikime më konkurruese kjo për të bërë të mundur një numër më të lartë ofertuesish, ndërkohë rezultoi se nuk ka patur konkurrencë duke qenë vetëm 1 ofertues. Lidhur me specifikimet teknike të cilat



janë vendosur në kundërshtim me nenin 23 të LPP, ngarkohet me përgjegjësi komisioni përkatës për hartimin e tyre.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike.**

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *1. Pretendimet e dhëna janë të njëjta me ato të paraqitura mbi akt konstatimin dhe janë trajtuar në Projekt Raport.*

**Shpjegim shtesë:** *në një shqyrtim objektiv të dimensioneve të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit vërejmë që diapazoni i lejuar për parametrat teknikë nuk është i një niveli të ngushtë që do të passillte mungesën e ofertueve në procedurë. Duhet të kemi parasysh që **kjo procedurë është zhvilluar në kulmin e Pandemisë Covid-19 dhe furnizimi me automjete me karakteristika teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor kishte kufizime për sa i përket mundësisë së furnizimit së distributorëve zyrtarë me automjete pasi rrugët tregtare ishin të bllokuara.***

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit sqarojnë se jemi para të njëjtit qëndrim, pasi pikërisht fakti që jemi në periudhën COVID-19, AK do duhej të përcaktonte diapazon me të lartë për parametrat teknikë të mjeteve, pikërisht për të krijuar mundësi më të mëdha për ofertuesit në kushtet e një kufizimi global të tregut për shkak të situatës pandemike.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

*Për sa i përket përmbushjes së kriterit të kërkuar në pikën 2.3 (b) të DST, që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit të vlefshme. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE është konstatuar paraqitja e autorizimit në gjuhën angleze dhe e pa noterizuar, por ky dokument është një dokument publik lehtësisht i konfirmueshëm në faqen zyrtare të prodhuesit dhe distributorit dhe për këtë arsye KVO e ka konsideruar të vlefshëm autorizimin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik A. shpk.*

**Shpjegim shtesë:** *në nenin 53 pika 4 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se..... 4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj..... Nga shqyrtimi kësaj dispozite ligjore konstatojmë që jemi në kushtet e një informacioni lehtësisht të verifikueshëm dhe publik dhe mosparaqitja e tij në gjuhën shqipe nuk përbën një fakt i cili ndryshon thelbësisht karakteristikat apo kushtet e vendosura në DST, pasi dhe nga kualifikimi i anëtarëve të KVO konstatojmë që janë plotësisht të aftë të verifikojnë një dokument në gjuhën angleze nëse përmban të dhënat e kërkuara në DST.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Pranohen pretendimet tuaja, por në vijim, AK për devijimet e vogla, të evidentojë ato dhe ti bëjë pjesë të raportit.

## 10. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e thellë në objektet publike”, me këto të dhëna:

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e thellë në objektet publike”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.49, datë 29.10.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.49, datë 29.10.2020 1. K. Ll. – Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.49/1, datë 29.10.2020 1. R. B. – (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. A. U. – Inxhinier 3. A. S. – Ekonomiste	2. E. I. – (Anëtar) 3. E. Ll. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 32,218,278 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “R.” shpk” me ofertë 31,831,499 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 21.12.2020, me afat 90 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 386,779 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 04.12.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës 2.3.5 e DST e cila kërkon nga OE staf të kualifikuar me diploma/certifikata të arsimit profesional dhe certifikata të sigurimit teknik, ka kërkuar ndër të tjera që certifikatat e përfituara nga kurse periodikë nuk merren në konsideratë për këtë kriter, pasi nuk konsiderohen të vlefshme në referim të bazës ligjore, ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.

-Kriteri i mësipërm është konfuz, jo në përputhje me ligjin e cituar, dhe njëkohësisht AK nuk ka ndjekur të njëjtin standard si në procedurat tjera për të cilat ka kërkuar fuqi punëtore të kualifikuar. Së pari, në nenin 12 të këtij ligji, pika 1 përcaktohen institucione publike dhe private që kryejnë shërbime të formimit profesional në të cilat janë edhe qindrat e formimit profesional, institucione të specializuara për grupe të veçanta, shoqëritë tregtare dhe institucione tjera të licencuara dhe/ose të akredituara (germa c, ç, d, dh). Në pikën 16, pika 3 të këtij ligji, përcaktohet se kualifikimet janë të plota ose të pjesshme dhe përfitohen nëpërmjet formave ku ndër to janë kurset profesionale ku përfshihen dhe praktikat profesionale apo në forma të tjera të mësim nxënies praktike (germa b).

-Së dyti, kërkesa që stafi i kualifikuar, përkatësisht *hidraulik, mekanik, bojaxhi, hekurkthyes, pllakashtrues, karpentier, teknik mekanik, marangoz, etj., për të cilët kërkohet të jenë me dëshmi të sigurimit teknik*, është kërkesë e fryrë dhe jo në përputhje me objektin e ligjit mbi të cilit lëshohen këto dëshmi, Kërkesa që këta punonjës të kenë dëshmi sigurimi teknik bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” dhe ligjit me nr. 13/2013 i cili ka bërë ndryshime në ligjin e mësipërm, kanë për objekt pikërisht kërkesat e sigurisë në raport me instalimin elektrike. Profilet e këtyre punonjësve, puna që ata kryejnë nuk lidhet me instalimet elektrike, për të qenë me dëshmi të sigurimit teknik.

-Formulimi nga NJP se nuk njihen trajnimet e përfituara nga kurse periodikë, duke cituar ligjin e mësipërm, është i pa plotë, pasi nuk specifikon dispozitën konkrete ku bazohet, duke u kthyer potencialisht në një kriter evaziv i cili pengon ofertuesit ose bëhet arsye jo ligjore për s’kualifikimin e OE.

2.Kërkesa e pikës 2.3.6 e DST e cila kërkon 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

3.Kërkesa e pikës **2.3.11 e DST** e cila kërkon nga OE të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për materialet *elektrike, hidraulike, hidrosanitrare, pllaka dyer/dritare etj...* është kërkesë e tepërt, kjo pasi kemi të bëjmë me mallra që gjenden lehtësisht në treg, të cilat vendosen në vepër vetëm me miratimin e mbikëqyrësit, i cili vlerëson nëse janë në përputhje me specifikimet teknike sipas *Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 “për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* me ndryshimet përkatëse.

4.Kërkesa e pikës **2.3.13 e DST** e cila kërkon nga OE të paraqesin raport testimi nga laboratorë të akredituar për *materialet elektrike, hidraulike dhe ato të bojës*, është vijim i kërkesave të tepërta dhe jo në përputhje me rregullat e LPP. Praktikisht raport testimet e paraqitura, jo domosdoshmërisht kanë të bëjmë me produktet që do vendosen në vepër, dhe si e tillë nuk i shërben procedurës. Njëkohësisht, referuar udhëzimit të cituar më sipër, është mbikëqyrësi ai që vlerëson materialet përpara vendosjes në vepër.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët NjP.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 11. Tenderi me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për punonjësit e DDD”, me këto të dhëna:

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për punonjësit e DDD”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.54, datë 12.11.2020	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.54, datë 12.11.2020	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.54/1, datë 12.11.2020 1. R. B. – (Kryetar) 2. R. S. – (Anëtar) 3. K. L. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë me Propozim”	1. K. Ll. – Juriste 2. O. T. – Ekonomist 3. Xh. L. – Ing.Kimiste	
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,298,400 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “P.” shpk” me ofertë 6,292,200 lekë pa tvsh - me lidhje kontrate datë 18.12.2020, me afat 30 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 6,200 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.12.2020	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/dh të DST** për shlyerjen e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin e OSHEE me nr. 5135 prot., datë 25.11.2020 sipas të cilit OE nuk ka detyrime deri në datën 25.11.2020, pa përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2020. Në kushtet kur data e paraqitjes së ofertave është 03.12.2020, OE rezulton debitor duke mos likuiduar faturën e muajit Tetor 2020 dhe ngarkuar në

sistem në kundërshtim me pikën 5, germa (c) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe kërkesës së DST cituar më sipër.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/4 të DST** për furnizime të ngjashme. Ky OE ka paraqitur disa fatura TVSH-je për punë të ngjashme, të cilat janë pothuajse vetëm për njërin produkt që është maska, me apo pa varvul. Sipas listës së produkteve të kërkuara, rezultojnë edhe produkte tjera si *veshje speciale një përdorimesh, çizme kundër kimikateve, doreza profesionale kundër kimikateve, doreza të gomuara DDD, kominoshe profesionale për DDD dhe syze transparente.*

-Sa më sipër, pothuajse gjitha faturat e furnizimeve të ngjashme janë vetëm për produktin maskë, dhe 2 fatura të lidhura me UK-Durrës përfshije çizme pune ndërsa produktet tjera janë vegla pune. Duke qenë se kemi të bëjmë me produkte specifike që konsistojnë në produkte për mbrojtjen nga rreziku ndaj agjentëve të ndryshëm kimik, OE nuk jep garanci për kontrata të ngjashme pasi nuk rezulton të ketë të tilla për pjesën më të madhe të produkteve të paraqitura.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët KVO.**

**Ndikimi:** Nuk jep garanci për mallrat në përputhje me specifikimet e kërkuara.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2021**

*-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2021, nga DPOP referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **17** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 224,394 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 217,240 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 7,154 mijë lekë pa TVSH ose 3.2 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2021 - 31/12/2021	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
<b>GJITHESEJ</b>	<b>17</b>	<b>224,394,821</b>	<b>217,240,164</b>
-Të hapura	7	185,860,386	181,840,512
- Kërkesë me propozim	10	38,534,435	35,399,652
<b>Sipas objekteve</b>	<b>17</b>	<b>224,394,821</b>	<b>217,240,164</b>
-Objekte në fushën e investimeve	2	27,817,513	27,727,940
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	15	197,117,308	189,512,224

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **47** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **29** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **5** procedura ose 29 % e procedurave të zhvilluara.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **17** procedura prokurimi të zhvilluara me fond limit 224,394 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **13** procedure me fond limit 217,503 mijë lekë ose 97% e vlerës së fondit limit.

Nga auditimi i **11** procedurave me fond limit 187,721 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, **3** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, në **2** raste procedura duhej ndarë në lote dhe në **3** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, *si më poshtë vijon:*

**12. Tenderi me objekt: “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore”, Viti 2021”, me këto të dhëna:**

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore”, Viti 2021		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.16/7, datë 13.01.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderitNr.16/7, datë 13.01.2021 1. K. Ll. --- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.16/8, datë 13.01.2021 1.R. B.-(Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	2. V. K. --- Inxhinier 3. A. T. --- Inxhinier	2. T. D. --- (Anëtar) 3. V. Ll. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 61,885,281.6 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: OE R. sh.a me ofertë 26% (marzh fitimi), me vlerë kontrate 61,885,281.6 Lekë pa Tvsh, lidhje kontrate datë 26.02.2021, me afat 24 muaj	7.Diferenca me fondin limit: Vlerësimi me marzh fitimi (lidhen kontrata deri në vlerën e fondit limit)
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit16.02.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3/i e DST** e cila kërkon nga OE depozita me kapacitet jo më të vogël 3000m<sup>3</sup>, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në raport me volumin e pritshëm të furnizimit të kërkuar nga AK. Konkretisht janë kërkuar rreth 570,000 litra lëndë djegëse gazoil për 12 muaj, ndërkohë që kapaciteti i kërkuar është për depozita 3 milion litërshë është depozitë relativisht e madhe, për sasi shumë më të mëdha se ato të kërkuara për furnizim nga AK, çka potencialisht mund të përbëjë kufizim për OE për paraqitje oferte.

2.Kërkesa e pikës **2.3/j e DST** e cila kërkon nga OE 2 mjete transporti autobot 1000 – 5000 litra, rezulton se ndër dokumentacionet e nevojshme nuk është kërkuar licenca e transportit për mallrat e rrezikshme dhe njëkohësisht as pasaporta e botit, e cila përcakton kapacitetin e depozitave sipas matjeve, kjo për të siguruar AK që sasia e marrë e produktit është ajo e kërkuar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët NjP.**

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

**13. Tenderi me objekt: “Blerje dhe instalim soba me pellet”, me këto të dhëna:**

13. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dhe instalim soba me pellet”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.429/3, datë 08.02.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.429/3, datë 08.02.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.429/3, datë 08.02.2021 1. A. U. --- (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”	1. R. B. --- Jurist 2. V. K. --- Inxhinier 3. A. Xh. --- Inxhinier	2. E. Ll. --- (Anëtar) 3. E. L. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 17,808,560 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: “C.” sh.p.k me ofertë 17,450,272 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 01.04.2021, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 358,288 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 09.03.2021	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1. Kërkesa e pikës 3/b e DST e cila kërkon ndër të tjera që OE të ketë pjesë të stafit 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 arkitekt, janë kërkesa të tepërta dhe të paargumentuara lidhur me objektin e prokurimit i cili është “Blerje soba për pellet”. Njëkohësisht, në DST janë kërkuar edhe 1 inxhinier mekanik dhe 1 inxhinier elektrik, pra sa më sipër, për objektin e prokurimit i cili është për blerje mallrash, janë kërkuar rreth 5 inxhinierë të cilët njëkohësisht duhet të figurojnë në listëpagesa. Një numër i tillë inxhinierësh mund të kërkohej për punime ndërtimore, ndërkohë që këto kemi të bëjmë me procedurë blerje mallrash, dhe sa më sipër janë kërkesa jashtë objektit të prokurimit. Në rast se NJP gjykonte se mund të kërkohej inxhinierë, duhej të mundësonte disponimin e tyre edhe me kontratë shërbimi. Është kërkesë që kufizon pjesëmarrjen.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për aplikimin e loteve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP.**

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

#### 14. Tenderi me objekt: “Shërbim mirëmbajtje mjete transporti”, me këto të dhëna:

14. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje mjete transporti”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.409/3, datë 19.02.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.409/3, datë 19.02.2021	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.409/4, datë 19.02.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese me Propozim”	1. K. Ll. --- Jurist 2. I. P. --- Inxhinier 3. E. A. --- Specialist	1. R. B. --- (Kryetar) 2. K. L. --- (Anëtar) 3. V. K. --- (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa T.v.sh) 3,249,040 Lekë pa T.v.sh	6. Oferta fituese: A. sh.a 3,194,900 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 08.04.2021, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 54,140 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 08.03.2021	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1.OE “A.” sha, nuk përmbush kriterin e pikës 2.2/3 të DST për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore. Ky OE rezulton sipas ekstraktit të QKB të ketë adresë tjetër të shoqërisë në Bashkinë Tiranë, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave pranë kësaj bashkie.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 të DST për 1 inxhinier mekanik. OE ka deklaruar si inxhinier mekanik punonjës in A. B., për të cilin nuk ka paraqitur diplomën, në kundërshtim me DST.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3 të DST** për 1 elektroaut, 1 motorist, 1 pompist dhe 2 xhenerikë, për të cilët duhet të paraqesë dëshmitë e kualifikimit profesional. Për punonjës A. M., A. M., G. S., A. K. dhe A. P., nuk janë paraqitur dëshmitë e kualifikimit profesional.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për makineritë dhe pajisjet e nevojshme, për të cilat duhej të paraqesë dokumentacion për disponimin e tyre. Nuk ka asnjë dokumentacion që provon disponimin e tyre, si në pronësi, ashtu dhe në qiramarrje.

5.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për certifikatën BS OHSAS 18001:2007, pasi dokumenti i paraqitur figuron jashtë afateve të vlefshmërisë.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e NjP dhe KVO..

**Ndikimi:** Ndikon në garancinë që jep OE për përmbushjen e kontratës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

### 15. Tenderi me objekt: “Blerje vegla pune”, me këto të dhëna:

15. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje vegla pune”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.425/3, datë 05.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.425/3, datë 05.03.2021 1. K. Ll. --- Jurist 2. E. I. --- Inxhinier 3. O. M. --- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.425/3, datë 05.03.2021 1. R. B. -- (Kryetar) 2. E. Ll. --- (Anëtar) 3. T. D. --- (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për Propozim”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 3,604,380 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: I. sh.p.k me ofertë 3,564,930 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 20.04.2021, me afat 10 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 39,450 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.04.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, 1.Ankim Nr. 937 prot. datë 18.03.2021 V. sh.p.k për kriteret.	12. Përgjigje ankesës nga AK, Kthim përgjigje Nr. 937/4 prot. datë 23.03.2021.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për ndarjen në lote të procedurës.

**Situata:** Lidhur me mallrat objekt prokurimi, konstatohet se produkti me nr. rendor 11 *Karikues për makinë elektrike*, nuk është mall i cili duhet të klasifikohet si vegël pune, në kuptim të objektit të kontratës, pasi kategoria i produktit nuk ka lidhje me mjetet tjera të kërkuara të cilat mund të klasifikohen si mjete pune të nevojshme. *Karikuesi për makinën elektrike*, duhej klasifikuar si produkt që lidhet me pjesët e këmbimit apo të shërbimit për automjetet, dhe si e tillë AK duhej të bënte blerje të veçantë që ka për objekt pajisjet që karikojnë makinat elektrike. Vendosja e këtij produkti në listën e mallrave, përbën kufizim për OE që kanë për objekt aktiviteti mallrat/veglat e punës, pasi i makinës nuk mund të konsiderohet mall i ngjashëm.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin për ndarjen në lote të procedurës.

**Ndikimi:** Rrit pjesëmarrjen e OE.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 16. Tenderi me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale”, me këto të dhëna:

16. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.507/3, datë 19.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.507/3, datë 19.03.2021 1. K. Ll. --- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.507/4, datë 19.03.2021 1. R. B. --- (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:“Procedurë e Hapur”	2. Xh. L.--- Inxhinier 3. E. K.-- Inxhinier	2. R. S. --- (Anëtar) 3. E. Ll. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 13,333,300 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: BOE P. sh.p.k & S. sh.p.k me ofertë 12,899,570 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 19.05.2021, me afat 31.12.2021.	7.Diferenca me fondin limit: 433,730 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 19.04.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Shpjegime shitesë: Për sa i përket klasifikimit të disa mallrave si vegla pune nuk jemi dakord me konstatimin e grupit të auditimit pasi këto mallra në referim të VKM nr. 1053, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e mbrojtjes personale (pmp) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, nuk klasifikohen vegla pune por pajisje të mbrojtjes personale.*

### Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit sqarojnë se ato pranohen, pasi argumentohet lista e produkteve në përputhje me VKM-në 1053, cituar më sipër.

## 17. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e thellë e hidroizolimit të tarracave në objektet arsimore dhe godinat publike”, me këto të dhëna:

17. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e thellë e hidroizolimit të tarracave në objektet arsimore dhe godinat publike”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.413/3, datë 16.04.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.413/3, datë 16.04.2021 1. K. Ll. --- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.413/4, datë 16.04.2021 1. E. Ll. --- (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e thjeshtuar”	2. A. U.--- Inxhinier 3. E. B. --- Ekonomist	2. G. N. --- (Anëtar) 3. T. D. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 7,838,349 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: BOE H. sh.p.k & B. sh.p.k me ofertë 7,447,000 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 03.06.2021, me afat 60 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 391,349 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 14.05.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka



**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3.8 e DST** e cila kërkon nga OE për materialet e nevojshme sipas shtojcës 12, të paraqesin certifikatë/deklaratë konfirmimit të CE të produkteve të konfirmuara nga një organizëm i notifikuar europian/... ose raport testimet nga një organizëm i notifikuar europian/laborator të akredituar është kërkesë e tepërt dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit.

-Së pari kërkesa për certifikata konfirmimit të produkteve CE, është kërkesë për certifikata që jo domosdoshmërisht disponohen nga ofertuesi, ndërkohë që kërkesa për raport testimet nga laboratorë të akredituar nuk është në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “*për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” me ndryshimet përkatëse, pasi pavarësisht çdo raporti, i cili jo domosdoshmërisht ka të bëjë me produktet që do paraqiten në vepër, është mbikëqyrësi i punimeve ai që përcakton nëse materialet janë sipas specifikimeve të kërkuara për vendosjen e tyre në vepër.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.BOE nuk përmbush kriterin e **2.2/d të DST** për punë të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit.

-OE “H.” shpk, i cili ka marrë përsipër 51% të punimeve sipas preventivit, ka paraqitur kontratën e nënkontraktimit me objekt “*Përmirësimi, Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale dhe Horizontale*” kontratë e cila ka për investitor Autoritetin Rrugor Shqiptar. Objekti i procedurës dhe zërat e preventivit nuk kanë asnjë ngjashmëri me objektin e prokurimit të procedurës objekt shqyrtimi.

-OE “B.” shpk, i cili ka marrë përsipër 49% të punimeve sipas preventivit, nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme që lidhet me objektin e prokurimit.

2.OE “B.” shpk, i cili ka marrë përsipër 49% të punimeve sipas kontratës së bashkëpunimit, nuk ka paraqitur licencën e shoqërisë e cila përcakton se ky OE përmbush kategoritë e nevojshme sipas pikës **2.3.1 të DST**.

3.OE “H.” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST**, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga certifikatat ISO të kërkuara në DST (**ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018**), ndërkohë që është OE që ka marrë përsipër 51% të punimeve.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi *anëtarët e NjP* dhe *KVO*.

**Ndikimi:** Nuk jep garanci për përmbushjen e kontratës nga BOE.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 18. Tenderi me objekt: “*Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë*”, me këto të dhëna:

18. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ <i>Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë</i> ”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.431/3, datë 09.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.431/3, datë 09.03.2021 1. R. B.--- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.431/4, datë 09.03.2021 1. E. Ll. --- (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “ <i>Procedurë e Hapur e thjeshtuar</i> ”	2. V. K. --- Inxhinier 3. A. Xh. --- Inxhinier	2. G. N. --- (Anëtar) 3. T. D. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 5,088,800 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: C. sh.p.k me ofertë 4,672,050 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 08.07.2021, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 416,750 Lekë pa Tvsh.

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 01.06.2021	9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK, 1. Ankim Sh. sh.p.k për kriteret Nr. 972 prot. datë 18.03.2021	12. Përgjigje ankesës nga AK, 1. Kthim përgjigje Nr. 972/4 prot. datë 23.03/2021	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, 1. Vendim Nr. 199/2021 datë 07.05.2021.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për mos ndarjen në lote të procedurës dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata:** -Lidhur me procedurën e mësipërme, konstatohet se mallrat objekt prokurimi janë mobilie dhe kondicionerë. Lidhur me produktet e mësipërme, ato nuk mund të konsiderohen të njëjta apo të ngjashme, dhe si e tillë këto blerje duhet të ishin bërë në procedura të veçanta ose të ndahej me lote, kjo për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE nuk përmbush kriteret për furnizime të ngjashme, pasi për produktet nga nr. 5 në 10 që lidhen me pajisjet e mobilimit, nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

**Ndikimi:** Ndikon në garancitë që jep OE për mallrat objekt prokurimi.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Për sa i përket pikës 2.1 të DST, OE ka paraqitur certifikata ISO 9001 dhe 45001 të cilat kanë elementë të ngjashëm me objektin e prokurimit. Konstatimi që objekti i Certifikatave ISO duhet të mbulojë të elementët kryesorë të gjitha shërbimeve të parashikuara në preventiv për procedurën e prokurimit do të merret parasysh në procedurat që do të realizohen nga autoriteti kontraktor.*

**Shpjegim shtesë:** *në nenin 53 pika 4 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), përcaktohet se..... 4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj..... Nga shqyrtimi kësaj dispozite ligjore konstatohet që jemi në kushtet e mungesës së një elementi të certifikatës i cili nuk përbën një fakt që ndryshon thelbësisht karakteristikat apo kushtet e vendosura në DST, pasi operatori ekonomik ofertues i zotëron certifikatat e kërkuara.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, pranohet pretendimi juaj duke marrë në konsideratë faktin se OE disponon certifikatat ISO, por në raste të ngjashme, të evidentohet devijimet e vogla në raportin e hartuar nga KVO, i cili të bëhet pjesë e dosjet së procedurës.

### **Procedurat e periudhës 01.01.2022 – 30.12.2022**

*-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.*

Për periudhën 01/01/2022 – 31/12/2022, nga DPOP referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka përfunduar gjithsej **14** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 195,618 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 186,894 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 8,723 mijë lekë pa TVSH ose 4.5%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrë si vijon:

Procedura 01/01/2022 - 31/12/2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
<b>GJITHESEJ</b>	<b>14</b>	<b>195,618,512</b>	<b>186,894,618</b>
-Të hapura	6	157,735,912	150,985,935
- Kërkesë me propozim	9	37,882,600	35,908,683
<b>Sipas objekteve</b>	<b>14</b>	<b>195,618,512</b>	<b>186,894,618</b>
-Objekte në fushën e investimeve	4	84,043,319	81,088,340
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	10	111,575,193	105,806,218

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **42** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **25** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **5** procedura ose 35% e procedurave të zhvilluara.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **14** procedura prokurimi të zhvilluara me fond limit 195,618 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **11** procedure me fond limit 187,721 mijë lekë ose 96% e vlerës së fondit limit.

Nga auditimi i **11** procedurave me fond limit 187,721 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, **4** raste ku kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, *si më poshtë vijon:*

**19. Tenderi me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për automjetet e transportit”, me këto të dhëna:**

19. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për automjetet e transportit”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.609/3, datë 04.03.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.609/3, datë 04.03.2022 1. K. Ll. --- Jurist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.609/4, datë 04.03.2022 1. A. U. --- (Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e thjeshtuar”	2. I. P.--- Inxhinier 3. E. A. --- Specialist	2. E. B. --- (Anëtar) 3. J. M. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 3,325,875 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: B. M. p.f me ofertë 2,942,300 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 12.04.2022, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 383,575 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 25.03.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkis Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2 të DST** për 1 motorist. Janë deklaruar punonjësit B. D. dhe L. L. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se B. D. nuk figuron në listëpagesën e muajit Shkurt 2022. Për punonjësin tjetër, L. L., rezulton se dëshmia e kualifikimit profesional e paraqitur, nuk përcakton se është i kualifikuar për motorist, por ka vetëm përshkrimin se ka përfunduar kursin profesional për *Autoservis*.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

**Ndikimi:** Nuk jep garanci për kapacitetin e operatorit ekonomik.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

**20. Tenderi me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me këto të dhëna:**

20. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.1047/3, datë 15.03.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.1047/3, datë 15.03.2022 1. K. Ll. --- Jurist 2. A. U.--- Inxhinier 3. J. Q. --- Inxhinier	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.1047/4, datë 15.03.2022 1. E. Ll. --- (Kryetar) 2. O. M. --- (Anëtar) 3. A. Xh. --- (Anëtar) Nr.1047/6, datë 26.04.2022 1. E. Ll. --- (Kryetar) 2. O. M. --- (Anëtar) 3. V. D --- (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 40,000,000 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: OE V. sh.p.k me ofertë 38,364,718 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 16.05.2022, me afat 15.09.2022.	7.Diferenca me fondin limit: 1,635,282 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.04.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë .	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për hartimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon 1 mjek, është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

2.Kërkesa e pikës **2.3.9 e DST** e cila kërkon për materialet bojëra, të paraqiten deklarata nga prodhuesi ose distributori i autorizuar dhe në rast paraqitje deklarata nga distributori, të paraqitet akt marrëveshje ndërmjet tyre, është kriter i fryrë i cili nuk i shërben procedurës. Bojërat e nevojshme janë mall i cili gjendet lehtësisht në treg dhe që mund të ofrohet nga shumë kompani që kanë për objekt tregtimin e këtij malli. Për AK do ishte e mjaftueshme që OE të paraqesë mostra, katalogë apo deklarata që disponon bojërat sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.11 të DAT** për certifikatën e konformitetit për produktin *sistem kapot*, pasi certifikata e konformitetit e paraqitur, është fotokopje e panoterizuar. Është paraqitur vetëm një noterizim për përkthimin.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.12 të DST** për *Automjetin me kosh në lartësi ≥12m*. Për të përmbushur këtë kriterin është paraqitur mjeti me targa AA347VF, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti “S.” shpk. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se akti i kolaudimit është jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 24.09.2021. Gjithashtu, për këtë mjet nuk ka asnjë skedë teknike që të përcaktojë lartësinë e koshi **≥12m**.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe KVO.

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** 1.Për sa i përket pikës 2.3.2 të DST, ky kriter për të patur në stafin e operatorit ekonomik ofertues drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve. Detyrimi i administratorit të operatorit ekonomik ofertues për të përcaktuar me shkresë Drejtuesin Teknik të shërbimeve objekt të kontratës është bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Nuk është kërkuar të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.

2.Për sa i përket pikës 2.3.4 të DST, përcaktimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zërimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përlllogaritura në bazë të VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, (e ndryshuar). Këtë përlllogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve e kemi paraqitur të detajuar në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit të publikuar në SPE krahas DST.

3.Për sa i përket pikës 2.3.6 të DST, njësia e prokurimit i është referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar) i cili përcakton "2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut te ndërmarrjes, ne te gjitha subjektet qe ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose te huaja, juridike ose fizike dhe 12/2. Për subjektet qe nuk përfshihen ne piken 12/1 te këtij vendimi, marrja ne pune e mjekut te ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i te punësuarve është jo me pak se 15 punonjës.

Nga verifikimi në Qendrën e Publikimeve Zyrtare na rezulton që ky vendim është shfuqizuar me VKM Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

Konstatimi do të merret parasysh dhe në procedurat që do të realizohen nga autoriteti kontraktor do të modifikohet kriteri sipas përcaktimeve në këtë auditim.

4.Për sa i përket pikës 2.3.9 të DST autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Sasia e një pjese të mallrave që kërkohen për realizimin e kësaj kontrate nuk gjendet lehtësisht në treg dhe autoriteti kontraktor duhet të garantohet për vazhdimësinë e furnizimit gjatë zbatimit të kontratës. Ky konstatim do të merret parasysh duke marrë për bazë sasinë e materialeve të kërkuara për zbatimin e kontratës dhe në procedurat që do të realizohen nga autoriteti kontraktor do të modifikohet kriteri sipas përcaktimeve në këtë auditim.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

1.Pranohet pika 1 e observacionit, duke marrë parasysh shpërndarjen e punimeve dhe numrin e lartë të stafit të kërkuar.

2.Pranohet pika e dytë, për argumentimin e numrit të stafit të përgjithshëm të nevojshëm për zbatimin e kontratës, pasi është argumentuar dhe pasqyruar në procesverbalin përkatës, në përputhje me manualin teknik të çmimeve.

3.Për pikën 3 dhe 4 janë pranuar gjetjet e audituesve, për të cilat kërkohet në vijim të zbatohen në procedura të ngjashme.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 1007/4 prot., datë 28.02.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Për sa i përket pikës 2.2.3 të DST, OE V. shpk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore të lëshuar nga Bashkia Vlorë ku konfirmohet shlyerja e detyrimeve sipas kërkesave të DST. KVO nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshhtë dhe atij Historik të lëshuar nga QKB ka konstatuar se ky operator ekonomik nuk ka patur vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit përveç Bashkisë Vlorë. Detyrimi ligjor i këtij operatori për deklarimin e detyrimeve kundrejt Bashkive në të cilat realizon punime ndërtimore dhe regjistrimin në QKB, është tagër i konstatimit nga organet tatimore.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

1.Lidhur me pikën 1, do pranohet pretendimi juaj, por në vijim, AK të marrë në konsideratë edhe vendet tjera ku ky OE ka ushtruar aktivitet, pasi mos regjistrimi i adresës është në kundërshtim me nenin 43 pika 1/1 “përditësimi i të dhënave të regjistrimit” të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**21. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë në terrenet e jashtme sportive”, me këto të dhëna:**

21. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë në terrenet e jashtme sportive”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.1461/4, datë 23.05.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.1461/4, datë 23.05.2022 1. A. U. --- Inxhinier 2. E. K. --- Inxhinier 3. A. S. --- Ekonomist	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.1461/5, datë 23.05.2022 1.T. D. -(Kryetar) 2. O. M. - (Anëtar) 3. S. P. - (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 22,290,506- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE 2. sh.p.k me & A. sh.p.k me me ofertë 21,410,687 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 08.08.2022, me afat 90 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 879,788 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 22.06.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për hartimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës 2.5 e DST e cila kërkon staf teknik të kualifikuar, ka kërkuar ndër të tjera që për punonjësit teknik gjeometër, teknik ndërtimi, bojaxhi, hekurkthyes, suvaxhi, karpentier dhe manovratorë, të disponojnë dëshmitë e sigurimit teknik të lëshuara nga ISHTI ose institucione tjera të akredituara, është kërkesë e fryrë dhe jo në përputhje me objektin e ligjit mbi të cilit lëshohen këto dëshmi Kërkesa që këta punonjës të kenë dëshmi sigurimi teknik bazohet në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” dhe ligjit me nr. 13/2013 i cili ka bërë ndryshime në ligjin e mësipërm, i cili ka për objekt pikërisht kërkesat e sigurisë në raport me instalimin elektrike. Profilet e këtyre punonjësve, puna që ata kryejnë nuk lidhet me instalimet elektrike, për të qenë me dëshmi të sigurimit teknik.

2.Kërkesa e pikës 2.6 e DST e cila kërkon 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

3.Kërkesa e pikës **2.7 e DST** e cila kërkon OE 1 inxhinier me trajnimet për materialet e ndërtimit *markatura CE dhe direktiva 86/106/CEE*, 1 inxhinier i certifikuar për hapjen e punime kapitale nëntokësore *pajisur me certifikate profesionale lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2 (dy) punonjës te certifikuar/trajnuar nga prodhuesi, ose ente te certifikuara te cilat te kenë në fushë veprimtarinë e objektit te tyre trajnim për instalim tapet bari artificial, 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin ose kontrate shërbimi/ekspertize me një subjekt te kualifikuar Ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te figurojnë ne listë pagesat e shoqërisë, dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën *Shkurt – Prill 2022*, është kërkesë kufizuese e cila nuk i shërben procedurës por përbën kufizim për OE. Lidhur me kërkesën e inxhinierit të trajnuar për materialet, sqarohet se materialet në vepër vihen vetëm me miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, dhe si e tillë kjo kërkesë nuk i shërben AK. Gjithashtu, kërkesë që inxhinieri tjetër të ketë certifikatë profesionale për hapjen e punime kapitale nëntokësore, dhe 2 punonjësit të certifikuar/trajnuar nga prodhuesi ose ente të certifikuara që të kenë fushë veprimtarie instalim tapet bari të cilët të figurojnë njëkohësisht në listëpagesë për periudhën *Shkurt – Prill 2022*, kufizon pjesëmarrjen pasi nëse AK i konsideron të nevojshëm stafin e mësipërm, do duhej të mundësonte stafin edhe me kontratë pune, pasi janë certifikime që jo çdo shoqëri mund ti disponojë. Lidhur me kërkesën për ekspert zjarrfikës, ajo nuk është në përputhje me preventivin e paraqitur, pasi nuk ka zëra për të cilat të kërkohej një ekspertizë e tillë.*

4.Kërkesa e pikës **2.11 e DST** e cila kërkon nga OE 2 kamionë me kapacitet mbajtës 8 – 10 Ton, 2 kamionë vetëshkarkues 3.5 – 7.5 Ton, 3 kamionçina deri 3.5 Ton, janë kërkesa të tepërta dhe të paargumentuara në raport me volumin materialeve dhe afatin e punimeve. Krahas numrit të lartë, edhe përcaktimi i kapacitetit 8 – 10 Ton, është i vogël dhe AK do duhej të përcaktonte një kufi më të lartë ndërmjet kapacitetit minimal dhe maksimal, kjo për të rritur mundësinë dhe për të mos rritur kostot për OE që disponojnë mjetet e nevojshme, por me kapacitete të ndryshme.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e paraqitur, rezulton se OE “A.” shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/2 të DST** për vërtetimet e taksave vendore për vitin 2021. Ky OE nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë se ka likuiduar taksat vendore në vendet ku ka ushtruar aktivitetet për vitin 2021, që përkon me adresën ku ushtron veprimtarinë në Bashkinë Fier. Njëkohësisht për vitin 2021 ky OE ka paraqitur punë të ngjashme në Bashkinë Himarë për të cilën duhej të likuidoheshin detyrimet vendore. Në ekstraktin historik të QKB, ka paraqitur hapje adrese në Urën Vajgurore për vitin 2021, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë dokument për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie për vitin 2021.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.11 të DST** për disa nga mjetet e nevojshme për zbatimin e kontratës, konkretisht:

-Nuk përmbushin kriterin për 1 kamion me kapacitet 8 deri në 10 ton. Vetëm mjeti me targa AA935VN i marrë me qira nga subjekti V. C. plotëson kriterin, ndërkohë gjitha mjetet tjera të paraqitura, ose janë disa herë me shumë me kapacitet mbajtës se sa ai i kërkuar në DST, ndërkohë mjetet tjera të cilat janë marrë me qira, figuron se kanë certifikatën e transportit për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira.

-BOE nuk përmbush kriterin për 2 kamion me kapacitet mbajtës 3.5 – 7.5 Ton. Të gjitha mjetet e paraqitura që kanë këtë kapacitet, të cilat janë marrë me kontratë qiraje, figuron se kanë certifikatën e transportit për vete dhe jo për të tretë dhe me qira. Disa nga mjetet që kanë këtë kapacitet, u mungon certifikata e transportit.

-BOE nuk përmbush kriterin për 1 grejder. Në dosjen e paraqitur nuk kishte dokumentacion për disponimin e këtij mjete.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi *anëtarët e NjP* dhe *KVO*.

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës, si dhe nuk garanton që BOE ka kapacitetin teknik të nevojshëm.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 22. Tenderi me objekt: “Furnizim vendosje dritare dhe vetrata në objektet publike”, me këto të dhëna:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizim vendosje dritare dhe vetrata në objektet publike”.		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.2479/1, datë 06.06.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:Nr.2479/1, datë 06.06.2022 1. K. Ll. --- Jurist 2. A. S. --- Ekonomist 3. J. M. --- Sp,Fushe	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.2479/2, datë 06.06.2022 1. E. Ll. --- (Kryetar) 2. G. N. --- (Anëtar) 3. D. V. --- (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 10,847,176 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: N. sh.p.k me ofertë 10,664,435 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 07.09.2022, me afat 90 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 182,741 - Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 24.06.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për hartimin e kriterëve.

**Situata: Hartimi i kriterëve:** 1.Kërkesa e pikës **2.3.8 e DST** e cila kërkon 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

2.Kërkesa e pikës **2.3.9 e DST** e cila kërkon autorizime nga prodhuesi ose distributori zyrtar, është kërkesë e tepërt, pasi kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden në treg, për të cilat është e mjaftueshme të kërkohej deklarata nga OE në rast se nuk janë prodhues të tyre, të deklarojnë prodhuesin e tyre. AK në raste të ngjashme për produkte e mobilimit, është mjaftuar me deklaratën e OE, pa kërkuar autorizime nga prodhues të ndryshëm. AK duhej të ndiqte të njëjtin standard pasi kemi të bëjmë me mallra që gjenden lehtësisht në treg. Njëkohësisht, pavarësisht se kërkohej këto autorizime, sipas Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2001 “*për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” me ndryshimet përkatëse, pavarësisht çdo autorizimi të paraqitur për materialet e kërkuara, është mbikëqyrësi i punimeve ai që përcakton nëse materialet janë sipas specifikimeve të kërkuara për vendosjen e tyre në vepër.



**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi *anëtarët e NjP*.

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

### 23. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë e tualeteve në objektet shkollorë”, me këto të dhëna:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e Thellë e tualeteve në objektet shkollorë”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.3937/2., datë 22.09.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.3937/2., datë 22.09.2022	3.Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr.3997/3., datë 22.09.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar”	1. K. Ll. --- Inxhinier 2. J. G. --- 3. D. V. --- Sp.fushe	1. T. D. --- (Kryetar) 2. E. Ll. --- (Anëtar) 3. G. L. --- (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 10,905,637 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE 2. sh.p.k me & A. sh.p.k me me ofertë 10,348,500Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 09.12.2022, me afat 60 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 557,137 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 24.10.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës 2.3.6 e DST e cila kërkon 1 mjek është kërkesë në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1 ku përcaktohet se:

“Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“6.Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

**Vlerësimi i ofertave:** 1.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e paraqitur, rezulton se BOE “2.” shpk “A.” shpk nuk përmbushin kriterin e pikës 2.2.3 të DST për vërtetimet e taksave vendore për vitin 2022. OE “2.” shpk, ka paraqitur vetëm vërtetim për likuidimin e taksave në Bashkinë Fier, ndërkohë rezulton se për vitin 2022 ky OE ka lidhur kontratë me Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë. Ky OE nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar se ka likuiduar detyrimet vendore përkatëse. Gjithashtu, OE “A.” shpk, rezulton sipas ekstraktit historik të QKB se ka krahas adresës kryesore në Fier, edhe vend ushtrim tjetër të aktivitetit në Tiranë, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore për vitin 2022 pranë kësaj bashkie.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi *anëtarët e NjP* dhe *KVO*.

**Ndikimi:** Kualifikuar OE i cili shmang detyrimet vendore aty ky ushtron aktivitetin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## 24. Tenderi me objekt: “Blerje automjet”, me këto të dhëna:

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjet”		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.5179., datë 17.11.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.5179., datë 17.11.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.5179/1, datë 17.11.2022 1. A. U. --- (Kryetar) 2. V. Ll. --- (Anëtar) 3. J. S. --- (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar”	1. K. Ll. --- Jurist 2. I. P.--- Inxhinier 3. E. A. --- Specialist	
5.Fondi Limit (pa T.v.sh) 2,900,000 Lekë pa T.v.sh	6.Oferta fituese: E. Ç. p.f me ofertë 2,797,000 Lekë pa Tvsh., me lidhje kontrate datë 13.12.2022, me afat 30 ditë	7.Diferenca me fondin limit: 103,000 Lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 02.12.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë	10.Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, për vlerësimin e ofertave.

**Situata: Vlerësimi i ofertave:** 1.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.2 të DST e cila kërkon nga OE katalogë/fragmente katalogu ose skeda teknike. Për të përmbushur këtë kriter është paraqitur një skedë teknike e cila nuk i përket asnjë dokumenti zyrtar të prodhuesit të mjetit, por është një skedë e hartuar nga subjekti tregtues dhe e vulosur prej tij.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi *anëtarët e NjP* dhe *KVO*.

**Ndikimi:** Nuk jep garanci për specifikimet teknike të mjetit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

### 2.4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit nr. 1007/1, datë 15.11.2022, i ndryshuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike në Bashkinë Tiranë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, është përzgjedhur për auditim objekti:

Nr	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës (me TVSH)	Shënime
1	Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike	“R.” SHPK	38,197,800	Audituar

## **I. “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë)**

### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPOP), Bashkia Tiranë, të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm (DP), z. E. B. dhe Operatorit Ekonomik “R.” SHPK, me përfaqësues z. R. P., me licencë profesionale NZ 7408/12. Vlera e kontratës është 38,197,800 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e dorëzimit të objektit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 59/2 prot, datë 21.12.2020, është lidhur kontrata me OE “G.” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 511,632 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës së dhurimit me nr. 47392/1 prot., datë 13.12.2021, është dhuruar shërbimi i shërbimit nga OE Ing. M. K. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1200/4 dhe me vlerë të dhurimit të shërbimit 49,560 lekë me TVSH.

Investitori ka lidhur fillimisht një kontratë shërbimi për kolaudimin e objektit me nr. 2704/5 prot., datë 14.07.2021 me shoqërinë “B.” SHPK. Mbi bazë të kësaj kontrate, kjo shoqëri ka hartuar procesverbalin e kolaudimit tekniko ekonomik në datën 28.09.2021, në të cilin shpjegohen edhe arsyet e zgjatjes së afatit të kolaudimit, që kanë të bëjnë me komunikimin e palëve (sipërmarrës, mbikëqyrës, kolaudator), në lidhje me plotësimin e dosjes teknike. Procesverbali i kolaudimit, i hartuar dhe i firmosur vetëm nga përfaqësuesi i shoqërisë “B.” SHPK, është i plotë dhe me konkluzione të qarta teknike. Në këto konkluzione, theksohet se mungonte lidhja e rrjetit inxhinierik/elektrik të objektit, për të mundësuar inspektimin/verifikimin e funksionalitetit të sistemeve të ndryshme të instaluar në këtë objekt (sistemit elektrik, hidraulik, telefonisë, internetit, etj), ka paqartësi (dhe mungesë dakordësie) në lidhje me përdorimin dhe zbatimin e sistemit CAM për përforsimin e strukturave mbajtëse të objektit, si dhe janë vërejtur plasaritje në një nga muret e objektit, të cilat duhen verifikuar nëse kanë sjellë pasoja në themel. Pra, kolaudatori **me të drejtë** ka kërkuar shpjegime dhe përmirësim të punimeve të kryera. Nga verifikimi në terren, rezulton se objekti nuk është i lidhur akoma me rrjetin elektrik dhe inspektimi/verifikimi i funksionalitetit të sistemeve të ndryshme të instaluar në këtë objekt, nuk është i mundur. Nga verifikimi i pagesave bankare, rezultoi se me Urdhër Shpenzimi nr. 267, datë 24.06.2022, nga ana e DPOP është bërë pagesa për kolaudatorin “B.” SHPK në vlerën 49,560 lekë, si shërbim i realizuar. Mosmarrja në konsideratë e këtij procesverbali kolaudimi nga ana e investitorit, të hartuar nga shoqëria e kontraktuar për këtë qëllim dhe lidhja e një kontrate dhurim shërbimi me një tjetër operator, është e paargumentuar teknikisht. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e DPOP z. E. B..

Gjithashtu, ngarkohet me përgjegjësi edhe kolaudatori i objektit znj. M. K., për hartimin e aktit të kolaudimit pa bërë kontrollin e funksionimit të sistemeve infrastrukturorë.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhërit të Titullarit të Investitorit me nr. 5321/4, datë 29.12.2021, nga grupi i punës me përbërje ark. A. U., ing. E. K. dhe teknik D. M, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 31.12.2021.

Duhet theksuar se objekti, edhe pse ka një vit që është kolauduar, nuk ishte në shfrytëzim.

### **Projektpreventivi**

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje ndërtimi/Infrastrukurore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin i DPOP, Bashkia Tiranë z. E. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Projektpreventivi është hartuar nga shoqëria “I.” SHPK në Tetor 2020.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 21.12.2020, duhet të përfundonin në datën 21.03.2021 dhe kanë përfunduar me datë 09.06.2021.

Me shkresën nr. 616, datë 16.02.2021, Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të punimeve, për shkak të infektimit të tij me virusin Covid-2. Kjo kërkesë është miratuar me shkresën nr. 616/1, datë 16.02.2021 të titullarit të DPOP z. E. B.. Me shkresën nr. 616/2, datë 16.03.2021 (ose 30 ditë pas pezullimit të punimeve), Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar rifillimin e punimeve, që është miratuar me shkresën nr. 616/3, datë 16.03.2021 të DP të DPOP. Me shkresën nr. 1217/1, datë 07.04.2021 të investitorit, është kërkuar pezullimi i përkohshëm i punimeve deri në një urdhër të dytë, për shkak të ndryshimit të planit për akomodimin e Policisë Bashkiake në një tjetër godinë. Me shkresën nr. 1878/1, datë 31.05.2021 (ose 54 ditë pas pezullimit të punimeve) të investitorit, është kërkuar rifillimi i punimeve, duke kërkuar zbatimin e projektpreventivit fillestar.

Në dosje nuk administrohet asnjë amendament për shtyrjen e afatit të përfundimit, në kundërshtim me nenin 35.2, 36.4 dhe 36.5 të Kontratës. Ky mosveprim, ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm të DPOP z. E. B.

- Pas kërkesës së mbikëqyrësit për miratimin e preventivit të përmirësuar, është mbajtur procesverbali datë 04.06.2021 “Për miratimin përfundimtar të ndryshimit të volumeve në objektin “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPOP), Bashkia Tiranë, ndërmjet mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve (i panënshkruar nga përfaqësues të investitorit DPOP). Pas këtij procesverbali të ndryshimit të punimeve, është hartuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen në vlerën 2,881,848 lekë/lekë me TVSH dhe punime që hiqen në vlerën 1,859,726 me TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë me vlerë 1,022,122 lekë me TVSH. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7 dhe 7.1, sipas të cilës “7. Sipërmarrës i nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.

7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj”. Ky mosveprim, ngarkon me përgjegjësi Mbikëqyrësin, sipërmarrësin e punimeve dhe Investitorin.

Janë bërë analiza të tre çmimeve të reja, të cilat nga auditimi rezultuan të jenë hartuar sipas manualit në fuqi të çmimeve në punimet e ndërtimit.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së unimeve “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPOP), Bashkia Tiranë				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 49/5 prot datë 21.12.2020	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 38,197,800 lekë <b>OE fitues “R.” SHPK</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 38,161,248 lekë -Vlera pa tvsh 31,801,040 lekë	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 169 ditë. Fillimi punimeve: 21.12.2020 Përfundimi punimeve : 09.06.2021		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “G.” SHPK	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr 59/2 prot, datë 21.12.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Ing. M. K. PF	Licenca Nr: MK	Kontrata nr. 47392/1 prot., datë 13.12.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> 28.12.2021	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> 31.12.2021		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë(për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **232,320 lekë pa tvsh**.

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPOP), Bashkia Tiranë, nga zbatuesi i punimeve OE “R. C” SHPK, për zërat e punimeve 3.4, 12.E dhe 13.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Përforsim kolone tulle me sistemin CAM”, “FV grupi i pompave të furnizimit me ujë” dhe “FV detektorë tymi, multi sensitiv, inteligjentë të adresueshëm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 59/2 prot, datë 21.12.2020. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas kontratës së dhurimit të shërbimit me nr. 47392/1 prot., datë 13.12.2021.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e DPOP Bashkia Tiranë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Nga DPOP Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 232,320 lekë pa tvsh nga OE “R.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike (DPOP), Bashkia Tiranë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 232,320 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dem ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. G. S. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Zj. M. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** DPOP Tiranë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk është krijuar GMS dhe caktuar koordinatori i riskut, nuk janë miratuar regjistrat e konsoliduar të riskut, nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar plane vjetore trajnimesh për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit edhe në programe trajnimesh të organit epror bashkia Tiranë; mungesa e GMS ka sjellë mungesën e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të njësisë, planeve dhe raporteve vjetore mbi problematikat që hasen dhe parashikim për zgjidhjen e tyre gjatë veprimtarisë së njësisë publike. Mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2 dhe Manuali MFK miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i përditësuar me nr. 108/2016; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për krijimin e GMS dhe caktimin e koordinorit të riskut, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve dhe regjistrin e konsoliduar të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët standarde të auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të njësisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve në aktet ligjore/nënligjore dhe hapjen e faqes zyrtare në internet të DPOP Tiranë.

*Në vijimësi*

**1.2 Rekomandim:** Drejtorja e Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të marrë masa për të hartuar plane vjetore trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.3 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të ofrojë me përgjegjshmëri mbështetje te Nëpunësi Autorizues, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të MFK si dhe në rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi, konform akteve ligjore/nënligjore për arritjen e objektivave institucionale.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i mosrealizimit të planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore konstatohet se:

**1.** Referuar të dhënave të pasqyrës së planifikimit e realizimit për çdo zë buxhetor, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 52.7% deri në 100% *për vitin 2020*, nga 76,4% deri 98% *për vitin 2021*, nga 56 % deri 99.2% *për vitin 2022*; por gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit për llog. 600, llog. 601 dhe llog 606 vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022, ndërsa niveli i realizimit të po këtyre zërave vjen në rënie (përjashtuar llog 600-601); për llog 602 dhe llog 230-231 niveli i planifikimit vjen në rënie ndërsa niveli i realizimit vjen në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 dhe në rënie për vitin 2022, Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka DPOP dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2020 e zënë shpenzimet për llog. 602 e ndjekur nga llog. 600-601, për vitin 2021 e zënë shpenzimet e llog. 600 –601 e ndjekur nga llog 602; edhe për vitin 2022 peshën specifike e zë llog 600-601 e ndjekur nga llog. 602. Kjo tregon një rritje të planifikimit të shpenzimeve për zërin buxhetor “paga personeli” për shkak të trendit në rritje që paraqet planifikimi dhe realizimi për rekrutime si dhe për një planifikim të vlerave buxhetore në rënie për investime.

**2.** Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit e të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave nga bashkia dhe shpenzimeve të tyre, që do të thotë se nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, ka diferenca të dukshme të cilat janë pasqyruar edhe në tabelë, duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie.

**3.** Referuar tabelës së Investimeve rezultoi se, realizimi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta: *për vitin 2019* është realizuar në vlerën e 206,201,487 lekë; *në vitin 2020* në vlerën e 163,946,286 lekë ose 52.7% e fondeve të planifikuara dhe me një diferencë prej (-)42,255,201 lekë më pak nga viti 2019; ndërsa *për vitin 2021* realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 184,578,149 lekë ose 71.7% e fondeve të planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të lartë realizimi se ajo në vitin 2020 me (+)20,631,863 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2020; ndërsa *për vitin 2022* realizimi i shpenzimeve është në vlerën e 84,248,231 lekë ose 56.2% e fondeve të planifikuara dhe rezulton me një vlerë më të ulët realizimi se ajo në vitin 2021 me (-)100,329,918 lekë, por me një plan buxhetor më të vogël se ai i vitit 2021.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia dhe njësitë e varësisë nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

**4.** Lidhur me detyrimet e prapambetura nga auditimi rezultoi se: likuiditeti i detyrimeve të prapambetura në total për “investime nga bashkia” dhe “mallra e shërbime” të marra së bashku, është i vogël por ka trend në rritje; situatën e përkeqëson krijimi i detyrimeve të reja për këta zëra buxhetorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse të buxhetit në bashkinë Tiranë, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

**2.2 Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike pranë DPOP, Bashkia Tiranë, të marrë masa për likuidimin në kohë të detyrimeve vjetore ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja

prapambetura. Gjithashtu në planifikimin e buxhetit, më parë të planifikohen fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndërsa vite, sipas një plani të miratuar, me qëllim uljen në maksimum të tyre.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin e buxhetit sipas nevojave institucionale konstatohet se:

**1.** Nga auditimi rezultoi se, nuk janë ngritur dhe miratuar GMS dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për DPOP Tiranë, të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), politikat që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-se, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës. Kjo ka sjellë që procesi i hartimit dhe miratimit të PBA –ve, të në mos kalojë në të gjitha hallkat përkatëse, duke mos zbatuar kështu udhëzimet e MFE/Drejtoria e Financave Vendore: Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 7 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”. **2.** Për diskutimet rreth hartimit dhe prezantimit të PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxheti Vjetor 2021, nga ana e DPOP nuk ka asnjë takim të dokumentuar me njësitë përbërëse të strukturës së saj, apo dhe të DPOP me organin epror Bashkia Tiranë (takime me prezencë apo në platformën on-line), në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20.

**3.** Plani i buxhetit të DPOP Tiranë në raport me planin e buxhetit të Bashkisë Tiranë, rezulton të jetë: për vitin 2020 plani fillestar i buxhetit të DPOP zë 5.2% të planit të Bashkisë Tiranë dhe 4.1 % ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2021 zë 6.1 % të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar; për vitin 2022 zë 4.7% të planit fillestar dhe 3.3% ndaj planit të ndryshuar. Pra vlera e raportit të planit buxhetor të ndryshuar të DPOP ndaj atij të Bashkisë Tiranë vjen në rënie; Kjo ka sjellë që me zgjerimin e kompetencave dhe të fushës së veprimtarisë së DPOP Tiranë nga ana e Bashkisë Tiranë, të mos jetë në raport të drejtë me planifikimin e fondeve buxhetore vjetore, me qëllim realizimin me efektivitet të shërbimeve nga ana e njësisë publike. Kjo në moszbatim të ligjit nr.9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 29-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandim:** Në DPOP Tiranë titullari i saj në cilësinë e NA të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik për realizimin e takimeve, ku të analizohet çdo tregues i mos/realizimit të buxhetit vjetor, të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato mallra e shërbime që janë pjesë e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së njësisë nga njëra anë dhe arritjes së objektivave të saj nga ana tjetër, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### *Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatu se:

**1. Llogaria 486** “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,337,156 lekë. Në këtë llogari nuk është përfshirë shuma prej 108,432 lekë e cila përfaqëson detyrimin për shërbimet e 3 automjeteve, shumë e cila përfshihet në llog. 467 të pasivit. **Pra** kjo llog. është nënvlerësuar për shumën 108,432 lekë; kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;



**2.** Në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet **llog. 470** “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” në vlerën 100,689,492 lekë me kundërparti llog.468, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të drejtave për t’u arkëtuar; kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

**3.** Përsa i përket objekteve të cilat janë në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe i kanë kaluar për mirëmbajtje DPOP Tiranë, të cilat aktualisht janë të pasqyruara në bilancin kontabël të datës 31.12.2020 dhe 31.12.2021, referuar regjistrin të asetëve: disa figurojnë me çmimin e blerjes, disa nuk kanë vlerë apo vitin kur janë krijuar. Gjykojmë se pasqyrimi i zërave me vlerat e viteve kaq të largëta nuk japin një pamje reale të vlerës së ndërtesave dhe rrjedhimisht nuk pasqyrojnë vlerën aktuale të tregut. Nga regjistri i Aseteve rezultojnë 53 (pesëdhjetë e tre) objekte që nuk e kanë vlerën e objektit (godinës) por janë kontabilizuar me vlerën e investimit të kryer mbi to. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

Pra rezulton se vlera e **llog. 212** në kontabilitet nuk pasqyron vlerën reale të objekteve;

**4.** Nga regjistri i aktiveve të njësisë për periudhën nën auditim, rezultojnë 51 mjete transporti, ku përfshihen edhe 7 (shtatë) mjete tejet të amortizuara teknikisht dhe që janë vlerësuar në pamundësi qarkullimi në rrugë (referuar praktikës dokumentare të komisionit të inventarizimit. Vlera kontabël në total e tyre është 11,270,000 lekë. Këto mjete nuk i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, në moszbatim kjo të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke bërë që vlera e tyre të gjendet në mënyrë të gabuar e pasqyruar në vlerën e llog. 215 në kontabilitet, duke pasqyruar një vlerë jo reale të kësaj llogarie, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

**5.** Në **llog. 602** nuk është pasqyruar vlera e nënlllogarisë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë për vitin 2021, e cila përfaqëson shpenzimin e 12 muajve për ambiente (magazina) të marra me qira nga DPOP Tiranë. Pra rezulton se llog. 602 është *nënvlerësuar në shumën 26,492,956 lekë*, që përfaqëson shpenzime qiramarrje të ambienteve, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandim** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të sistemuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 486 për shumën 108,432 lekë;

**4.2 Rekomandim** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës, të marrin masa për të plotësuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 llog. 602 në nënlllogarinë 6026 “shpenzime për qiramarrje” në shumën 26,492,956 lekë;

**4.3 Rekomandim** Drejtoria ekonomike dhe sektori i financës të plotësojë në pasqyrat financiare llog. 470 “të ardhura për tu marrë” në shumën 100,689,492 lekë;

**4.4 Rekomandim** Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e NA, NZ si menaxheri i Drejtorisë Ekonomike, menaxheri i Drejtorisë së Aseteve dhe ai i Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës të DPOP në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për të përmbyllur procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të amortizuara me qëllim shkarkimin e tyre nga kontabiliteti në vlerën e 11,270,000 lekë dhe pasqyrimin me vlerë reale të llog. 215 “mjete transporti”.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për vlerësimin e aktiveve, rezultoi se:

**1. Për vitin 2020:-** Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve për 2 shkollat: Gjimnazi “Partizani” dhe “Sabaudin Gabrani”, janë pa nënshkrimin e drejtuesve të shkollave; Mungon nënshkrimi i anëtarit të 4 të komisionit znj. L.Y. te relacioni në 2 raste për zbatim të UB. 178/2 dt.29.05.2021 dhe Relacion i dt.24.12.2021; Mungon nënshkrimi i specialistes së Financës (në 2 raste): te kartela e inventarëve për propozim dhe përmbledhëse e inventarëve; Nuk kanë dalë urdhra të brendshëm nga Titullari për krijimin e komisioneve për procedurën e Nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0; Për sa më lart nuk janë zbatuar Ligji 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Për vitin 2021:-** Për aktivitetin e komisionit të ngritur me Urdhrin e brendshëm-32/2 dt.18.05.2021 “Për ngritjen e komisioneve për inventarin fizik të aktiveve”, mungon Relacioni i Inventarit Fizik të aktiveve; Procesverbalet e përpiluara nga komisioni i vlerësimit në 3 raste nuk janë origjinale: e Urdhrit të brendshëm-32/2 dt.18.05.2021 me Relacion dt.29.09.2021; Urdhrit të brendshëm-32/2 dt.18.05.2021 me Relacion dt.01.11.2021; Urdhrit të brendshëm-32/2 dt.18.05.2021 dhe Relacion i komisionit mungon; Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit; nga Titullari i njësisë nuk kanë dalë urdhra të brendshëm, për krijimin e komisioneve për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të papërdorshme ose me jetën e dobishme 0, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV pika 81;

**Për vitin 2022:-** Urdhrat e Brendshëm të Titullarit të njësisë nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154/2003 “Për arkivat”, “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13, Vendimi nr. 4/2017 “Për Miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë” shtojca 1;

**2. Mjetet (çiklomotora) me targa CAH 716 dhe CAH 697, janë denoncuar në Drejtorinë e Policisë Tiranë të vjedhur. Për këto mjete nuk janë bërë procedurat e çregjistrimit të përkohshëm pranë DRSHTRR Tiranë me qëllim shmangien e detyrimeve vjetore: taksa e qarkullimit dhe gjoba e kolaudimit, zbatimi i së cilës shmang pagesat e panevojshme të cilat çojnë në shpërdorimin e fondeve. E njëjta praktikë duhej ndjekur edhe për mjetin me targë TR 0681 G, i cili nuk rezultoi në listën e mjeteve aktivë të njësisë, dhe që nënkupton se detyrimet vjetore janë në rritje progresive me kalimin e kohës. Për sa më lart nuk është zbatuar Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120;**

**3. Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë në cilësinë e subjektit që përdor, mirëmban dhe pasqyron çdo shpenzim në bilancin e saj për mjetet e transportit, ndonëse në vitin 2021 ka kërkuar pranë bashkisë Tiranë mundësinë e çregjistrimit të përhershëm të mjeteve të amortizuara me vlerë kontabël 11,270,000 lekë, duhet të rikërkojë në mënyrë të vazhdueshme që nga ana e bashkisë Tiranë të mbyllet procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të amortizuara (teknikisht), me qëllim largimin e tyre nga ambientet e DPOP, çuarjen e tyre për skrap dhe për të bërë të mundur shkarkimin e tyre nga kontabiliteti i njësisë. Në moszbatim të Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120;**

**4. Drejtoria e Transportit në DPOP nuk ka hartuar një regjistër të dhënash mbi informacionin teknik, shpenzimet e detyrueshme vjetore dhe shpenzimet për shërbimet teknike të mirëmbajtjes, me qëllim fleksibilitet në marrjen e informacionit dhe ushtrimin e shërbimit në kohë ndaj mjetit,**

në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /;Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 pika 2 dhe Manualit MFK.

**5.** Komisioni i Inventarizimit në relacionin përmbledhës ka konkluduar se: njësia publike – DPOP Tiranë ka në mirëmbajtjen e saj 131 objekte (godina) me destinacion të ndryshëm përdorimi nga të cilat 22 (njëzetë e dy) nuk janë de facto të DPOP; Nga këto 17 (shtatëmbëdhjetë) në vlerën kontabël 9,613,267 lekë në total, nuk janë fizikisht nën administrimin dhe mirëmbajtjen e saj (në Llog. 212); ndërsa 5 (pesë) godina përdoren nga DPOP Tiranë për nevojat e saj. Në relacionin e komisioneve të inventarizimit, që prej vitit 2017 është bërë identifikimi i tyre në listën e aktiveve, por në terren ato janë tjetërsuar pasi pronarët e tyre i kanë përfutur dhe i kanë zhvilluar sipas nevojave apo interesave të tyre private. Ndonëse nga ana e Drejtorisë Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Performancës në DPOP Tiranë me shkresë zyrtare i është drejtuar ZRPP Tiranë (sot ASHK) për çregjistrimin e tyre nga DPOP Tiranë, nuk ka patur feedback nga ana e tyre për bashkëpunim. Kjo ka sjellë që këto objekte të mbeten në pronësi *de jure* të Bashkisë Tiranë dhe vlera e tyre në kontabilitetin e DPOP Tiranë; në moszbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV, pikat 73-120 Ligjit nr. 8744 /2001 “Për transferimin e pronave shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit të MFE nr. 2727/2020 “Mbi zbatimin e ligjit 90/2019 dhe percaktimin e tarifës së shërbimit”.

**6.** Gjithashtu në Regjistrin e Aseteve për llog.212 disa objekte (godina) nuk e kanë vlerën e tyre fillestare (të krijimit), por kanë të regjistruar vlerën e investimit të realizuar për mirëmbajtjen e tyre; disa objekte u përkasin periudhave të hershme të krijimit (para viti 1990). Nga auditimi rezulton gjithashtu se 20 (njëzetë) objekte inventarë AAGJM- janë të pa pajisura me certifikatë pronësie; dhe se të gjitha objektet nuk e kanë aktin e vlerësimit të tyre; në moszbatim të Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, Ligji 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit të MFE nr. 2727/2020 “Mbi zbatimin e ligjit 90/2019 dhe percaktimin e tarifës së shërbimit.

**7.** DPOP Tiranë nuk i ka përcjellë zyrtarisht organit epror – Bashkia Tiranë relacionin me listën e objekteve të ‘zëna forcërisht’ nga ish- pronarët e tyre, me qëllim që Drejtoria Ligjore pranë saj t’i drejtohet zyrtarisht ASHK- së Tiranë për çregjistrimin e tyre nga pronësia e DPOP Tiranë, pasi ato rezultojnë të tjetërsuara si nga statusi juridik i pronësisë, ashtu edhe fizikisht apo nga destinacioni i përdorimit (funktionalitetit). Në moszbatim të Udhëzimit nr. 30/2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”;

**8.** Mungesa e Grupit të Menaxhimit Strategjik ka bërë që njësia të ushtrojë funksionet e veta pa hartuar dhe pa miratuar një strategji dhe një rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale të DPOP si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, që do të rriste efektivitetin në aktivitetin e Drejtorisë së Aseteve, Inventareve dhe Koordinimit; në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, Manualit MFK pika 2.2.6; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**5.1 Rekomandim** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të transportit të amortizuara, me qëllim që vlera e llog. 215 të jetë sa më reale dhe të përfaqësojë ato mjete transporti të cilat realisht janë në gjendje teknike për të qarkulluar;

### **Menjëherë**

**5.2 Rekomandimi** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për çregjistrimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) objekteve që janë ‘të zëna forcërisht’, për vlerësimin kryesisht të atyre pa vlerë fillestare të krijimit, për pajisjen me certifikatë pronësie të 21 (njëzetë

e një) objekteve shkollore, për të pasqyruar një vlerë sa më reale të llog. 212 dhe llog. 210 në kontabilitetin e njësisë;

*Në vijimësi*

**5.3 Rekomandimi** Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues në DPOP Tiranë të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre, miratimin e një Rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2020 – 31.10.2022 në DPOP Tiranë u konstatua se nga DPOP Tiranë njoftimet për punësim nuk realizohen nëpërmjet komunikimit me mjetet dhe në strukturat përgjegjëse – Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Aftësive; DPOP Tiranë nuk ka hartuar listën e kriterëve specifike që u bashkëngjitet kriterëve bazë për punësim dhe rrjedhimisht ka punësuar persona që nuk plotësojnë kërkesat profesionale e teknike që kërkon efektiviteti i aktivitetit të njësisë, nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione me status “Grup i veçantë” si dhe lidhur me trajtimin e punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, në moszbatim këto të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 79-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandim:** NA dhe Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe e Performancës të marrin masa për të përdorur SHKPA si i vetmi organ përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e njoftimeve për punësim; hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të caktojnë në strukturën organizative pozicione për kategorinë ‘grup i veçantë’; si dhe të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, të gjitha këto për motivimin e punonjësve rritjen e efektivitetit të shërbimeve nga ana e tyre në dobi të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për subjektet përfituese të banesave sociale, ka rezultuar mungesë funksionimi e strukturave përgjegjëse dhe bashkëvepruese për menaxhimin e kontratave. Kontratat e lidhura me afat 1 vjeçar, nuk janë rinovuar pas përfundimit të këtij afati. Nuk kanë bashkëpunuar strukturat e ngarkuara sipas VKB-së Nr.109 datë 27.09.2018, pasi Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, Komisionit të Strehimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë, nuk kanë dalë me vendimmarrje për rivlerësimin e mëtejshëm të kriterëve të përfituesve, kusht i cili përcakton edhe rinovimin e kontratave. Konstatohet se disa prej banesave sociale braktisen nga qytetarët përfitues, evidentimi i të cilave nuk bëhet në kohën e duhur, duke krijuar detyrime fiktive. Rezultojnë njëkohësisht 12 familje të akomoduar në këto banesa, familje të cilat nuk janë pjesë e listës sipas VKB-së Nr.28 datë 13.08.2015 dhe VKB-së Nr.44 datë 06.07.2016 për “Përzgjedhjen e listës së aplikuesve, përfitues të programit të Banesave Sociale me qira”, për të cilët nuk disponohet asnjë kontratë e lidhur dhe detyrimet bashkëlidhur saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 44-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale, në bashkëpunim me strukturat e ngarkuara sipas VKB-së nr. 109, datë 27.09.2018, të marrë masa në drejtim të rivlerësimit dhe rinovimit të kontratave për përfituesit e qirave të banesave sociale, kjo për të përcaktuar edhe detyrimin e duhur të vlerës së qirasë për përfituesit e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.2. Rekomandimi:** Për 12 familjet të cilat janë strehuar në banesat sociale të cilët nuk janë pjesë e listës së miratuar me VKB, t'i nënshtrohen procedurave përkatëse nëse e përfitojnë ose jo banesën sociale. Të evidentohen me procesverbalin përkatës nëpërmjet strukturave të ngritura pranë kësaj drejtorie, largimet/braktisjet e banesave nga përfituesit e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për përdorimin e palestrave të shkollave për aktivitetet sportive, mungon marrja e pëlqimit nga drejtorët e shkollave, të cilët nuk kanë firmosur marrëveshjet e lidhura, në kundërshtim me VKB-në nr. 7, datë 31.01.2018. Në kontratat e lidhura nga Bashkia Tiranë, nuk janë përcaktuar qartë të dhënat e ambientit që jepet me qira, duke mos përcaktuar sipërfaqet e tij, kjo për të bërë të mundur saktësimin e vjeljes së tarifës përkatëse në bazë të nenit 73 të Vendimi Nr. 158 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**8.1. Rekomandimi:** DPOP për kontratat e lidhura për palestrat, të qartësojë me Bashkinë Tiranë si organ epror, vlefshmërinë e tyre kur konstatohen parregullsi në mos përputhje me VKB Nr. 7 datë 31.01.2018, që ka të bëjë me marrëveshjen Tip dhe tarifën përkatëse sipas objektit për të cilën janë lidhur këto kontrata. Të gjitha kontratat që do lidhen në vijim, të përcaktojnë saktë edhe sipërfaqet e dhëna me qira, kjo për të përcaktuar vlerën e saktë që duhet të paguajnë përdoruesit e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për bodrumet dhe vendstrehimet konstatohet se ka mangësi për monitorimin e tyre, që lidhet me mungesën e procesverbalit të gjendjes fizike të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës (shoqëruar dhe me pamje fotografike të momentit), në mospërputhje me germën a) të pikës 2, kreu VI i VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Në kontratat tip të dhënies me qira të vendstrehimeve mungon një përcaktim i plotë dhe posaçëm i të drejtave dhe detyrimeve të palëve në kontratë.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se mungon një data bazë ose një liste e saktë e numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, me qëllim arkëtimin konstant të detyrimeve nga qiraja.

Rezulton të mos ketë publikime të mundësive apo hapësirave ligjore që qytetarët kanë për marrjen me qira të bodrumeve apo vendstrehimeve, me qëllim mirëmbajtjen, vënien në ruajtje si edhe krijimin e të ardhurave për institucionin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 659 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 49-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**9.1. Rekomandimi:** Njësia përgjegjëse, në vijim, në lidhjen e kontratave me subjektet përkatëse, të procedojë me hartimin e dokumentacionit shoqëruar të këtyre kontratave në funksion të përcaktimit të sipërfaqes dhe rrjedhimisht edhe të vlerës së qerasë.

**9.2. Rekomandimi:** DPOP të krijojë një data bazë të numrit, gjendjes fizike dhe vendndodhjes së vendstrehimeve, si dhe të mundësohet publikimi i këtyre objekteve me qëllim krijimin e të ardhurave për Bashkinë Tiranë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për marrjen e magazinave me qira, konstatohet se ka mangësi në procedurën e marrjes me qira, në mospërputhje me nenin 5, 8, 16, si dhe pikën 4 të nenit 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Nga ana e Titullarit të Institucionit nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm

që të përcaktojë në mënyrë shteruese të gjithë procedurën e marrjes me qira, me qëllim përdorimin eficient, efektiv dhe me ekonomi të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

-Rezulton të mos ketë publikime të njoftimit për marrjen me qira të ambienteve për magazinë, si dhe nuk është përcaktuar dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin ofertuesit.

-Nga kontrolli i dosjeve nuk dokumentohet kriteri që lidhet me sigurinë, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht: Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisa me sisteme alarmi për zjarret). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i DPOP dhe personat e ngarkuar sipas urdhrave të miratuar prej tij për lidhjen e kontratave për qiratë e ambienteve, të përcaktojnë në mënyrë shteruese elementët kryesorë që kanë të bëjnë me objektin e qirave, kjo për të rritur eficientësinë e përdorimit të fondeve. Të merren masa në vijim për publikimin e kërkesave për marrje ambientesh me qira.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e 47 procedurave të prokurimit publike për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 14 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurime publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për blerje mallrash, në 2 raste procedura duhej të ishte ndarë në lote, konkretisht procedurat e vitit 2021 me objekt “Blerje vegla pune” si dhe “Mobilim dhe pajisje kondicionimi për Qendrën Komunitare Shkozë” pasi mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta, Mos ndarja në lote kufizon pjesëmarrjes e operatorëve ekonomik, pasi një numër i vogël OE mund të kenë objekt të aktivitetit të tyre, të dy objektet e procedurës që prokurohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 29 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me nenin 42 të VKM-në nr. 285/2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për të realizuar këtë ndarje dhe hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin i procedurave të prokurimit për punë publike, është vendosur në shumicën e tyre si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e

këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e ligjit. Pra ky kriter rezulton i pa argumentuar dhe i pa lidhur me objektin e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dispozitën ligjore të cituar më sipër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**13.1 Rekomandim:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Drejtoria e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të marrë masa për shmangien e kriterëve të pa argumentuara dhe të pa lidhura me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e operatorve ekonomik në procedurat e prokurimit publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit me objekt blerje mjetesh, konkretisht “*Blerje automjet Pick Up*” dhe “*Blerje automjet kamionçinë ATP 5+1/6+1 vende me bagazh hermetik*”, rezulton se specifikimet teknike të vendosura janë me diferenca minimaliste apo fikse për parametrat teknik, specifikime të cilat mund të pengojnë konkurrencën, dhe janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**14.1 Rekomandim:** Specialistët e fushës në Komisionin për Hartimin e Specifikimeve Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të marrin masa për vendosjen e specifikimeve teknike sa më përfshirëse, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 47 procedurave të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2020 – 31.12.202, u konstatua në 13 raste kualifikim i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, dhe neni 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3, të ndryshuara me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1 Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm i DPOP, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, nuk administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1. Rekomandim:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit/infrastrukture, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se objekti i rikonstruktuar “Ish Garda, edhe pse është kolauduar në datën 28.12.2021, nuk është vënë në shfrytëzim nga Investitori. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1. Rekomandim:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të merren masa të menjëhershme për inicimin e shfrytëzimit të këtij objekti, me qëllim ruajtjen dhe administrimin sa më të mirë të tij.

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në terren për zbatimin e punimeve civile të kontratës me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, rezultoi se grupi i pompave të furnizimit me ujë nuk ekzistonte. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1. Rekomandim:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për mungesën e këtij zëri pune dhe të përcaktohet personi përgjegjës që do të zëvendësojë grupin e pompave ose të dëmshpërblejë vlerën e dëmit ekonomik.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike*”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë me vlerë të kontratës (me tvsh) 38,197,800 lekë, fituar nga OE “R.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 232,320 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 49/5 prot datë 21.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë dhe OE “R.” SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1. Rekomandim:** Nga DPOP, Bashkia Tiranë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **232,320 lekë pa tvsh** nga OE “R.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 49/5 prot datë 21.12.2020, me objekt “Mirëmbajtje e thellë në objekte Publike”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për dhënie me qira të banesave sociale, rezulton debi e akumuluar në vlerën 100,589,491 lekë, nga të cilat,

- Për vitin 2017 janë 297 debitorë me vlerën e detyrimit 19,306,264 lekë;
- Për vitin 2018 janë 330 debitorë me shumë e debisë prej 36,275,766 lekë;
- Për vitin 2019 janë 331 debitorë me vlerën e detyrimit prej 57,472,830 lekë;
- Për vitin 2020 janë 338 debitorë me vlerën e detyrimit në 28,445,386 lekë;
- Për vitin 2021 janë 305 debitorë në vlerë të detyrimit prej 22,144,145 lekë;



-Rezulton se është krijuar debi ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë.

-Nga ana e saj Drejtoria e Strehimit ka raportuar në Bashkinë Tiranë, por mbajtja e statusit “raportim” jo vetëm që nuk ka sjellë marrjen e masave për zgjidhjen e problemit, por ka rezultuar me rritjen e numrit të debitorëve dhe të vlerës së detyrimit. Ky detyrim i përket kontratave me tarifa të pa përditësuara, të cilat janë modeste dhe të përballeshme nga përfituesit. Mungesa e bashkëpunimit mes DPOP Tiranë me Drejtorinë e Strehimit Social/Bashkia Tiranë, është arsyeja bazë e krijimit dhe thellimit të problematikes nga viti në vit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 44-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandim:** Nga DPOP, Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Banesave Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të qerasë dhe të marrin masa për hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore, me qëllim arkëtimin e vlerave të debitorëve në shumën 100,589,491 lekë, dhe pagesën e vlerave të detyrimit ndaj OSHEE në vlerën 23,924,081 lekë dhe ndaj UKT në vlerën 8,703,915 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratave për dhënien e palestrave me qira ndërmjet DPOP si Drejtori Mbikëqyrëse dhe subjekteve përfituese, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet në vlerën 1,526,525 lekë, nga të cilat *për vitin 2018* janë 15 debitorë me shumën e detyrimit 232,130 lekë; *për vitin 2019* janë 9 debitorë me shumën e detyrimit 59,475 lekë nga të cilët 3 debitorë janë të trashëguar nga viti 2018 në shumën e 29,475 lekë; *për vitin 2020* janë 50 debitorë me shumën e detyrimit 1,012,025 lekë; *për vitin 2021* janë 38 debitorë me shumën e detyrimit 514,500 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 47-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandim:** Nga DPOP Bashkia Tiranë, struktura përgjegjëse e saj- Drejtoria e Aseteve e Koordinimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe atë Ekonomike të analizojnë situatën financiare të krijuar nga mos vjelja e detyrimit të pagesave të tarifës për palestrat shkollore të dhëna në përdorim dhe të marrin masa në hartimin e planeve të punës, ndjekjen e hapave administrative apo ligjore me qëllim përmirësimin e situatës për të arkëtuar vlerën e plotë të detyrimit prej 1,526,525 lekë dhe parandalimin e kësaj dukurie në periudhat e ardhshme.

*Menjëherë*

## **D. MASA DISIPLINORE.**

**Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” shkronjat “e” dhe “ç”, të nenit 1, Kreu IV dhe nenet 37 dhe 44 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Masat disiplinore të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

**Masa disiplinore “Vërejtje”, për:**

**z. K. Ll.**, me detyrë *Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 12 (dymbëdhjetë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit*

*Përfundimtar të Auditimit)*

**z. A. U.**, me detyrë *Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe Transportit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 7 (shtatë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**z. E. Ll.**, me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Godinave Arsimore dhe Publike*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**z. E. B.**, me detyrë *Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Performancës*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**z. T. D.**, me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Impiantëve dhe Riparimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**z. A. S.**, me detyrë *Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të DT jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 3 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**z. K. L.**, me detyrë *Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Koordinimit*, për mangësitë e konstatuara në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 4 (katër) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 84-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**